



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 177

Tiranë – E hënë, 15 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 104/2021, datë 28.10.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19.....
	15617
Dekret i Presidentit nr. 13314, datë 9.11.2021	Për shpallje ligji.....
	15669
Ligj nr. 106/2021, datë 4.11.2021	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 30, datë 27.9.2021, “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export B.V.</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”.....
	15670
Dekret i Presidentit nr. 13318, datë 10.11.2021	Për shpallje ligji.....
	15670
Ligj nr. 108/2021, datë 4.11.2021	Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit, për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat.....
	15670
Dekret i Presidentit nr. 13320, datë 10.11.2021	Për shpallje ligji.....
	15695
Ligj nr. 109/2021, datë 4.11.2021	Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.1.2017.....
	15695

Dekret i Presidentit nr. 13319, datë 10.11.2021	Për shpallje ligji.....	15704
Dekret i Presidentit nr. 13310, datë 8.11.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	15704
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 10.11.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe planin e veprimit 2021–2022”	15704
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 528, datë 10.11.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”	15739
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 252, datë 12.11.2021	Mbi delegimin e kompetencës për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit.....	15739



LIGJ
Nr. 104/2021

Kopje nënshkrimi
(Numri i veprimt 52360)

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
GARANCISË NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (BERZH) PËR
MARRËVESHJEN E HUAS NDËRMJET
OPERATORIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE),
DHE BANKËS EVROPIANE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR
PROJEKTIN E OSHEE-së PËR REAGIMIN
NDAJ KRIZËS SË PANDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe
121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e
Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e garancisë ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane
për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për
marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të
Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.
(OSHEE), dhe Bankës Evropiane për Rindërtim
dhe Zhvillim për projektin e OSHEE-së për
reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19,
sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është
pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në
Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.10.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 13314, datë 9.11.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

MARRËVESHJE GARANCIE

(VISP: PROJEKTI I OSHEE-së PËR
REAGIMIN NDAJ KRIZËS SË PANDEMISË
COVID-19) NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë 8 shtator 2021

TABELA E LËNDËS

**NENI I – TERMAT DHE KUSHTE'T
STANDARDË; PËRKUFIZIME**

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe
Kushteve Standardë

Seksioni 1.02 Përkufizime

Seksioni 1.03 Interpretimi

**NENI II – GARANCIA; DETYRIME TË
TJERA**

Seksioni 2.01 Garancia

Seksioni 2.02 Përmbyllja e Projektit

Seksioni 2.03 Detyrime të tjera

NENI III – TË NDRYSHME

Seksioni 3.01 Njoftimet

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

MARRËVESHJE GARANCIE

**MARRËVESHJE E DATËS 8.9.2021
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
("GARANTUES") DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM ("BANKA").**

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se Operatori i Shpërndarjes
së Energjisë Elektrike Group sh.a. ka kërkuar
ndihmë nga Banka për financimin e Projektit dhe
Garantuesi ka rënë dakord të mbështesë këtë
kërkesë dhe Projektin në bazë të kësaj
Marrëveshjeje;

duke pasur parasysh se sipas një marrëveshjeje
huaje, të kësaj date, ndërmjet Operatorit të
Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. si
Huamarrës dhe Bankës ("Marrëveshja e Huas", siç
përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standardë),
Banka ka rënë dakord t'i japë një hua Huamarrësit
në shumën deri në 70,000,000 euro (shtatëdhjetë
milione euro), në bazë të termave dhe kushteve të



përcaktuar ose të referuar në Marrëveshjen e Huas, por vetëm me kusht që Garantuesi të garantojë detyrimet e Huamarrësit, sipas Marrëveshjes së Huas, siç parashikohet në këtë Marrëveshje; dhe

duke pasur parasysh se Garantuesi, duke pasur parasysh se Banka hyn në Marrëveshjen e Huas me Huamarrësin, ka rënë dakord të garantojë detyrime të tilla të Huamarrësit.

Tashmë, si rrjedhojë, me anë të kësaj, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Termat dhe Kushtet Standardë; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standardë

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standardë të Bankës të datës 1 tetor 2018, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin të përcaktuara plotësisht këtu, megjithatë, sipas ndryshimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas (dispozita të tilla siç janë modifikuar referohen më poshtë si “Termat dhe Kushtet Standardë”).

Seksioni 1.02. Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën), përveç nëse përcaktohet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në preambulë kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre në të, termat e përcaktuar në Termat dhe Kushtet Standardë dhe në Marrëveshjen e Huas kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Përfaqësues i Autorizuar i Garantuesit” nënkupton ministrin e Financave dhe Ekonomisë të Garantuesit.

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni ose seksioni të specifikuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Garancia; detyrime të tjera

Seksioni 2.01 Garancia

Garantuesi garanton në mënyrë të pakushtëzuar, si detyruesi kryesor dhe jo thjesht si dorëzanë, pagesën e kërkueshme dhe, në mënyrë të përpiktë, të çdo dhe të gjitha shumave të kërkueshme, sipas Marrëveshjes së Huas, qoftë në maturimin e deklaruar, me përshpejtim ose ndryshe, dhe përmbushjen në mënyrë të përpiktë të të gjitha detyrimeve të tjera të Huamarrësit, të gjitha siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 2.02 Përmbyllja e Projektit

Pa kufizuar përgjithësinë e ndonjë dispozite tjetër të Marrëveshjes ose Termave dhe Kushteve Standarde, Garantuesi do të mbështesë Huamarrësin në përpjekjet e Huamarrësit, për të vënë në veprim, sa më shpesh të jetë e nevojshme, të gjitha masat e domosdoshme, në mënyrë që të sigurojë që Huamarrësi mund të përmbushë detyrimet e tij të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, duke përfshirë por pa kufizuar detyrimet e tij sipas Seksionit 4.03 të Marrëveshjes së Huas.

Seksioni 2.03 Detyrimet e tjera

Garantuesi do të sigurojë që asnjë veprim që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin e Projektit ose kryerjen e detyrimeve të Huamarrësit në lidhje me Projektin, nuk do të merret ose lejohet të ndërmerret nga Garantuesi ose ndonjë agjenci ose autoritet përkatës shtetëror ose ndonjë nga nënndarjet e tyre përkatëse ose ndonjë nga subjektet në pronësi dhe të kontrolluar nga, ose që operojnë për llogari ose përfitim, të ndonjërit prej tyre.

Neni III

Të ndryshme

Seksioni 3.01 Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standardë, përveç që çdo njoftim do të konsiderohet se dorëzohet dorazi, me postë ose në formatin PDF ose në format të ngjashëm, me postë elektronike:

Për Garantuesin:

Ministri i Financave dhe Ekonomisë i Republikës së Shqipërisë



Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ministrit të Financave dhe
Ekonomisë

Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për BERZH:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Adminis-
trimit të Veprimeve/veprimi nr. 52360

Telefon: +44 20 7338 6000

Email: oad@ebrd.com

Seksioni 3.02 Opinioni ligjor

Për qëllime të seksionit 9.03(b) të Termave dhe
Kushteve Standardë dhe në përputhje me seksionin
[6.02 (b)] të Marrëveshjes së Huas, opinioni ose
opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të
Garantuesit nga ministri i Drejtësisë.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje,
duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të
autorizuar sipas rregullave, kanë siguruar që kjo
Marrëveshje të nënshkruhet në tri kopje dhe të
dorëzohet në Tiranë, Republikën e Shqipërisë, në
ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Nga: _____

Emri: Anila Denaj

Funksioni: Ministër i Financave dhe Ekonomisë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri: Jurgen Rigtterink

Funksioni: Zëvendëspresident i Parë

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

TERMAT DHE KUSHTET STANDARDË

1 tetor 2018

Ky dokument pasqyron politikat dhe praktikat
ekzistuese të Bankës dhe mund të rishikohet herë
pas here

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI 1 – APLIKIMI I TERMAVE DHE I KUSHTEVE STANDARDË

Seksioni 1.01 Aplikimi i Termave dhe i
Kushteve Standardë

Seksioni 1.02 Mospërputhje me Marrëveshjet e
Huas dhe Marrëveshjet e Garancisë

NENI II – REFERENCAT DHE TITUT; PËRKUFIZIMET

Seksioni 2.01 Interpretimi

Seksioni 2.02 Përkufizimet

NENI III – SHUMAT E AKSESUESHME; ANGAZHIMET PËR RIMBURIM; INTERESI DHE DETYRIME TË TJERA; SHLYERJA

Seksioni 3.01 Shumat e aksesueshme

Seksioni 3.02 Angazhimet për rimbursim të
kushtëzuar dhe të pakushtëzuar

Seksioni 3.03 Rialokimi

Seksioni 3.04 Interesi

Seksioni 3.05 Tarifa e angazhimit dhe tarifa
fillestare

Seksioni 3.06 Pagesat nga huamarrësi

Seksioni 3.07 Parapagimi

Seksioni 3.08 Anulimi

Seksioni 3.09 Norma e kamatëvonesës

Seksioni 3.10 Kostot e marrëveshjeve të
mëparshme

Seksioni 3.11 Valuta, forma dhe përcaktimi i
pagesave

Seksioni 3.12 Tarifat dhe kostot

Seksioni 3.13 Prishja e tregut

NENI IV – EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

Seksioni 4.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

Seksioni 4.02 Përgjegjësitë lidhur me
ekzekutimin e Projektit

Seksioni 4.03 Prokurimi

Seksioni 4.04 Të dhënat dhe raportet e projektit

NENI V – ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERACIONALE

Seksioni 5.01 Pengu negativ



Seksioni 5.02 Raportimi

NENI VI – TAKSAT; KUFIZIMET MBI
PAGESEN

Seksioni 6.01 Taksat

Seksioni 6.02 Kufizimet mbi pagesat

NENI VII – PEZULLIMI DHE ANULIMI;
PËRSHPEJTIMI I MATURIMIT

Seksioni 7.01 Pezullimi

Seksioni 7.02 Anulimi nga banka

Seksioni 7.03 Angazhimi për rimbursim të
pakushtëzuar të pandikuar nga pezullimi ose
anulimi

Seksioni 7.04 Detyrimet e huamarrësit dhe
garantuesit

Seksioni 7.05 Anulimi i garancisë

Seksioni 7.06 Ngjarjet e përshpejtimit

NENI VIII – ZBATUESHMËRIA;
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Seksioni 8.01 Zbatueshmëria

Seksioni 8.02 Detyrimet e garantuesit

Seksioni 8.03 Mosushtrimi i të drejtave

Seksioni 8.04 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

NENI IX – HYRJA NË FUQI;
NDËRPRERJA

Seksioni 9.01 Data e hyrjes në fuqi

Seksioni 9.02 Kushtet pararendëse për hyrjen në
fuqi

Seksioni 9.03 Mendimi juridik

Seksioni 9.04 Përfundimi për moshyrjen në fuqi

Seksioni 9.05 Përfundimi mbi performancën

NENI X – NJOFTIMET; PËRFAQËSUESIT
E AUTORIZUAR; AMENDIMI

Seksioni 10.01 Njoftimet

Seksioni 10.02 Autoriteti për të vepruar

Seksioni 10.03 Amendimi

Seksioni 10.04 Gjuha angleze

Neni I

Aplikimi i Termave dhe Kushteve Standardë

Seksioni 1.01 Aplikimi i Termave dhe i Kushteve Standardë

a) Çdo marrëveshje e Bankës në lidhje me një hua, garanci ose mjet tjetër financiar për ose të garantuara nga një anëtar i Bankës, mund të parashikojë që palët në atë marrëveshje të pranojnë dispozitat e këtyre Termave dhe Kushteve Standardë. Në masën e parashikuar në çdo marrëveshje të tillë, këta Terma dhe Kushte

Standardë do të zbatohen lidhur me marrëveshjen, me të njëjtën forcë dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në marrëveshje. Asnjë revokim ose ndryshim i këtyre Termave dhe Kushteve Standardë nuk do të jetë me efekt në lidhje me ndonjë marrëveshje të tillë, përveç nëse palët në atë marrëveshje bien dakord në këtë mënyrë.

b) Në rastin kur:

i. Marrëveshja e Huas është ndërmjet Bankës dhe një anëtar të Bankës, referencat në këta Terma dhe Kushte Standardë për “Garantuesin”, “Marrëveshjen e Garancisë” dhe “Përfaqësuesin e Autorizuar të Garantuesit” nuk do të merren parasysh;

ii. nuk ka një Marrëveshje të Projektit, referencat në këta Terma dhe Kushte Standardë për “Marrëveshjen e Projektit” nuk do të merren parasysh; dhe

iii. i gjithë projekti duhet të kryhet nga Huamarrësi, referencat në këta Terma dhe Kushte Standardë për “Subjektin e Projektit” nuk do të merren parasysh.

Seksioni 1.02 Mospërputhja me Marrë- veshjet e Huas dhe Marrëveshjet e Garancisë

Nëse një dispozitë e një marrëveshjeje të përmendur në seksionin 1.01(a) nuk është në përputhje me një parashikim të këtyre Termave dhe Kushteve Standardë, do të mbizotërojë parashikimi i një marrëveshjeje të tillë.

Neni II

Referencat dhe titujt; përkufizimet

Seksioni 2.01 Interpretimi

a) Referencat në këta Terma dhe Kushte Standardë për nenet ose seksionet janë për nenet ose seksionet e këtyre Termave dhe Kushteve Standardë.

b) Në këta Terma dhe Kushte Standardë ose në një marrëveshje për të cilën zbatohen këta Terma dhe Kushte Standardë, përveç nëse konteksti kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë njëjtesin përfshijnë shumësin dhe anasjelltas, fjalët që tregojnë personat përfshijnë korporatat, partneritetet dhe personat e tjerë juridikë dhe referencat për një person përfshijnë pasardhësit e tij dhe transferimet e lejuara.

c) Në këta Terma dhe Kushte Standardë ose në një marrëveshje për të cilën zbatohen këta Terma



dhe Kushte Standardë, titujt e neneve dhe seksioneve, si dhe tabela e përmbajtjes, futen vetëm për lehtësi referimi dhe nuk përdoren për të interpretuar këta Terma dhe Kushte Standardë ose marrëveshje të tilla.

Seksioni 2.02 Përkufizimet

Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme, kudo ku përdoren në këta Terma dhe Kushte Standardë ose në një marrëveshje për të cilën zbatohen këta Terma dhe Kushte Standardë:

“Bashkëpunëtor”, siç përdoret në lidhje me ndonjë person, nënkupton çdo person tjetër që kontrollon drejtpërdrejt ose indirekt, kontrollohet nga ose është nën kontrollin e përbashkët me një person të tillë.

“Marrëveshja e Themelimit të Bankës” nënkupton Marrëveshjen e Themelimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të datës 29 maj 1990.

“Asete” përfshin pasurinë, të ardhurat ose pretendimet e çdo lloji.

“Shuma e Disponueshme” nënkupton shumën e Huas që, herë pas here, nuk është anuluar ose tërhequr ose nuk i nënshtrohet një Angazhimi për Rimbursim të kushtëzuar ose të pakushtëzuar.

“Banka” nënkupton Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

“Përfaqësuesi i Bankës” nënkupton një person i cili është një punonjës i Bankës ose një konsulent, agjent ose përfaqësues i angazhuar nga Banka.

“Huamarrësi” nënkupton palën të cilit i jepet huaja në përputhje me Marrëveshjen e Huas.

“Përfaqësuesi i autorizuar i Huamarrësit” nënkupton personin e përcaktuar si i tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Ditë Pune” nënkupton një ditë (përveç ditës së shtunë ose të diel) në të cilën: i. kur valuta e Huas është USD ose £, bankat tregtare janë të hapura për transaksionin e biznesit të përgjithshëm (duke përfshirë veprimet në këmbimin e huaj dhe depozitimet në valutën e huaj) në Londër, Angli dhe mbi të cilat bankat tregtare dhe tregjet e këmbimit valutor vendosin pagesa në Valutën e Huas në qendrën kryesore financiare të vendit të emetimit të një valute të tillë; ose ii. kur valuta e Huas është euro, bankat tregtare janë të hapura për transaksionin e biznesit të përgjithshëm (duke përfshirë veprimet në këmbimin e huaj dhe

depozitimet në valutën e huaj) në Londër, Angli dhe që është një Ditë Target.

“Kategoria” nënkupton një kategori artikujsh që duhet të financohen nga të ardhurat e Huas, siç parashikohet në Marrëveshjen e Huas.

“Detyrimet” nënkupton detyrimet, komisionet, tarifat, primet, kostot e Marrëveshjeve të Mëparshme dhe interesin e vonuar në lidhje me Huan.

“Bashkëfinancues” nënkupton financuesin (përveç Bankës) të referuar në seksionin 7.01(a)(x), i cili siguron bashkëfinancimin; nëse Marrëveshja e Huas specifikon më shumë se një financues të tillë; “Bashkëfinancues” i referohet veçmas secilit prej këtyre financuesve.

“Bashkëfinancim” nënkupton financimin e referuar në seksionin 7.01(a)(x) dhe të specifikuar në Marrëveshjen e Huas të parashikuar ose që do të parashikohet për Projektin nga Bashkëfinancuesi. Nëse Marrëveshja e Huas specifikon më shumë se një financim të tillë; “Bashkëfinancimi” i referohet veçmas secilit prej këtyre financimeve.

“Marrëveshja e Bashkëfinancimit” nënkupton marrëveshjen e përmendur në seksionin 7.01(a)(x)(A), që parashikon bashkëfinancimin.

“Afati i bashkëfinancimit” nënkupton datën e referuar në seksionin 7.01(a)(x)(A) dhe të specifikuar në Marrëveshjen e Huas me të cilën Marrëveshja e Bashkëfinancimit do të bëhet efektive. Nëse Marrëveshja e Huas specifikon më shumë se një datë të tillë; “Afati i Bashkëfinancimit” i referohet veçmas secilës datë të tillë.

“Tarifa e angazhimit” nënkupton tarifën e angazhimit të specifikuar në seksionin 3.05(a).

“Kontrolli”, siç përdoret në lidhje me çdo person ose subjekt (duke përfshirë, me kuptimet e lidhura, termat “kontrolluar nga”, “duke kontrolluar” dhe “nën kontroll të përbashkët me”) nënkupton zotërimin, drejtpërdrejt ose indirekt, të autoritetit për të drejtuar ose për të marrë masa për drejtimin e menaxhimit dhe politikave të një personi apo subjekti të tillë, përmes pronësisë së aksioneve me të drejtë vote ose me kontratë ose ndryshe.

“Valuta” nënkupton valutën e ligjshme të një vendi që është tender ligjor për pagimin e borxheve publike dhe private në atë vend.

“Data e Përcaktimit të Kamatëvonesës” nënkupton, kur valuta është USD, për çdo



Periudhë Interesi të Kamatëvonesës, data dy Ditë Bankare në Londër para ditës së parë të Periudhës së tillë të Kamatëvonesës (ose, në opsionin e Bankës, dita e parë e një Periudhe Kamatëvonesë), ose kur valuta është £, për çdo Periudhë Kamatëvonesë, dita e parë e një Periudhe të tillë Kamatëvonesë, ose kur valuta është euro, për çdo Periudhë Kamatëvonesë, data dy Ditë Pune para ditës së parë të një Periudhe të tillë Kamatëvonesë.

“Periudha e Kamatëvonesës” nënkupton, në lidhje me çdo shumë të vonuar sipas Marrëveshjes së Huas, një periudhë që fillon në ditën kur kjo pagesë bëhet e kërkueshme ose, sipas rastit, në ditën e fundit të Periudhës së mëparshme të Kamatëvonesës, në lidhje me këtë shumë të vonuar dhe duke përfunduar në një ditë pune të zgjedhur nga Banka.

“Veprimi i nxjerrjes së informacionit” nënkupton një veprim të tillë, siç përcaktohet në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës.

“Dollar” ose “USD” nënkupton valutën e ligjshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

“Shuma e Aksesueshme” nënkupton përdorimin e një pjese të Shumës në Dispozicion nga Huamarrësi përmes një pagese ose pagesave të bërë nga Banka për Huamarrësin ose sipas urdhrit të Huamarrësit.

“Manuali i BERZH-it për disbursimet” nënkupton manualin e disbursimit të Bankës, i ndryshuar herë pas here nga Banka.

“Rregullat e prokurimit të BERZH-it” nënkupton Politikën dhe Rregullat e prokurimit për projektet e financuara nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të ndryshuara herë pas here nga Banka.

“Data e Hyrjes në Fuqi” nënkupton datën kur Marrëveshja e Huas hyn në fuqi në përputhje me nenin 9.01.

“Veprimi i zbatimit” nënkupton një veprim të tillë, siç përcaktohet në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës.

“Politik dhe procedurat e zbatimit” nënkupton Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës, në fuqi nga data e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, të ndryshuar herë pas here, dhe çdo politikë ose procedurë e miratuar nga Banka si pasuese ose zëvendësuese e këtyre politikave dhe procedurave.

“Euro”, “EUR” ose “€” nënkupton valutën e ligjshme të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, që miratojnë valutën e vetme në përputhje me

legjislacionin e Bashkimit Evropian, lidhur me unionin ekonomik dhe monetar.

“Borxhi i jashtëm” nënkupton çdo borxh, i cili është ose mund të bëhet i pagueshëm në një mjet të ndryshëm nga valuta e anëtarit.

“Norma fikse e interesit” nënkupton normën e interesit të pagueshme mbi Huan, herë pas here, në përputhje me seksionin 3.04(d).

“Komisioni fillestar” nënkupton komisionin fillestar të specifikuar në seksionin 3.05(b).

“Marrëveshja e Garancisë” nënkupton marrëveshjen ndërmjet Bankës dhe një anëtarit të Bankës, që siguron garantimin e Huas, ku kjo marrëveshje mund të ndryshohet herë pas here; dhe ky term përfshin këta Terma dhe Kushte Standardë të aplikuar në marrëveshje, të gjitha skedulet e Marrëveshjes së Garancisë dhe të gjitha marrëveshjet shtesë, ose të përfshira në objektin e Marrëveshjes së Garancisë.

“Garantuesi” nënkupton anëtarin e Bankës që është palë në Marrëveshjen e Garancisë.

“Përfaqësuesi i autorizuar i Garantuesit” nënkupton personin e caktuar si të tillë në Marrëveshjen e Garancisë.

“Shtimi i borxhit” përfshin pohimin ose garancinë e borxhit dhe çfarëdo rinovimi, zgjatje ose modifikimi të kushteve të borxhit ose të pohimit ose të garancisë së tij.

“Data e konvertimit të interesit” nënkupton një datë të pagesës së interesit të zgjedhur nga Huamarrësi si të tillë në përputhje me seksionin 3.04(c)(ii).

“Periudha e konvertimit të interesit” nënkupton një periudhë të paktën 1 (një) vit, duke filluar nga një Datë e Pagesës së Interesit dhe përfunduar në një Datë të Pagesës së Interesit të zgjedhur nga Huamarrësi si të tillë në përputhje me seksionin 3.04(c)(ii).

“Data e Përcaktimit të Interesit” nënkupton, kur valuta është USD, për çdo Periudhë Interesi, data dy Ditë Bankare në Londër para ditës së parë të Periudhës së tillë të Interesit ose, kur valuta është £, për çdo Periudhë Interesi, dita e parë e një Periudhe të tillë Interesi, ose ku valuta është euro, për çdo Periudhë Interesi, data dy Ditë Pune para ditës së parë të kësaj Periudhe Interesi ose një ditë e përcaktuar ndryshe në Marrëveshjen e Huas.

“Data e Caktimit të Interesit” nënkupton, kur valuta është USD, për çdo Periudhë të Konvertimit të Interesit të zgjedhur nga Huamarrësi si të tillë, në



përputhje me seksionin 3.04(c)(ii), një Ditë Bankare në Londër, të paktën dy Ditë Bankare në Londër përpara ditës së parë të një Periudhe të tillë të Konvertimit të Interesit, ose ku valuta është £, për çdo Periudhë të Konvertimit të Interesit të zgjedhur nga Huamarrësi si të tillë në përputhje me Seksionin 3.04(c)(ii), Dita Bankare në Londër përpara ditës së parë të Periudhës së tillë të Konvertimit të Interesit (ose, sipas opsionit të Huamarrësit, dita e parë e Periudhës së tillë të Konvertimit të Interesit), ose kur valuta është euro, për çdo Periudhë të Konvertimit të Interesit të zgjedhur nga Huamarrësi si të tillë në përputhje me seksionin 3.04(c)(ii), një Ditë Pune të paktën dy Ditë Pune para ditës së parë të një Periudhe të tillë të Konvertimit të Interesit.

“Data e Pagesës së Interesit” nënkupton çdo ditë që bie në një nga datat e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për pagimin e interesit mbi Huan, megjithatë, me kusht që, nëse ndonjë Datë e Pagesës së Interesit do të binte në një ditë që nuk është një Ditë Pune, kjo Datë e Pagesës së Interesit do të ndryshohet në Ditën vijuese të Punës në të njëjtin muaj kalendarik ose, nëse nuk ka ndonjë Ditë vijuese të Punës në të njëjtin muaj kalendarik, Dita e Punës që i paraprin menjëherë.

“Periudha e Interesit” nënkupton, për çdo Shumë të Aksesueshme, periudha që fillon në datën e një Shume të tillë të Aksesueshme dhe përfundon në Ditën tjetër të Pagesës së Interesit, dhe çdo periudhë pas kësaj duke filluar në një Datë për Pagesën e Interesit dhe përfunduar në Datën tjetër të Pagesës së Interesit, me kusht që, nëse kjo Shumë e Aksesueshme është bërë më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune para Datës tjetër të Pagesës së Interesit, Periudha e parë e Interesit për një Shumë të tillë të Aksesueshme do të fillojë në Datën e një Shume të tillë të Aksesueshme dhe përfundon në Datën e Pagesës së Interesit pas Datës tjetër të Pagesës së Interesit.

“Norma e Interesit” nënkupton Normën Fikse të Interesit ose Normën e Ndryshueshme të Interesit, ose të dyja, siç specifikohet në Marrëveshjen e Huas ose, kur Norma Fikse e Interesit përcaktohet në përputhje me seksionin 3.04(c), në njoftimin nga Banka për Huamarrësin dhe Garantuesin, të lëshuar në përputhje me nenin 3.04(c)(iii).

“Data e Fundit e Disponueshmërisë” nënkupton datën e specifikuar si të tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Barra” përfshin hipotekat, pengjet, tarifet, privilegjet dhe përparësitë e çdo lloji dhe çdo angazhimi që ka një efekt të barasvlershëm.

“Huaja” nënkupton Huan e parashikuar në Marrëveshjen e Huas.

“Marrëveshja e Huas” nënkupton marrëveshjen e Huas për të cilën zbatohen këta Terma dhe Kushte Standardë, ku një marrëveshje e tillë mund të ndryshohet herë pas here; dhe ky term përfshin këta Terma dhe Kushte Standarde, siç zbatohen në marrëveshje, të gjitha skedulet e Marrëveshjes së Huas dhe të gjitha marrëveshjet plotësuese të Marrëveshjes së Huas.

“Valuta e Huas” nënkupton Valutën ose Valutat me të cilat Huaja emërtohet, siç specifikohet në Marrëveshjen e Huas.

“Data e Shlyerjes së Huas” nënkupton çdo ditë që bie në një nga datat e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për shlyerjen e principalit të Huas, megjithatë, me kusht që, nëse ndonjë Datë e Shlyerjes së Huas do të binte në një ditë që nuk është Ditë Pune, kjo Datë e Shlyerjes së Huas do të ndryshohet në Ditën tjetër të Punës në të njëjtin muaj kalendarik ose, nëse nuk ka ndonjë Ditë Pune vijuese në të njëjtin muaj kalendarik, Dita e Punës që i paraprin menjëherë.

“Dita Bankare në Londër” nënkupton një ditë (përveç ditës së shtunë ose të diel) ku bankat tregtare janë të hapura për transaksionet e biznesit të përgjithshëm (duke përfshirë veprimet në këmbimin e huaj dhe depozitimet në valutë të huaj) në Londër, Angli.

“Marzhi” nënkupton një për qind (1%) në vit.

“Ngjarje e Prishjes së Tregut” nënkupton:

a) në Datën e Përcaktimit të Interesit për Periudhën përkatëse të Interesit ose Datën e Përcaktimit të Kamatëvonesës për Periudhën përkatëse të Kamatëvonesës (në secilin rast gjatë ose jo gjatë një periudhe në të cilën e gjitha ose ndonjë pjesë e Huas i nënshtrohet një Norme Fikse Interesi), Faqja e Referencës nuk është në dispozicion dhe asnjë ose vetëm një nga bankat kryesore aktive, sipas rastit, tregu ndërbankar i Londrës (për USD ose £) ose Tregu ndërbankar i Zonës Euro (për euro) i jep një normë Bankës për të përcaktuar Normën Përkatëse të Interesit të Tregut për Valutën e Huas për Periudhën përkatëse



të Interesit ose normën e Kamatëvonesës për Valutën e Huas për Periudhën përkatëse të Kamatëvonesës, sipas rastit; ose

b) përpara mbylljes së ditës së punës në Londër në Datën e Përcaktimit të Interesit për Periudhën përkatëse të Interesit ose Datën e Përcaktimit të Kamatëvonesës për Periudhën Përkatëse të Kamatëvonesës (në secilin rast gjatë ose jo gjatë një periudhe në të cilën e gjitha ose një pjesë e Huas i nënshtrohet një Normë Fikse të Interesit), Banka përcakton se kostoja për Bankën për marrjen e depozitimeve përjasëse, sipas rastit, tregu ndërbankar i Londrës (për USD ose £) ose tregu ndërbankar i Zonës Euro (për euro), do të ishte në tejkallim të Normës Përkatëse të Interesit të Tregut.

“Anëtar” nënkupton anëtarin e Bankës që është palë në Marrëveshjen e Huas ose Marrëveshjen e Garancisë ose ndonjë marrëveshje tjetër të referuar në seksionin 1.01(a).

“Shuma Minimale e Anulimit” nënkupton shumën e specifikuar si të tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Shuma Minimale e Aksesueshme” nënkupton shumën e specifikuar si të tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Shuma Minimale e Parapagimit” nënkupton shumën e specifikuar si të tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Paund” ose “£” nënkupton valutën e ligjshme të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.

“Praktikë e Ndalar” nënkupton një Praktikë Shtrënguese, një Praktikë Bashkëpunimi, një Praktikë Korrutive, një Praktikë Mashtrimi, një Keqpërdorim i Burimeve të Bankës ose Aseteve të Bankës, një Praktikë Penguese ose një Vjedhje, secila siç përcaktohet në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit në fuqi në kohën kur është nënshkruar Marrëveshja e Huas.

“Projekti” nënkupton projektin për të cilin jepet Huaja, siç përshkruhet në Marrëveshjen e Huas ose Marrëveshjen e Garancisë, ku ky përshkrim mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje ndërmjet palëve.

“Marrëveshja e Projektit” nënkupton çdo Marrëveshje të Projektit, nëse ka, të përshkruar në Marrëveshjen e Huas ose Marrëveshjen e Garancisë, ku kjo marrëveshje mund të ndryshohet herë pas here; dhe një term i tillë përfshin këta Terma dhe Kushte Standardë të aplikueshëm për

to, të gjitha skedulet për një Marrëveshje të tillë të Projektit dhe të gjitha marrëveshjet plotësuese të një Marrëveshje të tillë Projekti.

“Mekanizmi i Ankesave të Projektit” nënkupton mekanizmin e përgjegjësishë së Bankës, siç përcaktohet në Mekanizmin e Ankesave të Projektit (PCM), Rregulloren e Procedurave të datës maj 2014, ku rregulla të tilla mund të ndryshohen, plotësohen ose zëvendësohen herë pas here.

“Subjekti i Projektit” nënkupton çdo subjekt, të specifikuar si të tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Përfaqësuesi i Autorizuar i Subjektit të Projektit” nënkupton, në lidhje me çdo Subjekt të Projektit, personin e përcaktuar si të tillë në çdo Marrëveshje të Projektit.

“Asetet publike” nënkupton asetet e Anëtarit, të çfarëdo nënndarje politike ose administrative të tij dhe të çdo subjekti në pronësi dhe të kontrolluar nga, ose që vepron për llogari ose përfitim të Anëtarit ose çdo nënndarje të tillë, duke përfshirë asetet e arit dhe të këmbimit të huaj të mbajtura nga çdo institucion që kryen funksionet e një banke qendrore ose fondi për stabilizimin e këmbimit, ose funksione të ngjashme, për Anëtarin.

“Faqja e referencës” nënkupton paraqitjen: i. për Huat e shprehura në USD ose £, normat ndërbankare të ofruara të Londrës të bankave kryesore për depozitimet në Valutën e Huas të përcaktuara si faqet LIBOR01 dhe LIBOR02 në shërbimet *Thomson Reuters* (ose faqe tjetër e tillë që mund të zëvendësojë faqet LIBOR01 dhe LIBOR02 në shërbimet *Thomson Reuters* për qëllim të prezantimit të normave ndërbankare të ofruara të Londrës për depozitimet në Valutën e Huas); dhe ii. për Huat e shprehura në euro, normat ndërbankare të ofruara të Zonës Euro për depozitimet në Valutën e Huas, të përcaktuara si faqja EURIBOR01 në Shërbimet *Thomson Reuters* (ose faqe tjetër që mund të zëvendësojë EURIBOR01 në shërbimet *Thomson Reuters* për qëllimin e paraqitjes së normave të ofruara ndërbankare të Zonës Euro për depozitimet në Valutën e Huas).

“Angazhimi për Rimbursim” nënkupton një angazhim të referuar në seksionin 3.02 dhe mund të jetë një “Angazhim për Rimbursim të kushtëzuar” ose një “Angazhim për Rimbursim të pakushtëzuar”, sikurse ata terma përdoren në atë seksion.



“Norma Përkatëse e Interesit të Tregut” nënkupton normën e interesit të specifikuar në seksionin 3.04.

“Statutet” nënkupton, në lidhje me Huamarrësin (nëse nuk është një anëtar i Bankës) ose një Subjekt i Projektit, statuti i tij i themelimit, akt, vendim, akt themelues ose instrument tjetër të ngjashëm, siç mund të përcaktohet në mënyrë më specifike në Marrëveshjen e Huas ose secilën Marrëveshje të Projektit.

“Filial” nënkupton, në lidhje me ndonjë subjekt, çdo subjekt tjetër, ku mbi pesëdhjetë për qind (50%) e kapitalit të të cilit është në pronësi, drejtpërdrejt ose indirekt, nga një subjekt i tillë ose përndryshe kontrollohet në mënyrë efektive nga një subjekt i tillë.

“Ditë TARGET” nënkupton çdo ditë në të cilën sistemi Transvropian i Transferimit Ekspres të Shlyerjes Bruto të Automatizimit në Kohë Reale është i hapur për shlyerjen e pagesave në Euro.

“Taksat” nënkupton, pa kufizim, detyrimet, taksat, tarifat dhe tatimet e çdo lloji, qofshin në fuqi në datën e Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose ndonjë Marrëveshje të Projektit ose më pas e vendosur në territorin e Anëtarit.

“Kësti” nënkupton një pjesë të Huas të identifikuar si e tillë në Marrëveshjen e Huas.

“Kostot e marrëveshjeve të mëparshme” nënkupton:

I. Sipas paragrafit II më poshtë, shuma nga e cila Ndarja Origjinale e të Ardhurave tejkalon Ndarjen Zëvendësuese të të Ardhurave, ku:

a) “Ndarja Origjinale e të Ardhurave” nënkupton agregatin e vlerave aktuale të pagesave të principalit dhe interesin që do të ishte bërë e kërkueshme për Bankën në pjesën e Huas e cila i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit gjatë Periudhës së Llogaritjes (siç përcaktohet më poshtë), nëse ky parapagim, përshpejtim ose anulim nuk do të kishte ndodhur dhe nëse interesi nuk do të ishte shtuar në një pjesë të tillë të Huas në Normën Fikse (siç përcaktohet më poshtë) gjatë periudhave në të cilat Norma Fikse e Interesit është në fuqi, në përputhje me seksionin 3.04(d) dhe duke zbatuar Normën e Ndryshueshme të zbatueshme për të gjitha periudhat e tjera.

b) “Ndarja zëvendësuese e të ardhurave” nënkupton shumën e:

1. Agregatit të vlerave aktuale të çdo pagese të mbetur të principalit dhe të interesit, i cili, pas

marjes në konsideratë të një parapagimi, anulimi ose përshpejtimi të tillë, do të bëhej e pagueshme për Bankën në pjesën e Huas që i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit gjatë Periudhës së Llogaritjes, nëse interesi do të ishte shtuar në këtë pjesë të Huas në Normën Fikse gjatë periudhave në të cilat Norma Fikse e Interesit është në fuqi në përputhje me seksionin 3.04(d) dhe duke zbatuar Normën e zbatueshme të Ndryshueshme për të gjitha periudhat e tjera; dhe

2. Sikurse është e zbatueshme:

A. Në rastin e një parapagimi, në përputhje me seksionin 3.07, vlera aktuale e shumës së Huas, e cila i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit dhe e cila duhet të parapaguhet, përcaktohet duke zbritur këtë shumë nga data kur një parapagim i tillë bëhet i kërkueshëm për Datën e Llogaritjes (siç përcaktohet më poshtë) në Normën e Zbritjes (siç përcaktohet më poshtë); dhe/ose

B. Në rastin e ndonjë parapagimi tjetër, shuma e Huas e cila i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit dhe e cila është parapaguar; dhe/ose

C. Në rastin e një përshpejtimi, vlera aktuale e shumës së Huas, e cila i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit dhe e cila është përshpejtuar, e përcaktuar duke zbritur një shumë të tillë nga data kur një përshpejtim i tillë bëhet efektive në Datën e Llogaritjes në Normën e Zbritjes; dhe/ose

D. Në rast të një anulimi, vlera aktuale e shumës së Huas e cila i nënshtrohet Normës Fikse të Interesit dhe e cila është anuluar, e përcaktuar duke zbritur një shumë të tillë nga Data e Fundit e Disponueshmërisë në Datën e Llogaritjes në Normën e Zbritjes.

c) “Norma fikse” nënkupton Normën Fikse të Interesit minus diferencën.

d) Për qëllime të paragrafëve (I)(a) dhe (I)(b)(1) më lart, vlera aktuale e secilës pagesë të principalit dhe interesit përcaktohet duke zbritur shumën e kësaj pagese nga data e tij e kërkueshme deri në Datën e Llogaritjes, duke përdorur Normën e Zbritjes.

e) “Data e llogaritjes” nënkupton:

1. Në rastin e një parapagimi në përputhje me seksionin 3.07, data dy Ditë Pune para datës kur ky parapagim bëhet i kërkueshëm ose, në opsionin e Bankës, data kur ky parapagim bëhet i kërkueshëm;

2. Në rastin e ndonjë parapagese tjetër, data kur bëhet një parapagim i tillë ose një datë e tillë e



mëvonshme, siç mund të zgjedhë Banka, sipas gjykimit të saj; dhe

3. Në rastin e një përshpejtimi ose anulimi, data dy Ditë Pune para datës kur një përshpejtim ose anulim i tillë bëhet efektiv ose, në opsionin e Bankës, data kur një përshpejtim ose anulim i tillë bëhet efektiv.

f) “Periudha e Llogaritjes” nënkupton:

1. Në rastin e një parapagimi në përputhje me seksionin 3.07, periudha që fillon në datën kur ky parapagim bëhet i kërkueshëm dhe përfundon në Datën përfundimtare të Shlyerjes së Huas;

2. Në rastin e ndonjë parapagimi tjetër, periudha që fillon në datën kur bëhet një parapagim i tillë ose një datë e tillë e mëvonshme, siç mund të zgjedhë Banka në diskrecionin e saj, dhe që përfundon në Datën përfundimtare të Shlyerjes së Huas; dhe

3. Në rastin e një përshpejtimi ose anulimi, periudha që fillon në datën kur një përshpejtim ose anulim i tillë bëhet efektiv dhe përfundon në Datën përfundimtare të Shlyerjes së Huas.

g) “Norma e Zbritjes” nënkupton faktorin e zbritjes për maturimin përkatës që rrjedh nga kurba e këmbimit për Valutën e Huas, e cila është në dispozicion për Bankën në kurbën e këmbimit të interesit dhe tregun e opsioneve në Datën e Llogaritjes.

h) “Norma e Luhatjes” nënkupton normat e ardhshme, të zbatueshme, për USD, £ ose Euro, për maturimet përkatëse në dispozicion të Bankës në këmbimin e normës së interesit dhe tregun e opsioneve në Datën e Llogaritjes.

II. Pavarësisht nga paragrafi “I” më lart, “Kostot e Marrëveshjeve të Mëparshme” nënkupton, në lidhje me çdo shtyrje të Datës së Fundit të Disponueshmërisë (siç mund të bihet dakord nga Banka, në përputhje me Marrëveshjen e Huas) për çdo pjesë të Huas, e cila i nënshtrohet një Norme Fikse Interesi, ku një shumë e tillë, herë pas here, njoftohet nga Banka për Huamarrësin dhe Garantuesin me shkrim.

“Norma e Ndryshueshme e Interesit” nënkupton normën e interesit të pagueshëm për Huan, herë pas here, në përputhje me seksionin 3.04 (b).

Neni III

Shumat e Aksesueshme; angazhimet për rimbursim; interesi dhe detyrime të tjera; shlyerja

Seksioni 3.01. Shumat e Aksesueshme

Huamarrësi mund të tërheqë nga Shuma e Disponueshme, herë pas here, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas dhe sipas dispozitave të mëposhtme:

a) Data e fundit e disponueshmërisë

E drejta e Huamarrësit për të tërhequr nga Shuma në Dispozicion do të bëhet efektive në Datën e Hyrjes në Fuqi dhe do të përfundojë në Datën e Fundit të Disponueshmërisë ose në një datë të tillë të mëvonshme, siç mund të vendosë Banka pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi (ku një kërkesë e tillë, kur ka një Marrëveshje Garancie, do të nënshkruhet ose ndryshe aprovohet nga Garantuesi). Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për një datë të tillë të mëvonshme.

b) Aplikimet për Shumat e Aksesueshme

i. Për të bërë një Shumë të Aksesueshme, duhet të dorëzohet një kërkesë për shumë të aksesueshme te Banka nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit. Çdo kërkesë e paraqitur për shumë të aksesueshme do të jetë në përputhje dhe në formën e përshkruar nga Manuali i Disbursimit i BERZH-it dhe dorëzohet në Bankë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) Ditë Pune para datës së vlerës së propozuar të Shumës së Aksesueshme. Çdo kërkesë për shumë të aksesueshme do të jetë në thelb e pranueshme nga Banka dhe do të shoqërohet me dokumente të tilla dhe dëshmi të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje, për të bindur Bankën që Huamarrësi ka të drejtë të marrë Shumën e Aksesueshme dhe se Shuma e Aksesueshme do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.

ii. Me përjashtim të Shumës së fundit të Aksesueshme ose nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, Shumat e Aksesueshme duhet të bëhen në shuma jo më pak se Shuma minimale e Aksesueshme.

c) Valuta e Shumave të Aksesueshme

Shumat e Aksesueshme do të bëhen në Valutën e Huas në një shumë ekuivalente me shpenzimet



që do të financohen nga të ardhurat e Huas. Në rastin e shpenzimeve të bëra në një Valutë ose Valuta të ndryshme nga Valuta e Huas, Shuma e barasvlershme e Aksesueshme përcaktohet si më poshtë:

i. nëse Huamarrësi kërkon pagesë në Valutën e Huas, Banka do të përcaktojë shumën ekuivalente të Shumës së Aksesueshme dy Ditë Pune para kryerjes së pagesës;

ii. nëse Huamarrësi kërkon pagesë në Valutën ose Valutat e shpenzimeve, Banka do të blejë Valutë ose Valuta të tilla, në një mënyrë të tillë që Banka mund ta konsiderojë të përshtatshme, me kusht që këto shpenzime të jenë në Valuta të disponueshme ose Valutën e Anëtarit. Shuma ekuivalente e Aksesueshme përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit që ishin ose do të ishin shkaktuar nga Banka në përdorimin e Valutës së Huas për të përmbushur kërkesën.

d) Pagesat në Valuta të Tjera

Në rrethana të veçanta, Banka mund të japë një kërkesë nga Huamarrësi që pagesa të bëhet në një Valutë ose Valuta të ndryshme nga Valuta e Huas ose valuta e shpenzimeve. Në këtë rast, Banka do të blejë Valutë ose Valuta të tilla, në atë mënyrë që Banka mund ta konsiderojë të përshtatshme. Shuma ekuivalente e Aksesueshme përcaktohet nga Banka në bazë të kostove të këmbimit që ishin ose do të ishin shkaktuar nga Banka në përdorimin e Valutës së Huas për të përmbushur kërkesën.

Seksioni 3.02 Angazhimet e rimbursimit të kushtëzuar dhe të pakushtëzuar

a) Me kërkesën e Huamarrësit, në përputhje me dispozitat e Manualit të Disbursimit të BERZH-it, Banka mund të lëshojë Angazhime të Rimbursimit të pakushtëzuar ose të kushtëzuar, për të rimbursuar pagesat e bëra nga bankat, sipas letrave të kreditit, në lidhje me shpenzimet që duhet të financohen nën Hua. Çdo rimbursim i tillë do të përbëjë një Shumë të Aksesueshme.

b) Në rastin e një Angazhimi të Rimbursimit të kushtëzuar, detyrimi i Bankës për të paguar pezullohet ose përfundon menjëherë pas çdo pezullimi ose anulimi të Huas nga Banka, në përputhje me nenin 7.01 ose 7.02.

c) Në rastin e një Angazhimi Rimbursimi të pakushtëzuar, detyrimi i Bankës për të paguar nuk ndikohet nga ndonjë pezullim ose anulim i mëvonshëm i Huas.

Seksioni 3.03 Rialokimi

a) Nëse Banka vlerëson se shumën e Huas e alokuar për ndonjë Kategori do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e rënë dakord të shpenzimeve në atë Kategori, Banka, me një njoftim për Huamarrësin (dhe, kur ekziston një Marrëveshje Garancie, për Garantuesin) mund:

i. të riallokojë, për një kategori të tillë, në masën që kërkohet për të përmbushur mungesën e vlerësuar, të ardhurat e Huas, të cilat para këtij riallokimi ishin alokuar në një Kategori tjetër dhe të cilat sipas mendimit të Bankës nuk janë të nevojshme për të përmbushur shpenzimet e tjera; dhe

ii. nëse një riallokim i tillë nuk mund të përmbushë plotësisht mungesën e vlerësuar, mund të reduktojë përqindjen e shpenzimeve që duhet të financohen në mënyrë që Shumat e mëtejshme të Aksesueshme, sipas kësaj Kategorie të mund të vazhdojnë derisa të bëhen të gjitha shpenzimet pas kësaj.

b) Në rast se bëhet një riallokim në përputhje me paragrafin (a)(i) më sipër, Huamarrësi mund të kërkojë nga Banka (ku kjo kërkesë, nëse ka një Marrëveshje Garancie, nënshkruhet ose ndryshe aprovohet nga Garantuesi) për të bërë një riallokim të mëtejshëm të një shume ekuivalente të të ardhurave të Huas për një Kategori tjetër të rënë dakord në mënyrë të ndërsjellët nga Huamarrësi dhe Banka.

Seksioni 3.04 Interesi

Me përjashtim sa parashikohet në seksionin 3.09:

a) Nëse Huaja i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi, atëherë, për qëllime të seksionit 3.04(b) më poshtë, Norma Përkatese e Interesit të Tregut, do të jetë:

i. për Periudhën e parë të Interesit të çdo Shume të Aksesueshme, norma e ofruar në vit për depozitimet në Valutën e Huas që paraqitet në faqen e Referencës që nga ora 11:00, siç zbatohet, ora lokale e Londrës (për USD ose £) ose ora lokale e Brukselit (për euro), në Datën Përkatese të Përcaktimit të Interesit për periudhën e cila është e barabartë me kohëzgjatjen e një Periudhe të tillë Interesi (ose nëse nuk paraqitet një normë e tillë në Faqen e Referencës për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e një Periudhe të tillë Interesi, por normat ("Normat e Referencës") paraqiten në Faqen e Referencës për një periudhë që është më e



shkurtër se sa dhe për një periudhë që është më e gjatë se sa kohëzgjatja e një Periudhe të tillë Interesi, Norma Përkatese e Interesit të Tregut do të jetë norma (e rrumbullakosur më pas, nëse është e nevojshme, në katër presje dhjetore) që do të ishte e zbatueshme për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e një Periudhe të tillë Interesi, siç përcaktohet përmes përdorimit të interpolimit linear, duke iu referuar Normës së Referencës që paraqitet në Faqen e Referencës, për periudhën që është periudha tjetër më e shkurtër se sa kohëzgjatja e një Periudhe të tillë Interesi dhe Norma e Referencës që paraqitet në Faqen e Referencës, për periudhën që është më e gjatë se sa kohëzgjatja e një Periudhe të tillë Interesi); dhe

i. për secilën Periudhë të mëpasshme të Interesit, norma e ofruar në vit për depozitimet në Valutën e Huas, e cila paraqitet në Faqen e Referencës që nga ora 11:00, siç zbatohet, ora lokale e Londrës (për USD ose £) ose ora lokale e Brukselit (për euro), në Datën përkatëse të Përcaktimit të Interesit për periudhën, e cila është më e afërt me kohëzgjatjen e një Periudhe të tillë Interesi (ose, nëse dy periudha janë njësoj afër kohëzgjatjes së një Periudhe të tillë Interesi, mesatarja e dy normave përkatëse),

me kushtin që:

1. Nëse, për ndonjë arsye, Norma Përkatese e Interesit të Tregut nuk mund të përcaktohet në atë kohë duke iu referuar Faqes së Referencës, Norma Përkatese e Interesit të Tregut do të jetë norma në vit të cilën Banka përcakton si mesatarja aritmetike (e rrumbullakosur më pas, nëse është e nevojshme, deri në katër presje dhjetore) të normave të ofruara në vit për depozitimet në Valutën e Huas në një shumë të krahasueshme me pjesën e Huas, sipas një Norme të Ndryshueshme Interesi, e planifikuar të mbetet e papaguar gjatë Periudhës përkatëse të Interesit, për një periudhë të barabartë me atë Periudhë të tillë Interesi, e cila u është cituar bankave kryesore, sipas rastit, në tregun ndërbankar të Londrës (për USD ose £) ose tregun ndërbankar të Zonës Euro (për euro), siç këshillohet për Bankën nga të paktën dy banka të mëdha aktive, sipas rastit, tregu ndërbankar i Londrës (për USD ose £) ose tregu ndërbankar i Zonës Euro (për euro) të zgjedhur nga Banka; dhe

2. Nëse në përputhje me termat e specifikuar në këtë seksion 3.04(a), Norma Përkatese e Interesit të

Tregut do të ishte nën zero, Norma Përkatese e Interesit të Tregut do të konsiderohet zero.

b) Nëse Huaja i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi, interesi i Huas do të përcaktohet dhe paguhet si më poshtë:

i. Shuma e principalit të Huas, herë pas here e tërhequr dhe jo e shlyer, do të ketë interes gjatë Periudhës përkatëse të Interesit në Normën e Ndryshueshme të Interesit të llogaritur në përputhje me këtë seksion.

ii. Interesi do të shtohet nga dhe duke përfshirë ditën e parë të një Periudhe Interesi, por duke përjashtuar ditën e fundit të një Periudhe të tillë Interesi, do të llogaritet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti 360 ditë (përveç nëse Valuta e Huas është Paund, ku në këtë rast do të llogaritet në bazë të një viti 365 ditë) dhe bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme në Datën e Pagesës së Interesit, e cila është dita e fundit e Periudhës përkatëse të Interesit.

iii. norma e Ndryshueshme e Interesit do të jetë shuma e Marzhit dhe sipas nenit 3.13, Norma Përkatese e Interesit të Tregut e specifikuar në seksionin 3.04(a).

iv. Në çdo Datë të Përcaktimit të Interesit, Banka do të përcaktojë Normën e Ndryshueshme të Interesit të zbatueshme për Periudhën përkatëse të Interesit dhe do të njoftojë menjëherë Huamarrësin dhe Garantuesin e saj.

c) Pavarësisht nga sa më sipër, nëse parashikohet në këtë mënyrë në Marrëveshjen e Huas, Huamarrësi, si një alternativë për pagimin e interesit në një Normë të Ndryshueshme të Interesit në të gjithë ose ndonjë pjesë të Huas të papaguar, mund të zgjedhë të paguajë interes në një Normë Fikse Interesi për një pjesë të tillë të Huas, si më poshtë:

i. Huamarrësi mund të ushtrojë një mundësi të tillë vetëm, nëse:

A. Në kohën e ushtrimit nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon asnjë ngjarje e specifikuar në seksionin 7.01 më poshtë (dhe asnjë ngjarje e cila me njoftim dhe/ose kalimin e kohës do të bëhej një ngjarje e tillë) dhe asnjë Ngjarje e Prishjes së Tregut; dhe

B. Shuma e principalit të Huas, e cila konvertohet nga një Normë e Ndryshueshme Interesi në një Normë Fikse Interesi nuk është më e vogël se ekuivalenti në Valutën e Huas prej 5,000,000 eurosh.



ii. Huamarrësi do të përdorë një mundësi të tillë duke njoftuar Bankën jo më pak se pesë ditë pune para Datës së propozuar të Caktimit të Interesit. Ky njoftim, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, është i parevokueshëm dhe specifikon Datën e Caktimit të Interesit dhe Periudhën e Konvertimit të Interesit të zgjedhur nga Huamarrësi dhe shumën e principalit të Huas që do të konvertohet në një Normë Fikse Interesi.

iii. Duke filluar nga Data e Konvertimit të Interesit, pjesa e Huas që konvertohet (siç specifikohet në njoftimin e Huamarrësit) do të jetë sipas një Norme Fikse Interesi. Për qëllimet e seksionit 3.04(d), Norma Përkatëse e Interesit të Tregut do të jetë norma e ardhshme fikse e interesit për Valutën e Huas, e cila është në dispozicion të Bankës në tregun e këmbimit të normës së interesit në një Datë të tillë të Caktimit të Interesit për një Periudhë të tillë të Konvertimit të Interesit, duke marrë parasysh shlyerjen e principalit dhe skedulet e pagesës së interesit për Huan, pasi një shumë e tillë mund të rregullohet për të marrë parasysh aftësinë e Huamarrësit për kreditim. Banka do të përcaktojë Normën Fikse të Interesit në një datë të tillë të Caktimit të Interesit dhe do të njoftojë menjëherë Huamarrësin dhe Garantuesin.

iv. Banka mund të zgjedhë në çdo kohë të konsolidojë të gjitha Normat Fikse të Interesit, të zbatueshme për pjesët e Huas, në një Normë të vetme Fikse të Interesit, e barabartë me mesataren e ponderuar të Normave Fikse të Interesit, të zbatueshme për pjesët e Huas. Banka do të përcaktojë një Normë të tillë Fikse Interesi të konsoliduar dhe do të njoftojë menjëherë Huamarrësin. Një normë e tillë Fikse Interesi e konsoliduar do të jetë e zbatueshme për të gjitha pjesët e Huas, që mbartin interesin në Normat Fikse të Interesit që fillojnë në Datën e Pagesës së Interesit, menjëherë pas njoftimit nga Banka për Huamarrësin.

d) Nëse Huaja është sipas një Norme Fikse Interesi, interesi mbi Huan do të paguhet si më poshtë:

i. Shuma e principalit të Huas herë pas here e tërhequr dhe jo e shlyer do të ketë interes gjatë Periudhës përkatëse të Interesit në Normën Fikse të Interesit, të llogaritur në përputhje me këtë seksion.

ii. Interesi do të shtohet nga dhe duke përfshirë ditën e parë të një Periudhe Interesi deri më, por

duke përjashtuar ditën e fundit të një Periudhe të tillë Interesi, do të llogaritet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti 365 ditë dhe do të bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme në Datën e Pagesës së Interesit, e cila është dita e fundit e Periudhës përkatëse të Interesit.

iii. Norma Fikse e Interesit do të jetë shuma e Marzhit dhe Norma përkatëse e Interesit të Tregut të specifikuar në Marrëveshjen e Huas ose, kur Norma Fikse e Interesit është vendosur në përputhje me nenin 3.04(c) në një datë që është më vonë se data e Marrëveshjes së Huas, në njoftimin nga Banka për Huamarrësin dhe Garantuesin, të lëshuar në përputhje me seksionin 3.04(c)(iii).

e) Nëse ka ndodhur dhe po vazhdon një ngjarje e specifikuar në seksionet 7.01(a) ose 7.06, Banka mund të zgjedhë që t'i kërkojë Huamarrësit të paguajë interes për pjesën e Huas, nëse ka ndonjë, sipas një Norme Fikse Interesi jo me një Normë të tillë Fikse Interesi, por në vend të kësaj me një Normë të Ndryshueshme Interesi.

Seksioni 3.05 Tarifa e Angazhimit dhe Komisioni fillestar

a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë angazhimi në normën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, e pagueshme në totalin e Shumës së Disponueshme plus çdo shumë të Huas, sipas një Angazhimi të Rimbursimit dhe që nuk është tërhequr akoma, me kushtin që Tarifa e Angazhimit e pagueshme për shumën e Huas, sipas një Angazhimi të Rimbursimit të pakushtëzuar do të jetë 0,5% në vit më e madhe se norma e Tarifës së Angazhimit të specifikuar në Marrëveshjen e Huas. Tarifa e Angazhimit do të shtohet nga data 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas ose, në rastin e Tarifës së Angazhimit të pagueshme në shumën e Huas, sipas një Angazhimi të Rimbursimit të pakushtëzuar, nga data e lëshimit të një Angazhimi të tillë të Rimbursimit të pakushtëzuar dhe do të shtohet dhe llogaritet në të njëjtën bazë si interesi sipas seksionit 3.04(b)(ii). Tarifa e Angazhimit do të paguhet në çdo Datë të Pagesës së Interesit (edhe pse asnjë interes nuk mund të paguhet në atë datë) që fillon në Datën e parë të Pagesës së Interesit pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

b) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një komision fillestar të barabartë me një për qind (1%) (ose një shumë tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Huas) të shumës kryesore të Huas.



c) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Huas, Banka, në emër të Huamarrësit, do të tërhiqet nga Shuma në Dispozicion në Datën e Hyrjes në Fuqi, ose brenda 7 (shtatë) ditëve pas kësaj, dhe t'i paguajë vetes shumën e Komisionit Fillestar të pagueshme në përputhje me seksionin 3.05(b).

d) Në rast se Huamarrësi vendos që sipas Marrëveshjes së Huas të paguajë Komisionin fillestar nga burimet e veta, Komisioni Fillestar do të bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm brenda 7 (shtatë) ditëve pas Datës së Hyrjes në Fuqi.

Seksioni 3.06 Pagesat nga Huamarrësi

Principali, interesi dhe Tarifatat mbi Huan do të jenë të kërkueshme dhe të pagueshme nga Huamarrësi në mënyrën dhe datat e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.

Seksioni 3.07 Parapagesa

a) Huamarrësi, në çdo Datë të Pagesës së Interesit, mund të paguajë paraprakisht të gjithë ose një pjesë të shumës së principalit të Huas së tërhequr dhe të pashlyer, së bashku me të gjithë interesin e shtuar dhe të papaguar dhe Tarifatat mbi to, në jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune me një njoftim që i dërgohet me shkrim Bankës, dhe ky njoftim do të jetë i parevokueshëm dhe i detyrueshëm për Huamarrësin.

b) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës, në datën e parapagimit, një tarifë administrative parapagimi prej një të tetës së një për qindëshit (0.125%) të shumës së principalit të Huas të papaguar.

c) Në rastin e parapagimit të pjesshëm, një parapagim i tillë:

i. nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, do të jetë në një shumë të paktën e barabartë, më pak se:

A. Shuma Minimale e Parapagimit; dhe

B. Shuma e principalit të Huas të tërhequr dhe jo të shlyer; dhe

ii. do të jetë:

A. së pari, e aplikuar për të paguar interesin dhe Tarifatat mbi Huan; dhe

B. së dyti, aplikuar në mënyrë proporcionale për disa maturime të shumës së principalit të Huas të tërhequr dhe jo të shlyer.

Seksioni 3.08 Anulimi

a) Huamarrësi mund të anulojë të gjithë ose një pjesë të Shumës së Disponueshme në çdo Datë të Pagesës së Interesit me një njoftim paraprak me shkrim për Bankën jo më pak se 30 (tridhjetë) Ditë Pune, ku ky njoftim do të jetë i parevokueshëm dhe

detyrues për Huamarrësin. Ky Anulim do të jetë në një shumë të paktën të barabartë në shumën më të ulët të:

i. Shumës Minimale të Anulimit; dhe

ii. Shumës së Disponueshme.

b) Në rast të ndonjë anulimi nga Huamarrësi në përputhje me nënparagrafin “a” të këtij seksioni ose nga Banka në përputhje me seksionin 7.02:

i. Huamarrësi do t'i paguajë Bankës, në datën e anulimit, të gjitha Tarifatat e kërkueshme dhe të papaguara që nga ajo datë dhe një tarifë anulimi prej një të tetës së një për qind (0.125%) të shumës së principalit të Huas që anulohet, përveç në lidhje me shumat e anuluar në përputhje me seksionin 7.02 (a);

ii. shuma e anuluar do të zbritet nga shuma e disponueshme e papaguar në datën e anulimit; dhe

iii. shuma e anuluar do të aplikohet proporcionalisht për maturimet e shumës së principalit të Huas që bëhet e kërkueshme pas datës së këtij anulimi.

Seksioni 3.09 Kamatëvonesa

a) Nëse Huamarrësi nuk arrin të paguajë kur është e kërkueshme ndonjë shumë të pagueshme nga ai sipas Marrëveshjes së Huas, shuma e vonuar do të ketë interes në një normë të barabartë me shumën e:

i. dy për qind (2%) në vit;

ii. diferencës; dhe

iii. normës së interesit në vit të ofruar, sipas rastit, në tregun ndërbankar të Londrës (për USD ose £) ose në tregun ndërbankar të Zonës Euro (për euro), në Datën e Caktimit të Kamatëvonesës për një depozitim në Valutën e Huas të një shume të krahasueshme për shumën e vonuar për një periudhë të barabartë me Periudhën përkatëse të Kamatëvonesës ose, nëse ka ndodhur një Ngjarje e Prishjes së Tregut, norma e cila shpreh si një normë përqindjeje në vit koston e Bankës për financimin e Huas, nga çfarëdo burimi që Banka mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme (ose sipas opsionit të Bankës, Norma përkatëse e Interesit të Tregut, nëse është e disponueshme), me kusht që nëse norma në përputhje me këtë nënparagraf “iii” do të ishte nën zero, norma do të konsiderohet të jetë zero.

b) Kamatëvonesa:

i. shtohet nga dita në ditë nga data e kërkueshme deri në datën e pagesës aktuale;



ii. llogaritet në bazë të numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti 360 ditë (përveç nëse Valuta e Huas është Paund, në këtë rast do të llogaritet në bazë të një viti 365 ditë);

iii. llogaritet në fund të çdo Periudhe të Kamatëvonesës; dhe

iv. është e kërkueshme dhe e pagueshme menjëherë sipas kërkesës.

c) Çdo përcaktim nga Banka i normave të interesit të zbatueshme për shumat e prapambetura dhe të Periudhave të Kamatëvonesës do të jetë përfundimtare, vendimtare dhe e detyrueshme për Huamarrësin.

Seksioni 3.10 Kostot e Marrëveshjeve të mëparshme

a) Nëse, për ndonjë arsye (duke përfshirë, pa kufizim, një përshpejtim në përputhje me seksionin 7.06), çdo pjesë e Huas, e cila është sipas një Norme të Ndryshueshme Interesi, bëhet e kërkueshme dhe e pagueshme në një datë tjetër nga dita e fundit e një Periudhe Interesi, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës nëse kërkohej shumën, nëse ka ndonjë, me të cilën:

1. Interesi i cili do të ishte shtuar në një pjesë të tillë të Huas nga data në të cilën kjo pjesë e Huas është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme deri në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Interesit në atë kohë, në një normë të barabartë me Normën Përkatëse të Interesit të Tregut për pjesën e tillë të Huas, për një Periudhë të tillë Interesi,

tejkalon:

2. Interesin që Banka do të mund të merrte nëse do të vendoste një shumë të barabartë me këtë pjesë të Huas në depozitim në një bankë drejtuese, sipas rastit, në tregun ndërbankar të Londrës (për USD ose £) ose tregun ndërbankar të Zonës Euro (për euro) për periudhën që fillon në datën në të cilën një pjesë e tillë e Huas është bërë e kërkueshme dhe e pagueshme dhe që përfundon në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Interesit të asaj kohe.

b) Nëse, në ndonjë moment:

1. Huamarrësi jep një njoftim, në përputhje me seksionin 3.07, për parapagimin e çdo pjese të Huas, sipas një Norme Fikse Interesi ose Huamarrësi, përndryshe parapaguan ndonjë pjesë të tillë të Huas;

2. Çdo pjesë e Huas, e cila i nënshtrohet një Norme Fikse Interesi përshpejtohet në përputhje me nenin 7.06 ose përndryshe bëhet e kërkueshme,

për shkak të maturimit të deklaruar ose i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi, në përputhje me nenin 3.04(e); ose

3. Çdo pjesë e Huas, e cila i nënshtrohet një Norme Fikse Interesi, anulohet në përputhje me nenet 3.08, 7.02 ose 7.06 ose ndryshe anulohet,

Huamarrësi, përveç çdo pagese administrative të parapagimit, tarifës së anulimit ose shumave të tjera të pagueshme në lidhje me të, do t'i paguajë Bankës, sipas kërkesës, shumën e çdo Kostoje të Marrëveshjes së Mëparshme, me kusht që, nëse shuma e këtyre Kostove të Marrëveshjeve të Mëparshme është negative, Banka, në datën tjetër të Pagesës së Interesit, do t'i kreditojë Huamarrësit, në Valutën e Huas, shumën e Kostove të tilla të Marrëveshjeve të Mëparshme.

c) Nëse ndonjë shumë e vonuar paguhet në një datë tjetër, përveç ditës së fundit të një Periudhe të Kamatëvonesës, Huamarrësi do t'i paguajë Bankës, sipas kërkesës, shumën, nëse ka ndonjë, me të cilën:

1. Interesi, i cili do të ishte shtuar në një shumë të tillë të vonuar nga data e marrjes së një shume të tillë të vonuar deri në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Kamatëvonesës në atë kohë me një normë të barabartë me normën e specifikuar në nenin 3.09(a)(iii) për këtë Periudhë të Kamatëvonesës,

tejkalon:

2. Interesin që Banka do të mund të merrte nëse do të vendoste një shumë të barabartë me një shumë të tillë të vonuar në depozitim në një bankë drejtuese, sipas rastit, në tregun ndërbankar të Londrës (për USD ose £) ose tregun ndërbankar të Zonës Euro (për euro) për periudhën që fillon në datën e marrjes së një shume të tillë të vonuar dhe që përfundon në ditën e fundit të Periudhës aktuale të Kamatëvonesës.

d) Huamarrësi do të rimbursojë menjëherë Bankën me njoftimin e Bankës, për çdo kosto, shpenzim dhe humbje të shkaktuar nga Banka, dhe jo të rikuperuar ndryshe nga Banka, sipas seksioneve 3.10(a), 3.10(b) dhe 3.10(c), si rezultat i ndodhisë së një ngjarjeje të specifikuar në seksionet 7.01 ose 7.06 më poshtë, një ndryshim në kohëzgjatjen e çdo Periudhe përkatëse të Interesit, në përputhje me nenin 3.13(b), një ndryshim në bazën për përcaktimin e normës së interesit, në përputhje me nenin 3.13(c), parapagimi i çdo pjese të Huas në një datë tjetër nga dita e fundit e një



periudhe interesi, mospërmbushja nga Huamarrësi për të paguar ndonjë shumë kur është e kërkueshme, financimi i Bankës ose marrja e masave për të financuar një Shumë të Aksesueshme të kërkuar në një kërkesë për Shumë të Aksesueshme të paraqitur, në përputhje me seksionin 3.01(b), por jo e bërë për shkak të funksionimit të ndonjë ose më shumë dispozitave të Marrëveshjes së Huas (përveç për shkak të mospërmbushjes ose neglizhencës nga Banka, sipas rastit) ose mospërmbushjes nga Huamarrësi për të bërë ndonjë parapagim, në përputhje me një njoftim të parapagimit të dorëzuar, në përputhje me ndonjë dispozitë të Marrëveshjes së Huas.

e) Një certifikatë e Bankës për çdo shumë të pagueshme, sipas këtij seksioni 3.10 do të jetë përfundimtare, vendimtare dhe e detyrueshme për Huamarrësin, nëse Huamarrësi nuk tregon për të bindur Bankën se përmban gabim të dukshëm.

Seksioni 3.11 Valuta, Forma, dhe Përcaktimi i Pagesave

a) Të gjitha pagesat e principalit, interesi, tarifat dhe çdo shumë tjetër të kërkueshme për Bankën, sipas Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Garancisë do të bëhen, pa zbritje ose mbajtje të çfarëdo lloji, pa shlyerje ose kundërkërkesë, në Valutën e Huas, për vlerën në datën e caktuar, në një bankë ose bankë të tilla, dhe në një vend apo vende të tilla, siç do të caktojë Banka herë pas here.

b) Nëse data e caktuar për ndonjë pagesë, sipas Marrëveshjes së Huas do të binte në një ditë që nuk është një Ditë Pune, atëherë kjo pagesë e tillë do të bëhet e kërkueshme në Ditën e ardhshme të Punës dhe interesi (ose Tarifa e Angazhimit, sipas rastit) do të vazhdojë të shtohet për periudhën nga kjo datë në Ditën tjetër të Punës. Me kërkesë të Huamarrësit, të rënë dakord nga Banka, kjo pagesë do të bëhet në një datë më të hershme kur palët bien dakord.

Seksioni 3.12 Tarifat dhe Kostot

Huamarrësi do të mbulojë çdo tarifë profesionale, bankare, transferimi ose këmbimi dhe shpenzime të shkaktuara nga Banka në përgatitjen, ekzekutimin, dorëzimin dhe regjistrimin e Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit dhe çdo dokumenti të lidhur.

Seksioni 3.13 Prishja e Tregut

a) Nëse ndodh një ngjarje e prishjes së tregut, Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin. Nëse

Banka njofton Huamarrësin për ndodhinë e një Ngjarjeje të Prishjes së Tregut:

1. Interesi do të shtohet në çdo pjesë të Huas që i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi në një normë të barabartë, me shumën e:

A. Diferencës; dhe

B. Normës që shpreh si një normë të përqindjes në vit koston e Bankës për financimin e Huas nga çfarëdo burimi që Banka mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme (ose, në opsionin e Bankës, Normën Përkatese të Interesit të Tregut, nëse është e disponueshme), siç njoftohet nga Banka për Huamarrësin sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast para se interesi të paguhet në lidhje me Periudhën përkatëse të Interesit; me kusht që nëse norma sipas këtij nënparagrafi “B” do të ishte nën zero, norma do të konsiderohet të jetë zero; dhe

2. Interesi do të shtohet në çdo pjesë të Huas që i nënshtrohet një Norme Fikse Interesi në një normë të barabartë me Normën Fikse të Interesit të përcaktuar, në përputhje me nenin 3.04(d), duke përfshirë marzhin,

në secilin rast derisa Banka të ketë njoftuar Huamarrësin se ngjarja e prishjes së Tregut ka pushuar së ekzistuari.

b) Nëse ka ndodhur një Ngjarje e Prishjes së Tregut, Banka do të ketë të drejtë, sipas mendimit të saj, të ndryshojë kohëzgjatjen e çdo Periudhe përkatëse të Interesit duke i dërguar Huamarrësit një njoftim me shkrim lidhur me të. Çdo ndryshim i tillë në një Periudhë të Interesit do të hyjë në fuqi në datën e specifikuar nga Banka në një njoftim të tillë.

c) Pavarësisht seksionit 3.13(a), nëse ndodh një Ngjarje e Prishjes së Tregut dhe Banka ose Huamarrësi e kërkon këtë, brenda pesë ditë pune të njoftimit të Bankës, në përputhje me seksionin 3.13(a) më lart, Banka dhe Huamarrësi do të hyjnë në negociatë (për një periudhë jo më shumë se tridhjetë ditë), me qëllim që të bien dakord për një bazë zëvendësuese për përcaktimin e normës së interesit të zbatueshme për Huan. Çdo bazë alternative e rënë dakord do të hyjë në fuqi në përputhje me kushtet e saj dhe do të zëvendësojë normën e interesit, në fuqi në atë kohë në përputhje me seksionin 3.13(a) më sipër. Nëse nuk mund të arrihet ndonjë marrëveshje, Huamarrësi mund të parapaguajë Huan në Datën tjetër të Pagesës së Interesit në përputhje me nenin 3.07, por pa ndonjë tarifë administrative parapagimi.



Neni IV Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 4.01 Bashkëpunimi dhe Informacioni

a) Banka, Huamarrësi, secili Subjekt i Projektit dhe Garantuesi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet për të cilat është dhënë Huaja do të përmbushen. Në këtë drejtim, Banka, Huamarrësi, secili Subjekt i Projektit dhe Garantuesi:

i. herë pas here, me kërkesë të ndonjërit prej tyre, do të shkëmbejnë mendime në lidhje me ecurinë e Projektit, qëllimet për të cilat është dhënë Huaja dhe përmbushjen e detyrimeve të tyre përkatëse, sipas Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë, si dhe performancën e një Subjekti të Projektit, sipas çdo Marrëveshjeje të Projektit ku është palë, dhe çdo marrëveshje e lidhur me të, dhe do t'u japin palëve të tjera të gjitha informacionet e lidhura me to, siç do të jenë kërkuar në mënyrë të arsyeshme; dhe

ii. informojnë menjëherë njëra-tjetrën për çdo kusht që ndërhyt ose kërcënon të ndërhyt, në çështjet e referuara në paragrafin “i” më sipër.

b) Huamarrësi do të informojë menjëherë Bankën për çdo ndryshim të propozuar në natyrën ose objektin e Projektit, ose biznesin, ose aktivitetet e një Subjekti të Projektit dhe për çdo ngjarje ose kusht, e cila mund të ndikojë materialisht në kryerjen e Projektit ose në ushtrimin e biznesit ose aktiviteteve të një Subjekti të Projektit.

c) Garantuesi nuk do të ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk do të lejojë asnjë nga agentët ose filialet e tij të ndërmarrin ndonjë veprim, i cili do të parandalonte ose ndërhynte në ekzekutimin e Projektit ose funksionimin efikas të objekteve të Projektit ose kryerjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas ose detyrimet e një Subjekti të Projektit, sipas një Marrëveshjeje Projekti. Garantuesi, gjithashtu, siguron që asnjë veprim i tillë të mos ndërmerret ose të lejohet të ndërmerret nga ndonjë prej nënndarjeve të tij politike, ose administrative, ose ndonjë prej subjekteve në pronësi dhe të kontrolluara nga, ose që veprojnë për llogari ose përfitim të Garantuesit ose nënndarjeve të tilla.

Seksioni 4.02 Përgjegjësitë lidhur me Ekzekutimin e Projektit

a) Huamarrësi do të zbatojë Projektin ose do të marrë masa që Projektin të zbatohet me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, në përputhje me ligjet për mjedisin, shoqërinë, shëndetin e mirë, standardet dhe praktikatat e sigurisë dhe punës, siç specifikohet në Marrëveshjen e Huas, dhe standardet dhe praktikatat e tjera përkatëse dhe do të sigurojë, kur është e nevojshme, fondet, token, objektet, shërbimet dhe burimet e tjera të kërkuara për këto qëllime.

b) Nëse ekziston një Marrëveshje e Projektit që vendos përgjegjësi të pjesshme ose të plotë për ekzekutimin e Projektit me një Subjekt të Projektit, Huamarrësi:

i. do të marrë masa që Subjekti përkatës i Projektit të kryejë, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së tillë të Projektit, të gjitha detyrimet e Subjektit të Projektit të përcaktuara në Projekt; dhe

ii. nuk do të ndërmarrë ose lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që do të parandalonte ose ndërhynte në një performancë të tillë.

c) Pa kufizuar përgjithësinë e nënseksioneve “a” ose “b” më sipër, Huamarrësi do të ndërmarrë ose do të marrë masa që të ndërmerren, të gjitha veprimet e tilla që janë të nevojshme për të marrë, siç dhe kur e nevojshme, të gjitha këto toka dhe të drejta të tilla, në lidhje me token, siç do të kërkohej për zbatimin e Projektit dhe do t'i japë Bankës, menjëherë me kërkesë të saj, dëshmi të kënaqshme për Bankën se toka dhe të drejtat e tilla, në lidhje me token janë në dispozicion për ato qëllime.

d) Huamarrësi do të sigurojë ose do të marrë masa të sigurohet ose do të bëjë parashikime të duhura të pranueshme për Bankën, për sigurimin e:

i. mallrave të importuara që do të financohen nga të ardhurat e Huas për Projektin, ndaj rreziqeve të rastësishme për blerjen, transportimin dhe dërgimin e tyre në vendin e përdorimit ose instalimit (dhe, kur është e zbatueshme, ndaj rreziqeve gjatë periudhës së ndërtimit), me zhdëmtimin, sipas një sigurimi të tillë të pagueshëm në Valutën e nevojshme për të zëvendësuar ose për të riparuar mallra të tillë; dhe

ii. të gjithë artikujve të tjerë që kanë lidhje me qëndrueshmërinë financiare ose teknologjike të Projektit dhe që janë në pronësi ose kontroll të Huamarrësit.



e) Huamarrësi do të veprojë dhe do të mirëmbajë në çdo kohë, ose do të marrë masa që të jetë në funksion dhe mirëmbahet, në gjendje të mirë pune, çdo ambient i rëndësishëm për Projektin dhe, menjëherë, kur është e nevojshme, do të bëjë ose marrë masa që të bëhen të gjitha riparimet dhe rinovimet e nevojshme.

f) Huamarrësi do të marrë masa që të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas do të përdoren ekskluzivisht për qëllimet e Projektit.

g) Huamarrësi, Garantuesi dhe çdo Subjekt i Projektit nuk duhet dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë asnjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, Bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësues, të angazhohen në ndonjë Praktikë të Ndaluar, në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e ndonjë kontrate, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas).

Seksioni 4.03 Prokurimi

a) Përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punimeve dhe shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulentëve, të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas do të rregullohet nga Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen e Huas.

b) Nëse në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, Banka vendos që Huamarrësi, Garantuesi, çdo Subjekt i Projektit, furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët ose nënkonsulentët, që konkurrojnë për ose në ekzekutimin e ndonjë marrëveshjeje në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas), është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndaluar, Banka mund të deklarojë këtë marrëveshje si të papërshtatshme për financim dhe Banka mund të ndërmarrë ndonjë nga Veprimet e Zbatimit dhe Veprimet e Nxjerrjes së Informacionit të përcaktuara në Politikën dhe Procedurat e Zbatimit.

c) Huamarrësi, Garantuesi dhe Subjekti i Projektit do të sigurojnë secili, në lidhje me ato pjesë të Projektit për të cilat ky subjekt është drejtpërdrejt përgjegjës, siç përcaktohet në

Marrëveshjen e Huas, që në dokumentet e tenderit dhe çdo kontratë në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas), të përfshihen parashikimet:

i. deklarimi se furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk duhet dhe nuk do të autorizojnë ose të lejojnë asnjë nga zyrtarët, drejtorët, punonjësit e autorizuar, Bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit e tyre të angazhohen në ndonjë Praktikë të Ndaluar në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas); dhe

ii. njoftimi për furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët se Banka ka të drejtë të kërkojë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, përfshirë çdo Veprim të Zbatimit dhe Veprimin e Nxjerrjes së Informacionit të paraqitur në të, në lidhje me pretendimet e Praktikave të Ndaluara, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas).

Seksioni 4.04 Të dhënat dhe Raportet e Projektit

a) Huamarrësi, Garantuesi dhe Subjekti i Projektit, në lidhje me ato pjesë të Projektit, për të cilat kjo njësi është drejtpërdrejt përgjegjëse, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huas:

i. do të mirëmbajnë procedurat dhe të dhënat e përshtatshme për të regjistruar dhe për të monitoruar ecurinë e Projektit (duke përfshirë koston e tij dhe përfitimet që rrjedhin prej tij), për të identifikuar të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas dhe për të identifikuar përdorimin e tyre në Projekt dhe t'i vendosin këto të dhëna në dispozicion të Përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës;

ii. do t'i japin menjëherë Bankës informacione të tilla që Banka herë pas here mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme dhe të lejojnë Përfaqësuesit e Bankës, me kërkesën e Bankës:

A. Të vizitojnë çdo objekt dhe kantier ndërtimi që kanë të bëjnë me Projektin ose ndonjë nga



mjediset e tjera ku zhvillohet aktiviteti i Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit;

B. Të kenë akses dhe të kontrollojnë çdo dhe të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas dhe çdo impiant, instalim, vendpunim, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, asete, libra, llogari, regjistra dhe dokumente të Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit, dhe të lejojnë që këto regjistrime dhe llogari të auditohen nga auditorët e Bankës; dhe

C. Të takojnë dhe të zhvillojnë diskutime me këta përfaqësues dhe punonjës të Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit, siç mund të çmojë Banka të nevojshme dhe të përshtatshme, në secilin rast, duke përfshirë, në mënyrë që: 1. Të lehtësojnë monitorimin dhe vlerësimin e Bankës lidhur me Projektin dhe t'i mundësojnë Bankës të shqyrtojë dhe trajtojë çdo ankesë, në lidhje me Projektin të bërë, sipas Mekanizmit të Ankesave të Projektit të Bankës; dhe 2. Të vlerësojnë nëse ka ndodhur një Praktikë e Ndaluar, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financiar ose të propozuar për t'u financiar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas):

iii. do të sigurojnë që në dokumentet e tenderit dhe çdo kontratë në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financiar ose të propozuar për t'u financiar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas), përfshihen dispozitat për efekt të seksionit 4.04(a)(i) dhe (ii), në lidhje me furnizuesit, nënfurnizuesit, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët;

iv. do t'u japin Përfaqësuesve të Bankës të gjitha raportet dhe informacionet që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me Projektin, duke përfshirë informacionin mbi çështjet mjedisore, sociale, shëndetësore, të sigurisë dhe punës, në lidhje me Projektin, koston e tij dhe, kur është e përshtatshme, përfitimet që do të nxirren prej tij, shpenzimi i të ardhurave të Huas dhe i të gjitha mallrave, punimeve dhe shërbimeve të financuara nga këto të ardhura;

v. pa kufizuar parimin e përgjithshëm të paragrafit (a)(iii) më sipër, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, do të sigurojnë ose marrin masa që Bankës t'i jepen raportet periodike të Projektit në një formë të pranueshme për Bankën dhe të një frekuence të specifikuar në Marrëveshjen e Huas, duke specifikuar ndër të tjera ecurinë e bërë dhe

problemet e hasura gjatë periudhës në shqyrtim, hapat e ndërmarrë ose të propozuar për t'u ndërmarrë për të korrigjuar ato probleme dhe programin e propozuar të aktiviteteve dhe ecurinë e pritur gjatë periudhës vijuese; dhe

vi. do t'u japin ose do të marrin masa që Përfaqësuesve të Bankës t'u jepen menjëherë, pasi të përgatiten, çdo plan, specifikim, raport, dokumentet e kontratës dhe skedulet e ndërtimit dhe të prokurimit për Projektin, dhe çdo modifikim material të tij ose shtesa të tij, në detaje të tilla siç do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme Banka.

b) Pas dhënies së ndonjë kontrate për mallra, punime ose shërbime që do të financohen nga të ardhurat e Huas, Banka mund të publikojë një përshkrim të tyre, emrin dhe shtetësinë e palës së cilës i është dhënë kontrata dhe çmimin e kontratës.

c) Menjëherë pasi:

i. Projekti të ketë përfunduar; ose

ii. kur shuma e plotë e Huas është tërhequr ose anuluar, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas Datës së Fundit të Disponueshmërisë ose në një datë të tillë të mëvonshme, siç mund të bjerë dakord Banka;

Huamarrësi do të përgatisë dhe paraqesë në Bankë një raport, në një formë të pranueshme për Bankën dhe me një objekt të tillë dhe me detaje të tilla që Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, mbi ekzekutimin dhe funksionimin fillestar të Projektit, duke përfshirë informacionin mbi çështjet mjedisore, sociale, shëndetësore, të sigurisë dhe punës në lidhje me Projektin, koston e tij dhe përfitimet e nxjerra dhe që do të rrjedhin prej tij, performancën nga Huamarrësi dhe Banka të detyrimeve të tyre përkatëse, sipas Marrëveshjes së Huas dhe përmbushjen e qëllimeve të Huas.

Neni V

Marrëveshjet financiare dhe operacionale

Seksioni 5.01 Pengu negativ

a) Anëtarit merr përsipër të sigurojë që asnjë Borxh tjetër i Jashtëm i Anëtarit nuk do të ketë përparësi ndaj Huas në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e valutës së huaj të mbajtura nën kontroll ose për të mirën e Anëtarit. Nëse do të krijohet ndonjë Barrë në ndonjë Aset Publik si siguri për ndonjë Borxh të Jashtëm, i cili do të rezultojë ose mund të rezultojë në një prioritet për



përfitimin nga kreditori të një Borxhi të tillë të Jashtëm në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e valutës së huaj, një Barrë e tillë, përveç nëse Banka do të bie dakord ndryshe, *ipso facto*, dhe pa asnjë kosto për Bankën, në mënyrë të barabartë dhe të normuar siguron principalin dhe interesin dhe Tarifatat mbi Huan dhe Anëtarin, në krijimin ose lejimin e krijimit të një Barre të tillë, do të shprehë dispozitën për atë qëllim; me kusht që, megjithatë, nëse, për ndonjë arsye kushtetuese ose tjetër ligjore, një dispozitë e tillë nuk mund të bëhet në lidhje me ndonjë Barrë të krijuar në Asetet e ndonjë prej nënndarjeve të saj politike ose administrative, Anëtari menjëherë dhe pa asnjë kosto për Bankën do të sigurojë principalin dhe interesin dhe Tarifatat mbi Huan nga një Barrë ekuivalente në Asete të tjera Publike të pranueshme për Bankën.

b) Huamarrësi (përveç Anëtarit) merr përsipër që, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

i. nëse Huamarrësi krijon ndonjë Barrë mbi ndonjë nga Asetet e tij si siguri për ndonjë borxh, një Barrë e tillë do të sigurojë në mënyrë të barabartë dhe me normë pagesën e shumës së principalit dhe interesin dhe Tarifatat e Huas dhe në krijimin e ndonjë Barre të tillë, do të bëhet një dispozitë e shprehur për këtë qëllim, pa ndonjë kosto për Bankën; dhe

ii. nëse krijohet ndonjë Barrë statusore mbi ndonjë aset të Huamarrësit si siguri për ndonjë borxh, Huamarrësi do t'i japë Bankës pa asnjë kosto një Barrë ekuivalente të pranueshme për Bankën, për të siguruar pagesën e shumës së principalit dhe interesin dhe Tarifatat mbi Huan.

c) Sipërmarrjet e mësipërme nuk do të zbatohen, për:

i. ndonjë Barrë të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes së saj, vetëm si siguri për pagimin e çmimit të blerjes së asaj prone ose si siguri për pagimin e borxhit të shkaktuar me qëllim të financimit të blerjes së një prone të tillë; ose

ii. ndonjë Barrë që lind gjatë rrjedhës së zakonshme të transaksioneve bankare dhe që siguron një borxh që maturohet jo më shumë se një vit nga data kur është bërë fillimisht.

Seksioni 5.02 Raportimi

a) Anëtari do t'i paraqesë Bankës të gjitha informacionet që Banka mund të kërkojë me arsye:

i. në lidhje me kushtet financiare dhe ekonomike në territorin e Anëtarit, duke përfshirë bilancin e pagesave të Anëtarit dhe Borxhin e

Jashtëm, si dhe Borxhin e Jashtëm të nënndarjeve të tij politike ose administrative, dhe të çdo subjekti në pronësi ose të kontrolluar nga, ose që operon për llogari ose përfitim të Anëtarit ose ndonjë nënndarje të tillë, dhe të çdo institucioni që kryen funksionet e një banke qendrore ose fondi të stabilizimit të këmbimit, ose funksione të ngjashme, për Anëtarin; dhe

ii. në lidhje me reformat ekonomike dhe masat që zbatojnë tranzicionin në një ekonomi tregu, duke përfshirë ristrukturimin dhe privatizimin, në çdo sektor ekonomik që mund të ketë ndikim në Projekt, duke përfshirë reformat në kuadrin ligjor dhe rregullator për një sektor të tillë;

b) Anëtari do të sigurojë të gjitha mundësitë e arsyeshme që Përfaqësuesit e Bankës të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të saj për qëllime që lidhen me Huan ose Projektin.

c) Huamarrësi dhe secili Subjekt i Projektit, në masën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, do të paraqesë ose marrë masa që t'i paraqiten Bankës, deri atëherë kur shuma e plotë e Huas është ripaguar ose anuluar:

i. pasqyrat dhe raportet periodike financiare, në lidhje me marrëveshjet financiare të specifikuara në Marrëveshjen e Huas;

ii. raportet periodike, në një formë të pranueshme për Bankën, mbi funksionimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të Projektit; dhe

iii. raportet vjetore mbi çështjet mjedisore, sociale, shëndetësore, të sigurisë dhe punës në lidhje me operacionet e Huamarrësit.

Neni VI

Taksat; kufizimet mbi pagesat

Seksioni 6.01 Taksat

a) Anëtari siguron se:

i. shuma e principalit dhe interesi dhe Tarifatat e Huas përjashtohen dhe paguhet pa zbritje për çdo Taksë të vendosur nga ose në territorin e Anëtarit; dhe

ii. Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë, çdo Marrëveshje e Projektit dhe çdo dokument i lidhur me të cilin zbatohen këta Terma dhe Kushte Standardë do të jenë pa ndonjë dhe pa të gjitha Taksat e vendosura nga, ose në territorin e Anëtarit mbi ose në lidhje me ekzekutimin, dorëzimin ose regjistrimin e tij.



b) Të ardhurat e Huas nuk do të tërhiqen për llogari të pagesave për çdo Taksë të vendosur nga, ose në territorin e Anëtarit.

c) Banka, me njoftim për Huamarrësin, mund të rrisë ose ulë përqindjen e shpenzimeve që do të financohen nga çdo Kategori, siç mund të kërkohej që të jetë në përputhje me paragrafin “b” të këtij seksioni.

Seksioni 6.02 Kufizimi mbi pagesat

Anëtari do të sigurojë që shuma e principalit të interesit dhe Tarifat mbi Huan të paguhen pa kufizime të çfarëdo lloji të vendosura nga, ose në territorin e Anëtarit.

Neni VII

Pezullimi dhe anulimi; përsheptimi i maturimit

Seksioni 7.01 Pezullimi

a) Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme do të ketë ndodhur dhe do të vazhdojë, Banka, me njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtën e Huamarrësit për të bërë Shuma të Aksesueshme, sipas Huas:

i. Huamarrësi nuk ka arritur të paguajë (pavarësisht nga fakti që një pagesë e tillë mund të jetë bërë nga Garantuesi ose nga një palë e tretë) principalin ose interesin ose ndonjë shumë tjetër që i detyrohet Bankës, sipas:

A. Marrëveshjes së Huas;

B. Ndonjë marrëveshje tjetër huaje ose garancie midis Bankës dhe Huamarrësit; ose

C. Ndonjë rimbursimi ose detyrimi të ngjashëm të Huamarrësit që lind si pasojë e ndonjë garancie të vazhduar ose detyrimi tjetër financiar të çdo lloji të marrë nga Banka ndaj ndonjë pale të tretë me marrëveshjen e Huamarrësit;

ii. Garantuesi nuk ka paguar principalin, interesin ose ndonjë shumë tjetër që i detyrohet Bankës, sipas:

A. Marrëveshjes së Garancisë;

B. Ndonjë marrëveshje tjetër huaje ose marrëveshje garancie me Bankën; ose

C. Ndonjë rimbursimi ose detyrim të ngjashëm të Garantuesit që lind si pasojë e ndonjë garancie të vazhduar ose detyrimi tjetër financiar të çdo lloji të marrë nga Banka ndaj ndonjë pale të tretë me marrëveshjen e Garantuesit;

iii. Huamarrësi ose Garantuesi (duke përfshirë çdo nënndarje politike ose administrative të tij) nuk ka përmbushur ndonjë detyrim tjetër ndaj Bankës, në përputhje me një marrëveshje midis Huamarrësit ose Garantuesit, ose ndonjë nënndarje politike ose administrative të tij, dhe Bankës, ose sipas nenit 21.2, të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës;

iv. ndonjë Subjekt i Projektit nuk ka përmbushur detyrimet e tij, sipas një Marrëveshje të Projektit;

v. Banka do të ketë pezulluar, plotësisht ose pjesërisht, të drejtën e Huamarrësit ose Garantuesit për të bërë kërkesa për Shuma të Aksesueshme, sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër Huaje me Bankën, për shkak të mosarritjes nga Huamarrësi ose Garantuesi për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij, sipas marrëveshjes së tillë ose ndonjë marrëveshjeje garancie me Bankën;

vi. do të jetë shkaktuar një situatë e jashtëzakonshme si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Huas, e cila do ta bëjë të pamundur që Projekti të zbatohet ose që Huamarrësi, Garantuesi ose Subjekti i Projektit do të mund të përmbushin detyrimet e tyre, sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose Marrëveshjes së Projektit;

vii. Shumat e Aksesueshme janë të ndaluara me një vendim të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të marra sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara;

viii. Anëtari do të jetë pezulluar nga anëtarësimi në Bankë ose do të ketë pushuar së qeni anëtar i Bankës, ose do t'i ketë dërguar Bankës një njoftim për t'u tërhequr nga ky anëtarësim;

ix. Huamarrësi (përveç Anëtarit) ose ndonjë Subjekt i Projektit (ose ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka pushuar së ekzistuar në të njëjtën formë ligjore si ajo mbizotëruese që nga data e Marrëveshjes së Huas;

x. ndodh ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme në lidhje me çdo financim të specifikuar në Marrëveshjen e Huas që do të sigurohet për Projektin (“Bashkëfinancimi”) nga një financues (përveç Bankës) (“Bashkëfinancuesi”):

A. Nëse Marrëveshja e Huas përcakton një datë në të cilën marrëveshja me Bashkëfinancuesin që parashikon Bashkëfinancimin (“Marrëveshja e Bashkëfinancimit”) do të hyjë në fuqi, Marrëveshja



e Bashkëfinancimit nuk ka hyrë në fuqi në atë deri në atë datë, ose në një datë të mëvonshme, siç e ka vendosur Banka me shkrim (“Afati i bashkëfinancimit”); me kusht që dispozitat e këtij nënparagrafi të mos zbatohen nëse, siç është e zbatueshme, Huamarrësi, Subjekti përkatës i Projektit ose Garantuesi vendosin për kënaqësinë e Bankës që fondet e përshtatshme për Projektin janë në dispozicion nga burime të tjera në termat dhe kushtet, në përputhje me detyrimet të Huamarrësit, Subjektet përkatëse të Projektit dhe Garantuesit, sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes përkatëse të Projektit dhe Marrëveshjes së Garancisë;

B. Sipas nënparagrafit “C” më poshtë: “X” e drejta për të tërhequr të ardhurat e Bashkëfinancimit është pezulluar, anuluar ose përfunduar plotësisht ose pjesërisht, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Bashkëfinancimit; ose “Y” Bashkëfinancimi është bërë i kërkueshëm dhe i pagueshëm para maturimit të rënë dakord; ose

C. Nënparagrafi “B” i këtij paragrafi nuk do të zbatohet nëse Huamarrësi, Subjekti përkatës i Projektit ose Garantuesi vendosin për kënaqësinë e Bankës, që: X. një pezullim, anulim, përfundim ose paramaturim i tillë nuk u shkaktua nga mospërbushja nga përfituesi i Bashkëfinancimit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij, sipas Marrëveshjes së Bashkëfinancimit; dhe Y. fondet e përshtatshme për Projektin janë në dispozicion nga burime të tjera, sipas termave dhe kushteve në përputhje me detyrimet e Huamarrësit, Subjektit përkatës të Projektit dhe Garantuesit, sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes përkatëse të Projektit dhe Marrëveshjes së Garancisë;

xi. nëse Huamarrësi nuk është një anëtar i Bankës, çdo ndryshim material negativ në gjendjen e Huamarrësit nga ai i përfaqësuar nga Huamarrësi në datën e Marrëveshjes së Huas do të ketë ndodhur para Datës së Hyrjes në Fuqi;

xii. një përfaqësim i bërë nga Huamarrësi, çdo Subjekt i Projektit ose Garantuesi, në lidhje me Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen përkatëse të Projektit ose Marrëveshjen e Garancisë do të ketë qenë e pasaktë ose çorientuese në ndonjë aspekt material;

xiii. sipas mendimit të Bankës, karakteri juridik, pronësia ose kontrolli i Huamarrësit (përveç Anëtarit) ose të Subjektit të Projektit (ose të ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë

pjesë të Projektit) ka ndryshuar nga ai që mbizotëronte që nga data e Marrëveshjes së Huas ose Marrëveshjes së Projektit, në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe negativisht në aftësinë e Huamarrësit ose të Subjektit të Projektit (ose një subjekti tjetër të tillë) për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij që lindin ose lidhen në përputhje me Marrëveshjen e Huas ose Marrëveshjen e Projektit, ose për të arritur objektivat e Projektit;

xiv. do të ketë ndodhur ndonjë ngjarje e specifikuar në seksionin 7.06(c), 7.06(d) ose 7.06(e);

xv. Banka do të ketë pezulluar ose ndryshe modifikuar aksesin në burimet e Bankës nga Anëtarit, në përputhje me një vendim të Bordit të Guvernatorëve të Bankës, sipas nenit 8.3 të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës;

xvi. në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, Banka do të ketë përcaktuar që Huamarrësi (përveç Anëtarit), Subjekti i Projektit ose një Bashkëpunëtor i subjekteve të tilla është përfshirë në listën e Bankës së personave ose subjekteve të papërshtatshme për t’u dhënë një kontratë e financuar nga Banka ose për financim të Bankës, ku kjo listë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës; ose

xvii. ka ndodhur ndonjë ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij seksioni.

b) E drejta e Huamarrësit për të bërë Shuma të Aksesueshme do të vazhdojë të pezullohet tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, deri atëherë kur ngjarja ose ngjarjet që krijuan pezullimin do të kenë pushuar së ekzistuari, përveç nëse Banka do të ketë njoftuar Huamarrësin se është rikthyer e drejta për të bërë Shuma të Aksesueshme; me kusht që e drejta për të bërë Shuma të Aksesueshme të rikthehet vetëm në masën dhe në varësi të kushteve të specifikuara në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, tagër ose mjet ligjor të Bankës, në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër të mëpasshme të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 7.02 Anulimi nga Banka

a) Nëse në çdo kohë Banka përcakton, pas konsultimit me Huamarrësin dhe Garantuesin, se një shumë e Huas nuk do të kërkohej për të financuar kostot e Projektit që do të financohet nga të ardhurat e Huas, Banka, me njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të anulojë këtë shumë të Huas. Në datën e fundit të



disponueshmërisë, çdo Shumë e mbetur në Dispozicion do të anulohet automatikisht.

b) Nëse e drejta e Huamarrësit për të bërë Shuma të Aksesueshme të ndonjë pjese të Huas do të jetë pezulluar për një periudhë të vazhdueshme prej 30 (tridhjetë) ditësh, Banka me njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin mund të anulojë një shumë të tillë të Huas.

c) Nëse në çdo kohë Banka përcakton, se:

i. prokurimi i ndonjë artikulli është në kundërshtim me procedurat e përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Huas dhe Banka përcakton shumën e shpenzimeve, në lidhje me këtë artikull, që, përndryshe, do të kishte qenë e drejtë për financim nga të ardhurat e Huas; ose

ii. fondet e tërhequra nën Huat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në Marrëveshjen e Huas dhe Banka përcakton shumën e përdorur në këtë mënyrë; ose

iii. në lidhje me çdo kontratë që do të financohet plotësisht ose pjesërisht nga të ardhurat e Huas, Huamarrësi, Subjekti i Projektit ose një Bashkëpunëtor i subjekteve të tilla është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndalar gjatë prokurimit ose ekzekutimit të një kontrate të tillë, ku Huamarrësi ose Garantuesi nuk kanë ndërmarrë veprime në kohë dhe të përshtatshme të pranueshme për Bankën për të korigjuar situatën, dhe Banka përcakton shumën e shpenzimeve, në lidhje me një kontratë të tillë, e cila përndryshe do të ishte e pranueshme për financim nga të ardhurat e Huas,

banka, me një njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të anulojë ekuivalentin e kësaj shume të Huas. Ky anulim do të hyjë në fuqi kur jepet njoftimi.

d) Nëse, në përputhje me Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, Banka vendos që Huamarrësi (përveç Anëtarit), Subjekti i Projektit ose një Bashkëpunëtor i subjekteve të tilla është përfshirë në listën e Bankës së personave ose të subjekteve të papërshtatshme për t'u dhënë një kontratë të financuar nga Banka ose për financim të Bankës, ku një listë e tillë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës, Banka, me një njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të anulojë të gjithë ose një pjesë të Huas. Ky anulim do të hyjë në fuqi kur jepet njoftimi.

e) Nëse Banka merr një njoftim përfundim nga Garantuesi, në përputhje me seksionin 7.05, në lidhje me ndonjë shumë të Huas që nuk është

tërhequr, këto shuma do të konsiderohen se janë anuluar nga Banka.

Seksioni 7.03 Angazhimi për Rimbursim të Pakushtëzuar të pandikuar nga Pezullimi ose Anulimi

Asnjë anulim ose pezullim nuk do të zbatohet për shumat sipas një Angazhimi të Rimbursimit të pakushtëzuar të bërë nga Banka, në përputhje me seksionin 3.02(c), përveç siç parashikohet shprehimisht në një angazhim të tillë.

Seksioni 7.04 Detyrimet e Huamarrësit dhe të Garantuesit

Pavarësisht nga ndonjë anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç siç parashikohet specifikisht këtu.

Seksioni 7.05 Anulimi i Garancisë

Nëse Huamarrësi nuk ka bërë pagesën e principalit ose të interesit ose ndonjë pagesë tjetër të kërkuar, sipas Marrëveshjes së Huas (si rezultat i ndonjë veprimi ose mosveprimi nga ana e Garantuesit) dhe kjo pagesë do të ishte bërë nga Garantuesi, ky i fundit pas konsultimit me Bankën, duke i dhënë njoftim Bankës dhe Huamarrësit, mund të përfundojë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Garancisë, në lidhje me çdo shumë të Huas që nuk është tërhequr para datës së marrjes së njoftimit nga Banka dhe nuk i nënshtrohet ndonjë Angazhimi të Rimbursimit të pakushtëzuar të lëshuar nga Banka, në përputhje me seksionin 3.02(b). Pas marrjes së një njoftimi të tillë nga Banka, detyrimet e Garantuesit, në lidhje me një shumë të tillë do të përfundojnë.

Seksioni 7.06 Ngjarjet e Përsheptimit

Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme do të ketë ndodhur dhe do të jetë duke vazhduar për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo kohë gjatë vazhdimit të asaj ngjarjeje, Banka, me një njoftim për Huamarrësin dhe Garantuesin, mund të anulojë Huan dhe të deklarojë që Shuma e principalit të Huas, e vonuar në atë kohë për të qenë e kërkueshme dhe e pagueshme menjëherë, së bashku me interesin dhe Tarifat mbi të, dhe mbi çdo deklaratë të tillë, shuma e tillë e principalit, së bashku me interesin dhe Tarifat e tilla, bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme menjëherë:

a) çdo ngjarje e specifikuar në seksionin 7.01(a)(i) ose 7.01(a)(ii) do të ketë ndodhur dhe do



të ketë vazhduar për 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e ngjarjes së tillë;

b) çdo ngjarje e specifikuar në seksionin 7.01(a)(iii) ose 7.01(a)(iv) do të ketë ndodhur dhe do të vazhdojë për 30 (tridhjetë) ditë, pasi njoftimi mbi të do të jetë dhënë nga Banka për Huamarrësin dhe Garantuesin;

c) çdo Borxh i Jashtëm i Huamarrësit ose Garantuesit deklarohet i kërkueshëm dhe i pagueshëm para maturimit të tij të specifikuar;

d) Huamarrësi (nëse nuk është një anëtar i Bankës) ose ndonjë Subjekt i Projektit nuk ka mundur të paguajë borxhet e tij, kur ato maturohen ose ndonjë veprim ose procedurë do të jetë marrë nga Huamarrësi ose ndonjë Subjekt i Projektit ose të tjerë, me anë të të cilave ndonjë prej Aseteve të Huamarrësit ose ndonjë Subjekt i Projektit shpërndahet ose mund të shpërndahet midis kreditorëve të tij;

e) çdo autoritet ose Subjekt që ka juridiksion ose kontroll mbi Huamarrësin ose ndonjë Subjekt të Projektit do të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për shpërbërjen ose shpërbërjen, ose pezullimin e aktiviteteve të Huamarrësit (nëse nuk është një anëtar i Bankës) ose ndonjë Subjekt të Projektit;

f) çdo ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij seksioni do të ketë ndodhur dhe do të ketë vazhduar për periudhën, nëse ka, të specifikuar në Marrëveshjen e Huas.

Neni VIII

Zbatueshmëria; zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Seksioni 8.01. Zbatueshmëria

a) Të drejtat dhe detyrimet e palëve në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme, në përputhje me kushtet e tyre pavarësisht nga ndonjë ligj lokal për të kundërtën. Asnjë palë e ndonjë marrëveshje të tillë nuk do të ketë të drejtë në asnjë rrethanë të supozojë ndonjë pretendim se ndonjë dispozitë e një marrëveshjeje të tillë është e pavlefshme ose e pazbatueshme për ndonjë arsye.

b) Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtyre Termave dhe Kushteve Standardë, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Huamarrësi, Garantuesi dhe secili Subjekt i Projektit

konsiderohen se pranojnë që Banka ka të drejtë të kërkojë Politikën dhe Procedurat e Zbatimit, duke përfshirë çdo Veprim të Zbatimit ose Veprim të Nxjerrjes së Informacionit të përcaktuar në të, në lidhje me pretendimet e praktikave të ndaluara, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas).

Seksioni 8.02 Detyrimet e Garantuesit

Detyrimet e Garantuesit sipas Marrëveshjes së Garancisë nuk do të shkarkohen, përveçse nga performanca dhe vetëm në masën e një performace të tillë. Këto detyrime nuk do t'i nënshtrohen asnjë njoftimi paraprak, kërkesë, apo veprimi ndaj Huamarrësit ose ndonjë Subjekti të Projektit ose ndonjë njoftimi paraprak ose kërkesë ndaj Garantuesit, në lidhje me ndonjë mospërbushje nga Huamarrësi ose ndonjë Subjekt të Projektit dhe nuk do të dëmtohet nga ndonjë nga sa vijon: çdo zgjatje e kohës, shmangie ose lëshim të dhënë Huamarrësit ose ndonjë Subjekt të Projektit; çdo pohim ose mospërbushje për të pohuar, ose vonesë për të pohuar, ndonjë të drejtë, tagër ose mjet ligjor ndaj Huamarrësit ose ndonjë Subjekti të Projektit ose në lidhje me ndonjë siguri për Huan; ndonjë modifikim ose amplifikim të dispozitave të Marrëveshjes së Huas ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit të parashikuar nga kushtet e saj; ose ndonjë mospërbushje nga Huamarrësi ose ndonjë Subjekt i Projektit për të përbushur ndonjë kërkesë të ndonjë ligji, rregulloreje ose urdhri të Garantuesit ose të ndonjë nënndarje politike ose agjencie të Garantuesit.

Seksioni 8.03 Mosushtimi i të drejtave

Asnjë vonesë në ushtrim ose mosveprim për të ushtruar, ndonjë të drejtë, tagër ose mjet kompensimi që i shtohen secilës palë sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit mbi çdo mospërbushje nuk do të dëmtojë ndonjë të drejtë, tagër ose mjet kompensimi të tillë ose interpretohet se është heqje dorë prej saj ose pranim në një mospërbushje të tillë; as veprimi i palës së tillë në lidhje me ndonjë mospërbushje ose ndonjë pranim në çdo mospërbushje nuk ndikon ose dëmton ndonjë të drejtë, tagër ose mjet kompensimi të palës së tillë, në lidhje me ndonjë mospërbushjeje tjetër ose pasuese.

**Seksioni 8.04 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

a) Palët në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje ose polemikë midis ndonjë ose më shumë prej tyre dhe Bankës që rrjedhin nga marrëveshje të tilla ose shkelja, përfundimi ose pavlefshmëria e tyre ose ndryshe në lidhje me to. Në këtë drejtim, me iniciativë të çdo pale në ndonjë marrëveshje të tillë, pala ose palët e tjera do të takohen menjëherë me palën iniciuese, për të diskutuar ndonjë mosmarrëveshje apo polemikë të tillë dhe, nëse kërkohet nga pala iniciuese me shkrim, do t'i përgjigjet me shkrim çdo parashtrimi me shkrim të bërë nga pala iniciuese, në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje apo polemikë të tillë.

b) Nëse ndonjë mosmarrëveshje apo polemikë e tillë ose ndonjë pretendim që lidhet me të, nuk mund të zgjidhet miqësisht, siç parashikohet në nënparagrafin “a” brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data kur bëhet kërkesa për një takim, siç referohet në nënparagrafin “a”, kjo mosmarrëveshje ose polemikë ose pretendim që lidhet me të do të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL në fuqi në datën e këtyre Afateve dhe Kushteve Standardë, sipas, sa vijon:

i. numri i arbitrave do të jetë 3 (tre);

ii. autoriteti emëruar për qëllimet e Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit;

iii. kur Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit do të caktojë një arbitër, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit do të jetë i lirë të zgjedhë çdo person që ai/a jo e konsideron të përshtatshëm për të vepruar si arbitër, në përputhje me nenet 9.2 dhe/ose 9.3 të Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL;

iv. vendi i arbitrazhit do të jetë Haga;

v. gjuha që do të përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze;

vi. ligji që do të zbatohet nga gjykata e arbitrazhit do të jetë ligji ndërkombëtar publik, burimet e të cilit do të merren për këto qëllime për të përfshirë:

A. Marrëveshjen për Themelimin e Bankës dhe çdo detyrim përkatës traktati që është i detyrueshëm për palët në mënyrë të ndërsjellët;

B. Dispozitat e çdo konvente dhe traktati ndërkombëtar (pavarësisht nëse janë apo jo detyruese drejtpërdrejt si të tilla për palët) të njohura përgjithësisht si të kodifikuara ose të përgatitura në rregulla detyruese të së drejtës zakonore të zbatueshme për shtetet dhe institucionet financiare ndërkombëtare, siç është e përshtatshme;

C. Forma të tjera të së drejtës zakonore ndërkombëtar, duke përfshirë praktikën e shteteve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare me një përgjithësi, qëndrueshmëri dhe kohëzgjatje të tillë që të krijojnë detyrime ligjore; dhe

D. Parimet e përgjithshme të zbatueshme të ligjit

vii. Pavarësisht nga dispozitat e Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL, gjykata e arbitrazhit nuk do të jetë e autorizuar të marrë masa të përkohshme të mbrojtjes ose të sigurojë ndonjë kompensim para vendimit kundër Bankës dhe askush nga palët në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë ose ndonjë Marrëveshje të Projektit nuk mund t'i dërgojë ndonjë autoriteti gjyqësor një kërkesë për ndonjë masë të përkohshme të mbrojtjes ose kompensim para vendimit kundër Bankës.

viii. Gjykata e arbitrazhit do të ketë autoritetin të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në ndonjë procedurë, vendim ose vendim gjyqi çdo mosmarrëveshje apo polemikë të paraqitur, siç duhet përpara saj nga Banka, Huamarrësi, Garantuesi ose ndonjë Subjekt i Projektit, për aq sa një mosmarrëveshje ose polemikë e tillë del nga Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë ose ndonjë Marrëveshje të Projektit; por sipas sa më sipër asnjë palë tjetër ose mosmarrëveshje tjetër nuk do të përfshihet ose konsolidohet në procedurat e arbitrazhit.

c) Pavarësisht nga dispozitat e këtij seksioni, asgjë që përfshihet në këta Terma dhe Kushte Standardë ose në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë ose ndonjë Marrëveshje të Projektit nuk do të funksionojë ose do të konsiderohet si heqje dorë, mospranim ose modifikim tjetër i ndonjë imuniteti, privilegji ose përjashtimi të Bankës nën Marrëveshjen për Themelimin e Bankës, nën konventat ndërkombëtare ose sipas ndonjë ligji në fuqi.

d) Në çdo procedurë arbitrazhi që rrjedh nga Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë ose



ndonjë Marrëveshje të Projektit, certifikata e Bankës për çdo shumë të kërkueshme për Bankën, sipas kësaj marrëveshjeje do të jetë dëshmi e qartë e kësaj shume.

Neni IX

Data e Hyrjes në Fuqi; përfundimi para kohe

Seksioni 9.01 Data e Hyrjes në Fuqi

Përveç nëse Banka dhe Huamarrësi do të bien dakord ndryshe, Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit do të hyjë në fuqi, në datën në të cilën Banka dërgon te Huamarrësi dhe Garantuesi njoftimin për pranimin nga Banka të dëshmimeve të kërkuara nga seksionet 9.02 dhe 9.03.

Seksioni 9.02 Kushtet pararendëse të hyrjes në fuqi

Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit nuk do të hyjnë në fuqi nëse Banka nuk është e bindur që asnjë ngjarje e përmendur në seksionin 7.01(a) ose 7.06 nuk ka ndodhur dhe nuk po vazhdon; dhe derisa dëshmitë, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, t'i paraqiten Bankës, që:

a) Ekzekutimi dhe dorëzimi i Marrëveshjes së Huas dhe Marrëveshjes së Garancisë në emër të Huamarrësit dhe Garantuesit janë autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare dhe të korporatave.

b) Ekzekutimi dhe dorëzimi i secilës Marrëveshje të Projektit, nëse ka, në emër të secilit Subjekt të Projektit është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga të gjitha veprimet e domosdoshme qeveritare, të korporatave dhe administrative.

c) Do të kenë ndodhur të gjitha ngjarjet e tjera të specifikuara në Marrëveshjen e Huas si kushte shtesë të efektshmërisë së saj.

Seksioni 9.03 Mendimi juridik

Si pjesë e provave që do të sigurohen në përputhje me seksionin 9.02, Huamarrësi, Garantuesi dhe secili Subjekt i Projektit do t'i paraqesin ose do të marrin masa që t'i paraqesin Bankës një mendim ose mendimet (në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Bankën) e këshilltarit të pranueshëm nga Banka, në lidhje me çështje të tilla që mund të specifikohen në Marrëveshjen e Huas ose siç do të kërkojnë me arsye nga Banka dhe, duke treguar se:

a) Në emër të Huamarrësit, Marrëveshja e Huas është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërsh të detyrueshëm të Huamarrësit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

b) Në emër të Garantuesit, Marrëveshja e Garancisë është autorizuar ose ratifikuar rregullisht nga dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Garantuesit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërsh të detyrueshëm të Garantuesit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

c) Në emër të secilit Subjekt të Projektit, secila Marrëveshje e Projektit, në të cilën është palë, është autorizuar ose ratifikuar rregullisht, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Subjektit të tillë të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërsh detyrues të një Subjekti të tillë të Projektit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

Seksioni 9.04 Ndërprerja për Moshyrjen në Fuqi

Nëse Marrëveshja e Huas nuk do të ketë hyrë në fuqi deri në datën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimet e këtij seksioni, të gjitha detyrimet e Bankës sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit do të përfundojnë nëse Banka, pasi merr në konsideratë arsyet e vonësës, nuk përcakton një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij seksioni. Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin dhe Garantuesin për një datë të tillë të mëvonshme.

Seksioni 9.05 Përfundimi i Performancës

Kur e gjithë Shuma e principalit të Huas do të jetë shlyer dhe të gjitha interesat dhe tarifatat që do të jenë përllëgaritur ose do të jenë bërë të kërkueshme mbi Huan do të jenë paguar, Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë dhe çdo Marrëveshje e Projektit, dhe të gjitha detyrimet e palëve pas kësaj, do të përfundojnë menjëherë.

Neni X

Njoftimet; përfaqësuesit e autorizuar; amendimi

Seksioni 10.01 Njoftimet

Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohej ose lejohet të jepet ose bëhet sipas Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose çdo Marrëveshje e Projektit ose, sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër të palëve të parashikuara në të, do të jetë me shkrim.



Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në nenin 9.01, ky njoftim ose kërkesë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë rregullisht kur i është dorëzuar palës së cilës i kërkohet të jepet ose bëhet në adresën e palës të specifikuar në Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë ose Marrëveshjen përkatëse të Projektit, ose në ndonjë adresë tjetër që pala do t'ia ketë specifikuar me shkrim palës që jep njoftimin ose bën kërkesën. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Manualin e Disbursimit të BERZH-it (për aplikimet e Shumave të Aksesueshmes dhe çështjet e lidhura me to), një dorëzim i tillë mund të bëhet dorazi, me postë, teleks ose faks. Dorëzimet e bëra me teleks ose faks do të konfirmohen, gjithashtu, me postë.

Seksioni 10.02 Autoriteti për të vepruar

Çdo veprim që kërkohet ose lejohet të merret dhe çdo dokument që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet, sipas Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi, sipas Marrëveshjes së Huas nga Garantuesi ose sipas ndonjë Marrëveshje e Projektit nga një Subjekt i Projektit do të merret ose ekzekutohet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit, Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit ose ndonjë Përfaqësues i Autorizuar i Subjektit të Projektit, siç është e zbatueshme, ose një zyrtar tjetër i Huamarrësit, Garantuesit ose ndonjë Subjekti të Projektit, që një Përfaqësues i Autorizuar i tillë do të caktojë me shkrim. Huamarrësi, Garantuesi dhe secili Subjekt i Projektit do t'i paraqesin Bankës dëshmi të mjaftueshme të autoritetit dhe nënshkrimin model të autorizuar të secilit zyrtar të tillë.

Seksioni 10.03 Amendimi

a) Marrëveshja e Huas mund të ndryshohet me një instrument me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit dhe nga një zyrtar i autorizuar rregullisht i Bankës. Në rast se, sipas mendimit të Bankës, një ndryshim i tillë rrit detyrimet e Garantuesit, ky instrument me shkrim do të nënshkruhet nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit.

b) Marrëveshja e Garancisë mund të ndryshohet me një instrument me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Garantuesit dhe nga një zyrtar i autorizuar rregullisht i Bankës.

c) Çdo Marrëveshje e Projektit mund të ndryshohet me një instrument me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i

Subjektit të Projektit, që është palë në të dhe nga një zyrtar i autorizuar rregullisht i Bankës.

Seksioni 10.04 Gjuha angleze

Çdo dokument i dorëzuar në përputhje me Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë ose çdo Marrëveshje të Projektit do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në çdo gjuhë tjetër duhet të shoqërohen me një përkthim të tyre në gjuhën angleze, i vërtetuar si një përkthim i aprovuar dhe një përkthim i tillë i aprovuar do të jetë përfundimtar.

Seksioni 10.05 Nënshkrimi i kopjeve

Marrëveshja e Huas, Marrëveshja e Garancisë dhe secila Marrëveshje e Projektit mund të nënshkruhen në disa kopje, ku secila prej tyre do të jetë origjinale.

Seksioni 10.06 Nxjerrja e Informacionit

Banka mund të zbulojë Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit dhe çdo informacion, në lidhje me marrëveshje të tilla (përfshirë dokumentet dhe të dhënat në lidhje me Huamarrësin, Garantuesin, Subjektin e Projektit dhe Projektin), në përputhje me politikën e saj për aksesin në informacion, në efekt në kohën e këtij zbulimi të informacionit, dhe në lidhje me ndonjë mosmarrëveshje ose procedurë në lidhje me, ose që përfshin Projektin ose Marrëveshjen e Huas, Marrëveshjen e Garancisë dhe çdo Marrëveshje të Projektit, me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes ose zbatimit të ndonjë prej të drejtave ose interesave të Bankës.

Kopje nënshkrimi
(Numri i veprimt 52360)

MARRËVESHJE HUAJE

(VISP: PROJEKTI I OSHEE-së PËR
REAGIMIN NDAJ PANDEMISË COVID-19)
NDËRMJET OPERATORIT TË
SHËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE GROUP SHA DHE BANKËS
EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM

Datë 8 shtator 2021

TABELA E LËNDËS

NENI I – TERMAT DHE KUSHTET
STANDARDË; PËRKUFIZIME

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe
Kushteve Standardë



Seksioni 1.02 Përkufizime

Seksioni 1.03 Interpretimi

NENI II – KUSHTET KRYESORE TË HUAS

Seksioni 2.01 Shuma dhe Monedha

Seksioni 2.02 Kushte të tjera Financiare të Huas

Seksioni 2.03 Tërheqjet e Fondit dhe Llogaria e Veçantë

NENI III – EKZEKUTIMI I PROJEKTTIT

Seksioni 3.01 Angazhime Mbështetëse të Projektit

Seksioni 3.03 Angazhime të Pajtushmërisë Sociale dhe Mjedisore

Seksioni 3.04 Konsulentët

Seksioni 3.05 Shpeshtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjes

NENI IV – ANGAZHIMET FINANCIARE DHE OPERACIONALE

Seksioni 4.01 Të Dhënat dhe Raportet Financiare

Seksioni 4.02 Angazhime Negative

Seksioni 4.03 Angazhime Financiare

Seksioni 4.04 Kryerja e Biznesit dhe Operacioneve

NENI V – PEZULLIMI DHE PËRSHPEJTIMI

Seksioni 5.01 Pezullimi

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i Maturimit

Seksioni 5.03 Anulimi

NENI VI – HYRJA NË FUQI

Seksioni 6.01 Kushtet para Hyrjes në Fuqi

Seksioni 6.02 Opinionet Ligjore

Seksioni 6.03 Përfundimi për Moshyrje në Fuqi

NENI VII – TË NDRYSHME

Seksioni 7.01 Njoftimet

SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTTIT

SKEDULI 2 – KATEGORITË DHE TËRHEQJET E FONDIT

SKEDULI 3 – PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

SKEDULI 4 – FORMA E SIPËRMARRJES SË INTEGRITETIT

SKEDULI 5 – LLOGARIA E VEÇANTË

MARRËVESHJE HUAJE

MARRËVESHJE E DATËS 8 SHTATOR 2021

NDËRMJET OPERATORIT TË

SHPËRNDARJES SE ENERGJISË

ELEKTRIKE GROUP SHA (“HUAMARRËSI”)

DHE BANKËS EVROPIANE PËR

RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (“BANKA”).

PREAMBULË

Duke pasur parasysh se Banka është themeluar për të siguruar financim për projekte specifike për të nxitur tranzicionin ndaj ekonomive të hapura drejt tregut dhe për të promovuar iniciativën private dhe sipërmarrëse në vende të caktuara të angazhuara dhe që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

duke pasur parasysh se Huamarrësi synon të zbatojë Projektin, siç përshkruhet në skedulin 1, i cili është projektuar për të ndihmuar Huamarrësin në zbutjen e pasojave financiare të krizës së lidhur me pandeminë COVID-19 dhe në ndërtimin e një nënstacioni 110/20 kV në Tiranë;

duke pasur parasysh se Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. ka kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e Projektit dhe Garantuesi ka rënë dakord të mbështesë këtë kërkesë dhe Projektin, sipas kushteve të Marrëveshjes së Garancisë;

duke pasur parasysh se banka është në proces të rregullimit të fondeve të bashkëpunimit teknik mbi një bazë granti për të ndihmuar Huamarrësin, në: i. përgatitjen dhe zbatimin e një plani veprimi antikorrupsion, me synim përmirësimin e proceseve dhe qeverisjen antikorrupsion të Huamarrësit; ii. përgatitjen e një udhërrëfyese inteligjent për zhvillimin e rrjetit; iii. përmirësimin e praktikave dhe të proceseve të tij mbi shëndetin dhe sigurinë; dhe iv. ofrimin e trajnimeve për punonjësit e Huamarrësit, duke rritur aftësitë e tyre teknike me një komponent të theksuar gjinor (“Detyrat e Bashkëpunimit Teknik”); në bazë të termave dhe kushteve që do të përcaktohen në një marrëveshje granti midis Bankës dhe Huamarrësit;

duke pasur parasysh se, sipas një marrëveshjeje garancie të kësaj date ndërmjet Republikës së Shqipërisë si Garantues dhe Bankës (“Marrëveshja e Garancisë”), siç përcaktohet në Termat dhe Kushtet Standardë, Garantuesi ka garantuar



detyrimet e Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord në bazë të, *ndër të tjera*, sa më sipër, për t'i dhënë një hua Huamarrësit në shumën deri 70,000,000 euro, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë Marrëveshje,

tashmë, si rrjedhojë, me anë të kësaj palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Termat dhe Kushtet Standardë; përkufizimet

Seksioni 1.01 Përfshirja e Termave dhe Kushteve Standardë

Të gjitha dispozitat e Termave dhe Kushteve Standardë të Bankës të datës 1 tetor 2018, përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu, megjithatë, subjekt i modifikimeve të mëposhtme (dispozita të tilla siç janë modifikuar referohen më poshtë si “Termat dhe Kushtet Standardë”).

a) Përkufizimi “Shuma e disponueshme” në seksionin 2.02 të Termave dhe Kushteve Standardë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet si më poshtë:

“Shuma e Disponueshme” nënkupton: i. Këstin 1, siç herë pas here nuk është anuluar ose tërhequr ose nënshtruar një Angazhimi për Rimbursim të kushtëzuar ose të pakushtëzuar (“Shuma e Disponueshme e Këstit 1”); dhe ii. Kësti 2, siç është kryer dhe herë pas here nuk është anuluar ose tërhequr ose nënshtruar një Angazhimi për Rimbursim të kushtëzuar ose të pakushtëzuar (“Shuma e disponueshme e Këstit 2”).

b) Seksioni 3.01(a) i Termave dhe i Kushteve Standardë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“a) Data e fundit e Disponueshmërisë

E drejta e Huamarrësit për të tërhequr nga Shuma e Disponueshme:

1. Bëhet efektive: i. në lidhje me këstin 1, në Datën e Hyrjes në Fuqi; dhe ii. në lidhje me Këstin 2 në Datën e Disponueshmërisë së këstit 2; dhe

2. Përfundon në Datën e fundit të Disponueshmërisë ose në një datë të tillë të mëvonshme, siç mund të vendosë Banka, sipas diskrecionit të saj, pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi (kërkesë e

cila, nëse ka një Marrëveshje Garancie, do të nënshkruhet ose ndryshe miratohet nga Garantuesi). Banka do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për një datë të tillë të mëvonshme.”.

c) Seksioni 3.01(b) i Termave dhe i Kushteve Standardë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“b) Aplikimet për Tërheqjet e Fondit

i. Për të bërë një Tërheqje Fondi, në Bankë do të paraqitet një kërkesë për Tërheqje Fondi nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit ose një person i caktuar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Huamarrësit. Çdo kërkesë e paraqitur për tërheqje fondi do të jetë në përputhje dhe në formën e përcaktuar në Manualin e Disbursimit të BERZH-it dhe do t'i dorëzohet Bankës të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune para datës së vlerës së propozuar të Transferimit të Fondit. Çdo kërkesë për Tërheqje Fondi do të jetë në thelb e pranueshme për Bankën, do të specifikojë Këstin (Kësti 1 ose Kësti 2) nga i cili kërkohet Tërheqja e Fondit dhe do të shoqërohet me dokumente dhe prova të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje, për të përmbushur kërkesën e Bankës se Huamarrësi ka të drejtë të marrë shumën e Tërheqjes së Fondit dhe se shuma e Tërheqjes së Fondit do të përdoret ekskluzivisht për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen e Huas.

ii. Me përjashtim të Tërheqjes së fundit të Fondit ose nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, Tërheqja e Fondit do të bëhen në shuma jo më pak se Shuma minimale e Tërheqjes së Fondit.”.

d) Seksioni 3.05 i Termave dhe i Kushteve Standardë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet me tekstin e mëposhtëm:

“Seksioni 3.05 Tarifa e Angazhimit dhe Komisioni Fillestar

a) Huamarrësi i paguan Bankës një Tarifë Angazhimi në normën e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, e pagueshme në Shumën e Disponueshme plus çdo shumë të Huas që i nënshtrohet një Angazhimi për Rimbursim dhe nuk është tërhequr akoma, me kusht që Tarifa e Angazhimit e pagueshme për shumën e Huas që i nënshtrohet një Angazhimi për Rimbursim të pakushtëzuar do të jetë 0,5% në vit më e lartë se norma e Tarifës së Angazhimit të specifikuar në Marrëveshjen e Huas. Tarifa e Angazhimit shtohet:



1. Për Këstin 1, nga data që korrespondon 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas datës së Marrëveshjes së Huas; dhe

2. Për Këstin 2, nga Data e Disponueshmërisë së Këstit 2; ose

3. Në rastin e Tarifës së Angazhimit të pagueshme për shumën e Huas, në bazë të një Angazhimi për Rimbursim të kushtëzuar, nga data e lëshimit të një Angazhimi të tillë për Rimbursim të pakushtëzuar,

me kusht që Tarifa e Angazhimit të shtohet dhe të llogaritet mbi të njëjtën bazë si interesi sipas seksionit 3.04(b)(ii). Tarifa e Angazhimit paguhet në çdo Datë të Pagesës së Interesit (pavarësisht se në atë nuk paguhet asnjë interes), duke filluar nga Data e parë e Pagesës së Interesit, pas: i. Datës Efektive për Këstin 1; dhe ii. [Datën e Disponueshmërisë së Këstit 2 për Këstin 2].

b) Huamarrësi i paguan Bankës komisionin fillestar të barabartë me një për qind (1%), përkatësisht të shumës së principalit të Këstit 1 dhe Këstit 2.

c) Banka, në emër të Huamarrësit, tërheq nga Shuma e Disponueshme e Këstit 1 në Datën e Hyrjes në Fuqi, ose brenda 7 (shtatë) ditëve më pas, dhe i paguan vetes shumën e Komisionit Fillestar të pagueshme për Këstin 1, në përputhje me seksionin 3.05(b);

d) Banka, në emër të Huamarrësit, tërheq Shumën e Disponueshme nga Kësti 2 në Datën e Disponueshmërisë të Këstit 2, ose brenda 7 (shtatë) ditëve më pas, dhe i paguan vetes shumën e Komisionit Fillestar të pagueshëm për Këstin 2, në përputhje me seksionin 3.05(b);

e) Të gjithë termat me germë të mëdha të përdorur në këtë seksion 3.05 dhe që nuk janë përcaktuar ndryshe këtu, kanë kuptimin e përshkruar për terma të tillë në Marrëveshjen e Huas.”

Seksioni 1.02 Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje (duke përfshirë preambulën dhe skedulet), përveç nëse përcaktohet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe, termat e përcaktuar në Preambulë kanë kuptimet përkatëse që u janë dhënë atyre në të, termat e përcaktuar në Termat dhe Kushtet Standardë kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në të dhe termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Autorizim” nënkupton çdo pëlqim, regjistrim, depozitim, marrëveshje, noterizim, certifikatë,

licencë, miratim, leje, autorizim ose përjashtim nga ose me ndonjë Autoritet Qeveritar, pavarësisht nëse jepet ose tërhiqet me veprim të shprehur ose konsiderohet i dhënë ose i tërhequr me mosveprim brenda ndonjë periudhe të caktuar kohore dhe të gjitha miratimet ose pëlqimet e korporatave, kreditorëve dhe aksionarëve.

“Përfaqësues i Autorizuar i Huamarrësit” nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Huamarrësit.

“ClientNet” nënkupton portalin *online* të Bankës për transmetimin e dokumenteve dhe të informacionit ndërmjet Bankës dhe klientëve të saj dhe çdo faqe interneti zëvendësuese, siç Banka mund të njoftojë herë pas here Huamarrësin.

“Kërkesat e Përcaktuara të Performancës” nënkupton Kërkesat e Performancës nga 1 deri në 8 dhe 10 (ose, siç mund të kërkojë konteksti, ndonjë prej këtyre Kërkesave të Performancës) të Kërkesave të Performancës të prillit 2019 dhe të lidhura me Politikën Sociale dhe Mjedisore të Bankës të prillit 2019.

“Politika dhe Procedurat e Zbatimit” nënkupton Politikën dhe Procedurat e Zbatimit të Bankës, të datës 4 tetor 2017.

“Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social” nënkupton planin e masave zbutëse dhe përmirësimit mjedisor dhe social, një kopje e së cilës i bashkëngjitet kësaj Marrëveshjeje si shtojca 3, pasi një plan i tillë mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak me shkrim të Bankës, në përputhje me seksionin 3.04[(e)].

“Dokumentacion Informues për Klientin mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale” nënkupton informacionin me shkrim të siguar nga ose në emër të Huamarrësit për Bankën, në përputhje me pyetësonin mjedisor dhe social të datës 23 shkurt 2021, që përmban informacion që lidhet, ndër të tjera, me Çështjet Mjedisore dhe Sociale dhe çdo ndryshim ose plotësim të një informacioni të tillë që pranohet nga Banka.

“Ligj për Çështjet Mjedisore dhe Sociale” nënkupton çdo ligj të zbatueshëm në çdo juridiksion përkatës, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, punëtorëve, komuniteteve ose personave të prekur nga projekti.

“Filialet Ekzistuese” nënkupton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes sh.a., një shoqëri e regjistruar dhe që ushtron aktivitetin në Shqipëri, Furnitorin e Shërbimit Universal sh.a., një shoqëri e



regjistruar dhe që ushtron aktivitetin në Shqipëri, dhe Furnitorin e Tregut të Lirë sh.a., një shoqëri e regjistruar dhe që ushtron aktivitetin në Shqipëri.

Çështjet Mjedisore dhe Sociale” nënkupton çdo çështje që është subjekt i ndonjë ligji për çështjet Mjedisore dhe Sociale, çdo Kërkesë e Përcaktuar e Performancës ose Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social.

“Vit Fiskal” nënkupton vitin fiskal të Huamarrësit që fillon në datën 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

“Autoriteti Qeveritar” nënkupton qeverinë e Garantuesit ose të çdo nënndarjeje politike të saj, qoftë shtetërore, rajonale ose lokale, dhe çdo agjenci, autoritet, degë, departament, organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore ose subjekt tjetër që ushtron kompetenca ose funksione ekzekutive, legjislativë, gjyqësore, tatimore, rregullatore ose administrative ose që i përkasin qeverisë ose çdo nënndarjeje të saj (përfshirë çdo organ shumëkombësh) dhe të gjithë zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit e secilit nga sa më sipër.

“SNRF” nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të lëshuara ose miratuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit dhe të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme.

“Konsulent i Pavarur për Çështjet Mjedisore dhe Sociale” nënkupton një firmë me konsulentë, siç mund të zgjidhet herë pas here nga Banka.

“Plani i Investimit” nënkupton një plan investimi që është aprovuar zyrtarisht herë pas here nga bordi mbikëqyrës dhe/ose drejtues i Huamarrësit.

“Licenca” nënkupton licencat e biznesit numër 251 (P14FPP seria) dhe numër 250 (P14SH) të lëshuara nga Rregullatori Shqiptar i Energjisë për Huamarrësin dhe më pas të transferuara te Filialet Ekzistuese.

“Ndikim Material Negativ” nënkupton një efekt material negativ për: a) gjendjen financiare të Huamarrësit dhe filialeve ekzistuese të tij; ose b) aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje; ose c) Projektin.

“Llogari e Veçantë” nënkupton llogarinë e veçantë të depozitës, të përmendur në seksionin 2.03 dhe në skedulin 5.

“Statute” nënkupton Statutin e Huamarrësit të aprovuar nga Asambleja e Aksionarëve në 1 Dhjetor 2020, përmes vendimit numër 7551/1.

“Kësti” nënkupton, siç mund të kërkojë konteksti, Këstin 1 ose Këstin 2.

“Kësti 1” ka kuptimin e përshkruar në seksionin 2.01(b)(1).

“Kësti 2” ka kuptimin e përshkruar në seksionin 2.01(b)(2).

“Data e Disponueshmërisë së Këstit” nënkupton datën në të cilën plotësohen të gjitha kushtet e referuara në seksionin 2.01(c) dhe Kësti 2 është bërë i disponueshëm për Tërheqjet e Fondit, siç është njoftuar nga Banka për Huamarrësin me shkrim, në përputhje me seksionin 2.01(c)(5).

Seksioni 1.03 Interpretimi

Në këtë Marrëveshje, një referencë ndaj një neni, seksioni ose skeduli të specifikuar, përveç kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje, interpretohet si referencë ndaj atij neni ose seksioni ose skeduli të specifikuar të kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Kushtet kryesore të huas

Seksioni 2.01 Shuma dhe Monedha

a) Banka bie dakord t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar ose të përmendur në këtë Marrëveshje, shumën deri 70,000,000 euro (shtatëdhjetë milionë euro).

b) Huaja konsiston:

1. Kësti 1 në vlerë deri në euro 55,000,000 (pesëdhjetë e pesë milionë euro) (“Kësti 1”); dhe

2. Kësti 2 në shumën euro 15,000,000 euro (peshmbëdhjetë milionë euro) (“Kësti 2”).

c) Pavarësisht nga ndonjë gjë në të kundërtën, të shprehur ose të nënkuptuar në këtë Marrëveshje, Kësti 2 është i pambyllur dhe, si rrjedhojë, Banka nuk do të ketë asnjë detyrim për të bërë ndonjë disbursim ose për të vijuar me ndonjë Tërheqje Fondi, sipas Këstit 2, përveç nëse:

1. Banka, duke vepruar sipas diskrecionit të saj të vetëm, përmbush kërkesën e saj me rezultatet e kujdesit të plotë të duhur (përfshirë teknike, mjedisore dhe sociale), në lidhje me përdorimin e propozuar të të ardhurave të Këstit 2;

2. Banka do të marrë një Plan të përditësuar të Veprimit Mjedisor dhe Social, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën;



3. Banka do të marrë projektin teknik dhe kërkesat teknike të nënstacionit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të pranueshme për Bankën;

4. Banka do të marrë dokumente dhe mendime të tjera ligjore, siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme; dhe

5. Banka do të vendosë në diskrecionin e saj të vetëm dhe absolut, se është e përgatitur të vendosë Këstin 2 të disponueshëm për Tërheqjet e Fondit dhe do të njoftojë Huamarrësin me shkrim për këtë përcaktim pozitiv.

Seksioni 2.02 Kushte të Tjera Financiare të Huas

a) shuma Minimale e Tërheqjeve të Fondit do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro) për Këstin 1 dhe 1,000,000 euro (një milion euro) për këstin 2;

b) shuma Minimale e Parapagimit do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro);

c) shuma Minimale e Anulimit do të jetë 5,000,000 euro (pesë milionë euro);

d) datat e Pagesës së Interesit do të jenë 30 mars dhe 30 shtator të çdo viti.

e) 1. [Huamarrësi do të shlyejë Huan në këste gjysmëvjetore të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) në secilën datë të Pagesës së Interesit të çdo viti, me Datën e parë të Shlyerjes së Huas, që është 30 shtator 2022 dhe Datën e fundit të Shlyerjes së Huas që është 30 mars 2026.

2. Pavarësisht sa më lart, në rast se: i. Huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e Këstit 1 dhe/ose Këstit 2 para Datës së parë të Shlyerjes së Huas të specifikuar në këtë seksion 2.02(e); dhe ii. Banka zgjat Datën e Fundit të Disponueshmërisë, sipas rastit, për Këstin 1 dhe/ose Këstin 2, të specifikuar në seksionin 2.02(f) më poshtë në një datë që bie pas Datës së parë të Shlyerjes së Këstit, atëherë shuma e çdo tërheqje fondi të kryer në ose pas Datës së parë të Shlyerjes së Huas do të alokohet për shlyerje në shuma të barabarta me disa Data të Shlyerjes së Huas, që përkojnë pas datës së një transferimi të tillë (ku Banka përshtat shumat e alokuara, sipas nevojës, për të arritur numra të plotë në secilin rast). Banka do të njoftojë herë pas here Huamarrësin në lidhje me këto alokime.

f) Data e Fundit e Disponueshmërisë do të jetë:

i. në lidhje me Këstin 1, data që korrespondon 12 muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje ose një datë e tillë e mëvonshme që Banka mund, në

diskrecionin e saj, të vendosë dhe njoftojë Huamarrësin dhe Garantuesin, dhe

ii. në lidhje me Këstin 2, data më e hershme ndërmjet: a) datës që korrespondon 24 muaj pas Datës së Disponueshmërisë së Këstit 2; dhe b) datës që korrespondon 36 muaj pas datës së kësaj Marrëveshjeje, ose datë të tillë të mëvonshme që Banka mund, në diskrecionin e saj, të vendosë dhe njoftojë Huamarrësin dhe Garantuesin.

g) Norma e Tarifës së Angazhimit do të jetë 0.5% në vit.

h) Huaja i nënshtrohet një Norme të Ndryshueshme Interesi.

Seksioni 2.03 Tërheqjet e Fondit dhe Llogaria e Veçantë

a) Shuma e Disponueshme mund të tërhiqet herë pas here, në përputhje me dispozitat e skedulit 2, për të financuar: 1. Shpenzimet operative dhe shpenzimet e bëra (ose, nëse Banka bie dakord, që do të bëhen), në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin në përputhje me shtojcën 1; dhe 2. Komisionin Fillestar.

b) Huamarrësi, për qëllime të Projektit, do të hapë dhe do të mirëmbajë një llogari të veçantë depozite të shprehur në Monedhën e Huas, në një bankë tregtare të pranueshme për Bankën, në terma dhe kushte të pranueshëm për Bankën. Nëse Huamarrësi dëshiron dhe Banka bie dakord, të kryejë Tërheqjet e Fondit për depozitim në dhe pagesa të drejtpërdrejta nga Llogaria e Veçantë (në vend të Tërheqjeve të Fondit, sipas seksionit 2.03(a)), këto Tërheqje Fondi do të bëhen në përputhje me dispozitat e skedulit 5.

Neni III

Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 3.01 Angazhime Mbështetëse të Projektit

Përveç sipërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin IV të Termave dhe Kushteve Standardë, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) mirëmban dhe, sipas rastit, rinovon Licencat;

b) mirëmban strukturën e korporatës së Huamarrësit dhe Filialeve të tij Ekzistues, që nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe siguron që Filialet Ekzistuese të kryejnë biznes me veprimet e shpërndarjes, veprimet e furnizimit me pakicë dhe



veprimet e tregtimit që do të kryhen përmes Filialeve të veçanta Ekzistuese;

c) bashkëpunon me çdo konsulent të angazhuar në lidhje me, dhe mundëson zbatimin dhe përmbylljen e Detyrave të Bashkëpunimit Teknik;

d) bashkëpunon me Bankën me pjesëmarrjen e konsulentëve të jashtëm të angazhuar, sipas Detyrave të Bashkëpunimit Teknik, për të ndryshuar Kodin e saj të Sjelljes dhe rregullat, proceset dhe procedurat e tjera përkatëse antirryshfet dhe antikorrupsion; dhe

e) për të koordinuar, menaxhuar, për të monitoruar dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, duke përfshirë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, emëron Menaxherin e Projektit me kualifikimin e duhur dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.02 Prokurimi

Për qëllime të seksionit 4.03 të Termave dhe Kushteve Standardë, dispozitat e mëposhtme, përveç kur Banka bie dakord ndryshe, rregullojnë prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas:

a) Mallrat, punët dhe shërbimet (përveç shërbimeve të konsulentëve që përfshihen në seksionin 3.02(c)) do të prokurohen me tenderim të hapur.

b) Për qëllimet e seksionit 3.02, procedurat për tenderim të hapur, tenderim të hapur të thjeshtuar, kontraktim të drejtpërdrejtë dhe standardet për procedurat alternative të prokurimit, në përputhje me ligjin kombëtar, përcaktohen në seksionin III të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

c) Konsulentët që do të punësohen nga Huamarrësi për të ndihmuar në kryerjen e Projektit do të zgjidhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në seksionin V të Rregullave të Prokurimit të BERZH-it.

d) Të gjitha kontratat do t'u nënshtrohen procedurave të rishikimit, të përcaktuara në Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga Banka.

e) Për çdo kontratë në lidhje me të cilën pagesa duhet të bëhet nga Llogaria e Veçantë, do të ndiqen procedurat e prokurimit që sigurojnë që kërkesat e rishikimit të seksionit 3.02(d) të jenë përmbushur përpara kryerjes së pagesës së parë nga Llogaria e Veçantë, në lidhje me këtë kontratë.

Seksioni 3.03 Angazhime të Pajtueshmërisë Mjedisore dhe Sociale

Pa kufizuar përgjithësinë e seksioneve 4.02(a), 4.04(a)(iii) dhe 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standardë, Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) Huamarrësi do të bëjë dhe do të marrë masa që çdo kontraktor të kryejë Projektin dhe biznesin dhe veprimet e Huamarrësit, në përputhje me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës.

b) Pa kufizuar sa më sipër, Huamarrësi do të zbatojë me kujdes dhe do të veprojë në përputhje me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, dhe do të monitorojë zbatimin e këtij plani në përputhje me parashikimet e monitorimit të përfshira në këtë plan.

c) Huamarrësi dhe Banka mund të bien dakord herë pas here të ndryshojnë Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social në përgjigje të ndryshimeve në rrethanat e Projektit ose Huamarrësit, ngjarjeve të paparashikuara dhe rezultateve të monitorimit. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër.

1. Nëse ka ndonjë ndikim negativ mjedisor ose social ose çështje që nuk ishte parashikuar ose e përfshirë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social, plotësisht ose sa i përket ashpërsisë së tij;

2. Nëse ka ndonjë ndikim ose çështje negative mjedisore ose sociale që nuk është vlerësuar dhe trajtuar gjatë rishikimit të Projektit nga BERZH-i;

3. Nëse ndonjë masë e zbutjes së ndikimit, të përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social nuk është e mjaftueshme për të eliminuar ose zvogëluar çdo ndikim mjedisor ose social në nivelin e parashikuar nga Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, brenda kornizës kohore të përcaktuar në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social; ose

4. Nëse ekziston ndonjë mospërputhje materiale me Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose me ndonjë Ligj për Çështjet Mjedisore dhe Sociale është identifikuar nga Huamarrësi, Banka ose në vijim të një kontrolli të kryer nga ndonjë autoritet rregullator ose i zbatimit ose nga ndonjë auditim i kryer, në përputhje me seksionin 3.04(d);

Huamarrësi, sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur dhe në varësi të miratimit të Bankës, do të zhvillojë dhe përfshijë në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ato masa lehtësuese shtesë ose të rishikuara, që mund të jenë të nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me Kërkesat e Përcaktuara



të Performancës, Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social ose Ligjet Mjedisore dhe Sociale, në secilin rast në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

Seksioni 3.04 Konsulentët

a) Për të ndihmuar në zbatimin e Projektit, Huamarrësi, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Bankën, punëson ose merr masa që të punësohet, siç kërkohet, dhe të përdorë konsulentë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës së të cilëve janë të pranueshëm për Bankën.

b) Huamarrësi siguron, pa pagesë, për çdo konsulent të angazhuar për të ndihmuar në çështjet që lidhen me Projektin ose veprimet e Huamarrësit, të gjitha lehtësitë dhe mbështetjen e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre, përfshirë hapësirën për zyrë, pajisjet e fotokopjimit dhe furnizimet, shërbimet e sekretarisë dhe transportin, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionet e tjera që mund të jenë të rëndësishme për punën e tyre.

Seksioni 3.05 Shpeshhtësia e Raportimit dhe Kërkesat e Paraqitjes

a) Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, derisa shuma e plotë e Huas të jetë shlyer ose anuluar, Huamarrësi do t'i paraqesë Bankës raporte gjysmëvjetore mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale që lindin në lidhje me Huamarrësin ose Projektin, siç referohet në seksionin 5.02(c)(iii) të Termave dhe Kushteve Standardë, brenda 60 ditëve pas përfundimit të periudhës gjysmëvjetore për të cilën raportohet. Këto raporte përfshijnë informacione për çështjet e mëposhtme specifike:

1. Informacion mbi pajtueshmërinë nga Huamarrësi me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës, siç përshkruhet në seksionin 3.04(a) dhe në zbatimin e Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social;

2. Informacion mbi mënyrën sesi Huamarrësi ka monitoruar pajtueshmërinë me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës dhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social nga çdo kontraktor i angazhuar për Projektin dhe një përmbledhje të çdo mospërputhjeje materiale nga një kontraktues i tillë me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës dhe Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social dhe çdo masë të marrë për të korrigjuar një mospërputhje të tillë;

3. Informacion mbi zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesit dhe mekanizmin e ankesave, të kërkuara nga Kërkesa e Përcaktuar e

Performancës 10, përfshirë një përmbledhje të ankesave të marra dhe mënyrën e zgjidhjes së këtyre ankesave;

4. Informacion mbi pajtueshmërinë nga Huamarrësi me Ligjet Mjedisore dhe Sociale, në lidhje me Projektin dhe biznesin dhe veprimet e Huamarrësit, përfshirë një përshkrim të çdo pretendimi, procedimi, urdhri ose hetimi të filluar ose të kanosur ndaj Huamarrësit, statusin e çdo Autorizimi të nevojshëm për Projektin, rezultatet e çdo inspektimi të kryer nga ndonjë autoritet rregullator, çdo shkelje e ligjeve, rregulloreve ose standardeve në fuqi dhe çdo veprim korrigjues ose gjobë, në lidhje me një shkelje të tillë, një përmbledhje të çdo njoftimi material, raport dhe komunikim tjetër mbi Çështjet Mjedisore dhe Sociale, në lidhje me Projektin dhe biznesin dhe veprimet e Huamarrësit të paraqitura nga Huamarrësi te çdo autoritet rregullator dhe çdo rrethanë tjetër që shkakton përgjegjësinë e Huamarrësit për ndonjë Çështje Mjedisore dhe Sociale;

5. Informacion mbi menaxhimin e shëndetit dhe të sigurisë në punë dhe të dhënat mbi shëndetin dhe sigurinë në punë të Projektit dhe biznesin dhe veprimet e Huamarrësit, përfshirë shkallën e aksidenteve, incidentet me kohën e humbur në punë dhe gati humbjet e jetës, çdo masë parandaluese ose lehtësuese e marrë ose e planifikuar nga Huamarrësi, çdo trajnim i stafit për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe çdo iniciativë tjetër, në lidhje me shëndetin dhe menaxhimin e sigurisë në punë, të cilat janë zbatuar ose planifikuar nga Huamarrësi;

6. Një përmbledhje të çdo ndryshimi në Ligjet Mjedisore dhe Sociale, të cilat mund të kenë një efekt material në Projekt; dhe

7. Kopjet e çdo informacioni mbi çështjet mjedisore dhe sociale të paraqitura periodikisht nga Huamarrësi për publikun e gjerë.

b) Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi, Huamarrësi do të paraqesë raportet periodike të Projektit të referuara në seksionin 4.04(a)(v) të Termave dhe Kushteve Standardë, në bazë gjysmëvjetore, brenda 120 ditëve pas përfundimit të periudhës për të cilën raportohet, derisa Projekti të ketë përfunduar. Këto raporte përfshijnë karakteristikat specifike të mëposhtme:

1. Informacionin e përgjithshëm, si më poshtë:



A. Progresin fizik të arritur në zbatimin e Projektit, deri në datën e raportit dhe gjatë periudhës së raportimit;

B. Vështirësitë ose vonesat aktuale ose të pritshme në zbatimin e Projektit dhe efektin e tyre në skedulin e zbatimit, dhe hapat aktualë të ndërmarrë ose të planifikuar për të kapërcyer vështirësitë dhe për të shmangur vonesat;

C. Ndryshimet e pritshme në datën e përfundimit të Projektit;

D. Ndryshimet e personelit kryesor në Menaxherin e Projektit, konsulentët ose kontraktuesit;

E. Çështjet që mund të ndikojnë në koston ose zbatimin e Projektit; dhe

F. Çdo zhvillim ose aktivitet që mund të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të Huamarrësit, Filialet të tij ose ndonjë Pjese të Projektit;

G. Çdo ndryshim në Licencat e mbajtura nga Huamarrësi dhe Filialet e tij;

H. Çdo ndryshim në flukset e energjisë dhe normat e grumbullimit, që prekin Huamarrësin dhe Filialet e tij; dhe

I. Çdo ndryshim në Planin e Investimeve.

2. Një deklaratë e shkurtër e statusit të pajtueshmërisë me secilën prej angazhimeve të përfshira në këtë Marrëveshje.

c) Sapo të vihet në dijeni për ndodhinë e ndonjë incidenti ose aksidenti, në lidhje me Huamarrësin ose Projektin, që ka ose mund të ketë një efekt të dukshëm negativ te mjedisi, punëtorët, për publikun ose shëndetin dhe sigurinë publike në punë, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë pas kësaj do t'i japë njoftim Bankës, duke specifikuar natyrën e një incidenti ose aksidenti të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerr për ta korrigjuar atë. Kur një incident përfshin informacionin sensitiv, në lidhje me një person ose ndonjë rrezik për hakmarrjeje, njoftimi fillestar për Bankën nuk do të përfshijë asnjë detaj të identitetit të personave të përfshirë. Pa kufizuar përgjithësinë e sa më sipër:

1. Një incident ose aksident ka të bëjë me Projektin, nëse ndodh në ndonjë vend të përdorur për Projektin ose nëse është shkaktuar nga punëtorët e Projektit dhe/ose objektet, pajisjet, automjetet ose mjetet lundruese të përdorura për ose që kanë lidhje me Projektin (pavarësisht nëse përdoren ose jo në ndonjë vend të Projektit dhe

pavarësisht nëse përdoren ose jo nga persona të autorizuar ose të paautorizuar);

2. Një incident ose aksident konsiderohet të ketë një efekt të dukshëm negativ te mjedisi ose shëndeti, ose siguria publike ose në punë, nëse:

A. Sipas ndonjë ligji të zbatueshëm kërkohet dërgimi i njoftimit, për një incident ose aksident të tillë, te çdo Autoritet Qeveritar;

B. Një incident ose aksident i tillë përfshin aksident me vdekje të ndonjë personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar nga Huamarrësi);

C. Më shumë se një person (pavarësisht nëse këto persona janë ose jo të punësuar nga Huamarrësi) ka marrë dëmtime të rënda dhe shtrimi në spital është i domosdoshëm;

D. Një incident i tillë përfshin dhunë dhe ngacim, bullizëm, frikësim dhe/ose shfrytëzim, duke përfshirë çdo formë të dhunës me bazë gjinore;

E. Një incident i tillë përfshin punë të detyruar dhe të fëmijëve, në lidhje me biznesin dhe veprimet e Huamarrësit; ose

F. Publiku është vënë ose mund të vihet në dijeni mbi një incident ose aksident të tillë, qoftë përmes mbulimit nga media ose ndryshe.

d) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo kundërshtim ose petition të rëndësishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut, të drejtuar për, ose lidhur me Huamarrësin ose Projektin, që mund të ketë një efekt negativ material te Huamarrësi ose Projekti ose është bërë ose mund të bëhet publike përmes mbulimit me media ose ndryshe. Brenda dhjetë ditëve pas çdo njoftimi të tillë, Huamarrësi do të paraqesë një raport të pranueshëm për Bankën, duke specifikuar rezultatin e hetimit të Huamarrësit për një kundërshtim ose petition të tillë, dhe çdo hap të ndërmarrë ose që propozohet të ndërmerret nga Huamarrësi, për të zgjidhur çështjet e ngritura në kundërshtimin.

e) Menjëherë pasi të informohet për çdo ndryshim të propozuar në kornizën rregullatore dhe ligjore që ndikon në biznesin e Huamarrësit dhe filialet të tij, Huamarrësi do të njoftojë Bankën për këtë.

f) Me kërkesë të Bankës, Huamarrësi do të paraqesë një raport në lidhje me përdorimin e fondeve të tërhequra sipas kësaj Marrëveshjeje, shumat që Huamarrësi ka paguar, në lidhje me secilën kategori të përmendur në përdorimin e të



ardhurave, të gjitha në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

g) Menjëherë pas ndodhies së ndonjë incidenti që mund të ndikojë materialisht në pozicionin financiar të Huamarrësit ose ndonjë zhvillim ose ndodhi të ndonjë ngjarjeje, që mund të ndikojë në biznesin e Huamarrësit dhe filialeve të tij, Huamarrësi do t'i japë Bankës njoftimin, duke specifikuar natyrën e një incidenti të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi po ndërmerret për ta korrigjuar, nëse ka ndonjë.

g) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën (por jo më vonë se 60 ditë përpara se të merret ndonjë vendim, në lidhje me një pushim të tillë kolektiv nga puna, të planifikuar), për çdo pushim të tillë kolektiv nga puna që prek të paktën 10% të totalit të punonjësve të Huamarrësit ose 30 nga të punësuarit e tij (cilado të jetë më e vogël), për një periudhë 30-ditore. Në rastin e ndonjë pushimi kolektiv nga puna, të planifikuar, që prek të paktën 25% të totalit të punonjësve të Huamarrësit ose 500 nga të punësuarit e tij (cilado të jetë më e vogël) për një periudhë 30 ditë, në kohën kur i jep një njoftim të tillë Bankës, Huamarrësi do t'i japë, gjithashtu, Bankës një plan të zbatueshëm për menaxhimin e procesit, në përputhje me Kërkesat e Përcaktuara të Performancës.

Neni IV

Angazhimet financiare dhe operacionale

Seksioni 4.01 Të Dhënat dhe Raportet Financiare

a) Huamarrësi do të mbajë procedurat, të dhënat dhe llogaritë, për të pasqyruar siç duhet, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), të zbatuara në mënyrë të vazhdueshme, veprimet dhe gjendjen financiare të Huamarrësit dhe Ndërmarrjeve të tij, nëse ka ndonjë, dhe të përshtatshme për të monitoruar dhe për të regjistruar progresin e Projektit (përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të vijnë nga ai).

b) Huamarrësi:

1. Do të ketë të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të tij (përfshirë bilancin, pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e ndryshimeve në pozicionin financiar dhe shënimet mbi to), përfshirë ato në lidhje me Llogarinë e Veçantë për secilin plotësim dhe raportin përfundimtar të

rakordimit të Llogarisë së Veçantë, dhe të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare të Ndërmarrjeve të tij, për çdo Vit Fiskal, të audituar nga auditorë të pavarur të pranueshëm për Bankën, në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht;

2. Do t'i japë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se katër muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal:

A. Kopje të vërtetuara të pasqyrave të tij financiare për një Vit të tillë Fiskal, siç janë audituar;

B. Raportin e një kontrolli të tillë nga auditorë të tillë me një objekt të tillë dhe në detaje të tilla siç mund të kërkojë Banka; dhe

C. Një pasqyrë të të gjitha transaksioneve financiare midis Huamarrësit dhe secilit nga Ndërmarrjet dhe Filialet e tij;

D. Një diskutim mbi menaxhimin dhe analizën e rezultateve për një periudhë të tillë, përfshirë një raport mbi çdo faktor që ndikon materialisht dhe negativisht ose që mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në biznesin, veprimet ose gjendjen financiare të Huamarrësit ose një deklaratë që nuk ka faktorë të tillë;

3. Do t'i dorëzojë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë pas përfundimit të çdo tremujori:

A. Kopjet e vërtetuara të pasqyrave të tij financiare të paaudituar për këtë tremujor;

B. Një pasqyrë të të gjitha transaksioneve financiare ndërmjet Huamarrësit dhe secilit nga Ndërmarrjet dhe Filialet e tij;

C. Një diskutim mbi menaxhimin dhe analizën e rezultateve për një periudhë të tillë, duke përfshirë një raport mbi çdo faktor që ndikon materialisht dhe negativisht ose që mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në biznesin, veprimet ose gjendjen financiare të Huamarrësit ose një deklaratë që nuk ka faktorë të tillë.

4. Do t'i paraqesë Bankës sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se një muaj para përfundimit të çdo Viti Fiskal, një plan biznesi 3-vjeçar, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, i cili do të përfshijë, por pa u kufizuar në, shpenzimet operative, prodhimin dhe tarifat e planifikuara, investimet në të ardhura dhe ndikimin e mundshëm në raportet financiare të specifikuar në seksionin 4.03 më poshtë.



5. Do t'i paraqesë Bankës informacione të tjera, në lidhje me të dhënat, llogaritë dhe pasqyrat financiare, dhe auditimin e tyre, siç mund të kërkojë Banka herë pas here në mënyrë të arsyeshme.

Seksioni 4.02 Angazhimet Negative

a) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin, siç Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në ndonjë marrëveshje ose angazhim, për të garantuar ose në ndonjë mënyrë, ose sipas ndonjë kushti për t'u bërë i detyruar për të gjithë ose për ndonjë pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose tjetër të një personi tjetër, përfshirë çdo Ndërmarrje ose Filial;

2. Të hyjë në ndonjë transaksion me ndonjë person, përveç në rrjedhën e zakonshme të biznesit, mbi kushte të zakonshme tregtare dhe në bazë të angazhimeve të tregu, ose të krijojë ndonjë agjenci të vetme dhe ekskluzive të blerjeve ose shitjeve, ose të hyjë në ndonjë transaksion përmes të cilit Huamarrësi mund të paguajë më shumë se çmimi i zakonshëm tregtar për çdo blerje ose mund të marrë më pak se çmimi i plotë i tregut (sipas zbritjeve normale të tregut) për produktet ose shërbimet e tij;

3. Të hyjë në ndonjë partneritet, ndarje fitimi ose Marrëveshje për Tarifat e Licencave ose marrëveshje tjetër të ngjashme me të cilën të ardhurat ose fitimet e Huamarrësit ndahen ose mund të ndahen me ndonjë person tjetër;

4. (Në mënyrë vullnetare ose jovullnetare) të bëjë ndonjë parapagim, riblerje ose shlyerje të parakohshme të ndonjë borxhi ose të bëjë një shlyerje të ndonjë borxhi, në përputhje me ndonjë dispozitë të ndonjë marrëveshjeje ose shënimi, që siguron drejtpërdrejt ose indirekt përshpejtimin e ripagimit në kohë ose shumë, përveç nëse në ndonjë rast të tillë, nëse Banka e kërkon, Huamarrësi në të njëjtën kohë bën një parapagim proporcional të shumës principal të papaguar të Huas, në përputhje me dispozitat e seksionit 3.07 të Termave dhe Kushteve Standardë (përveç kur shuma e ndonjë parapagimi të tillë nuk do t'u nënshtrohet kërkesave të shumës minimale të parapagimit);

5. Të shesë, transferojë, japë me qira ose ndryshe disponojë të gjitha ose një pjesë të konsiderueshme të aseteve të tij (në një transaksion

të vetëm ose në një seri transaksionesh, të lidhura ose ndryshe);

6. Të ndërmarrë ose lejojë ndonjë bashkim, konsolidim ose riorganizim i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, mund të ketë një efekt material negativ.

7. Të shtojë ose të marrë përsipër ndonjë borxh financiar që mund të rezultojë në shkelje të raporteve financiare të specifikuar në seksionin 4.03 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse informon Bankën të paktën 30 ditë përpara, ndonjë nga veprimet e mëposhtme dhe do t'i sigurojë Bankës të gjithë informacionin, siç mund të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme:

1. Të hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi ose të ngjashme angazhimi, me të cilën biznesi ose veprimet e tij menaxhohen nga ndonjë person tjetër, përfshirë çdo Ndërmarrje ose Filial; ose

2. Të formojë ndonjë Ndërmarrje (përveç Ndërmarrjeve Ekzistuese), ose të bëjë ose lejojë të ekzistojnë hua ose paradhënie, ose depozita (përveç depozitave në rrjedhën e zakonshme të biznesit në banka me reputacion), me persona të tjerë ose investime në ndonjë person, përfshirë çdo Ndërmarrje ose Filial; megjithatë, me kusht që Huamarrësi do të jetë i lirë të investojë në letra me vlerë të tregtueshme të shkallës së investimeve afatshkurtra, vetëm për t'i dhënë punësim të përkohshëm burimeve boshe të Huamarrësit.

Seksioni 4.03 Angazhimet Financiare

a) Pa kufizuar përgjithësinë e seksionit 4.02, Huamarrësi:

1. Do të mbajë një Borxh Financiar Neto ndaj raportit EBITDA (*fitimet para interesit, taksave, zhblerësimit dhe amortizimit*), jo më shumë se:

i. 4.5 x në çdo kohë nga data 1 janar 2021 dhe deri në dhe përfshirë datën 31 dhjetor 2021;

ii. 4.0 x në çdo kohë nga data 1 janar 2022 dhe deri në dhe përfshirë datën 31 dhjetor 2022; dhe

iii. 3.5 x në çdo kohë nga data 1 janar 2023.

2. Në çdo kohë, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi, do të mbajë një raport EBITDA ndaj normës së interesit të paktën 5 x.

3. Do të rrisë Normat e Grumbullimit të paktën: 93% në Vitin Financiar 2022, 95% në Vitin Financiar 2023, 96% në Vitin Financiar 2024 dhe 97% në çdo kohë pas kësaj.

b) Për qëllimet e këtij seksioni, raportet financiare të specifikuar në paragrafin “a” më sipër



do të llogariten në përputhje me SNRF-në dhe duke përdorur pasqyrat financiare të audituara më së fundmi, dhe termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

“EBITDA” nënkupton, në lidhje me çdo periudhë, të gjitha fitimet e Huamarrësit para interesit, taksave, zhvlerësimit dhe amortizimit, të llogaritura në përputhje me SNRF;

“Borxhi Financiar Neto” nënkupton, në lidhje me çdo datë, shumën e:

1. Të gjithë borxhit financiar të Huamarrësit, mbi një bazë të konsoliduar, në atë datë;

“Tarifat e Grumbullimit” nënkupton në lidhje me çdo periudhë, shumën totale të parave të gatshme të marra nga të ardhurat operative në atë periudhë pjesëtuar me të ardhurat totale operative të së njëjtës periudhë.

Seksioni 4.04 Kryerja e Biznesit dhe Operacioneve

Huamarrësi, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) kryen biznesin dhe veprimet e tij në përputhje me standardet dhe praktikën administrative, financiare, inxhinierike dhe të shëndosha të njohura ndërkombëtarisht dhe duke marrë parasysh të gjitha politikat kryesore të funksionimit;

b) ndërmerr menjëherë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, për të ruajtur ekzistencën e tij ligjore, për të vazhduar veprimtarinë e tij dhe për të marrë, ruajtur dhe rinovuar të gjitha të drejtat, pronat, kompetencat, privilegjet dhe ekskluzivitetet, që janë të nevojshme për ushtrimin e biznesit të tij, duke përfshirë realizimin e Projektit;

c) nuk shet, jep me qira ose disponon në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë prej asetëve të tij që kërkohen për kryerjen efikase të Operacioneve të tij ose disponimi i të cilave mund të dëmtojë aftësinë e tij për të kryer në mënyrë të pranueshme, cilindo nga detyrimet e tij, sipas kësaj Marrëveshjeje;

d) njofton menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, për të pezulluar ose për të shfuqizuar çdo dispozitë të Statutit dhe i jep Bankës një mundësi të përshtatshme për të komentuar mbi këtë propozim, përpara se të ndërmarrë ndonjë veprim mbi të;

e) merr dhe mirëmban me siguresit përgjegjës ose bën dispozita të tjera të pranueshme për Bankën, në lidhje me sigurimin ndaj rreziqeve të tilla të humbjes, dëmtimit dhe përgjegjësisë dhe në

shuma të tilla që janë në përputhje me praktikën e duhur;

f) në çdo kohë operon dhe mirëmban impiantin, objektet, pajisjet dhe pasurinë e tij, në gjendje të mirë pune dhe, sa më shpejt që të jetë e nevojshme, kryen të gjitha riparimet dhe ripërtëritjet e nevojshme, të gjitha në përputhje me biznesin e shëndoshë dhe praktikën financiare;

g) Huamarrësi siguron që të mos ketë përkeqësim të treguesve kryesorë të rrjetit të shpërndarjes dhe, në veçanti, siguron që normat SAIDI/SAIFI të mos bien përkatësisht poshtë nivelit 58.79 dhe 29.99,

ku

“SAIDI” nënkupton Indeksin e Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjes së Sistemit, një indeks sistemi i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes në furnizimin me energji të treguar në minuta për konsumator dhe llogaritur si më poshtë: SAIDI = kohëzgjatja totale e ndërprerjeve për një grup konsumatorësh/numri i të gjithë konsumatorëve.

“SAIFI” nënkupton Indeksin e Frekuencës Mesatare të Ndërprerjeve të Sistemit, një indeks sistemi i frekuencës mesatare të ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike dhe i llogaritur si më poshtë: SAIFI = numri i përgjithshëm i ndërprerjeve për një grup klientësh/numri i të gjithë konsumatorëve;

h) Në çdo kohë, Huamarrësi do të bëjë pagesa të plota dhe në kohë për të gjithë prodhuesit e energjisë së rinovueshme, sipas të gjitha kontratave të tij; dhe

i) Pa cenuar të drejtat e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Termave dhe Kushteve Standardë, Huamarrësi nuk do të ndërmarrë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe me Huamarrësin, ndonjë veprim që mund të ketë efekt të ndryshimit, shfuqizimit, caktimit, përfundimit ose heqjes dorë nga kjo Marrëveshje ose ndonjë dispozite të saj.

Neni V

Pezullimi dhe përsheptimi

Seksioni 5.01. Pezullimi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 7.01(a)(xvii) të Termave dhe Kushteve Standardë:

a) Kuadri legjislativ dhe rregullator i zbatueshëm për sektorin e energjisë në territorin e Garantuesit



do të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë, në një mënyrë që, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, mund të ketë një efekt material negativ, përveç atij të aprovuar nga Banka me shkrim;

b) Statuti do të jetë ndryshuar, pezulluar, anuluar, shfuqizuar ose hequr dorë, në një mënyrë që, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, mund të ketë një efekt material negativ;

c) Do të ketë ndodhur ndryshim në strukturën e korporatës (ekzistuese që nga data e kësaj Marrëveshjeje) së Huamarrësit dhe/ose Filialeve Ekzistuese, përfshirë bashkimin, konsolidimin ose riorganizimin e Huamarrësit dhe/ose Filialeve Ekzistuese, në një mënyrë që, sipas mendimit të arsyeshëm të Bankës, mund të ketë një efekt material negativ, përveç atij të aprovuar nga banka me shkrim, pa miratimin me shkrim të bankës;

d) Huamarrësi do të ketë ndërmarrë ndonjë nga veprimet e përmendura në seksionin 4.02(b), në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe negativisht në veprimet ose gjendjen financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të kryer Projektin ose për të kryer ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

e) Kontrolli i Huamarrësit i është transferuar një pale tjetër përveç Garantuesit.

Seksioni 5.02 Përshpejtimi i Maturimit

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 7.06(f) të Termave dhe Kushteve Standardë:

a) ndonjë nga ngjarjet e specifikuar në seksionin 5.01 do të ketë ndodhur dhe do të vazhdojë pa ndreqje për 30 ditë pasi njoftimi i tyre është dhënë nga Banka për Huamarrësin.

Seksioni 5.03 Anulimi

Nëse në çdo kohë, Banka përcakton që një pagesë nga, ose ndonjë përdorim i Llogarisë së Veçantë është bërë në kundërshtim me kërkesat e skedulit 5 dhe përcakton shumën e Huas, për të cilën zbatohet një keqpërdorim i tillë, Banka mund, me njoftimin për Huamarrësin dhe Garantuesin, të përfundojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë Tërheqje Fondi, në lidhje me një shumë të tillë. Pas dhënies së një njoftimi të tillë, kjo shumë e Huas do të anulohet.

Neni VI

Hyrja në fuqi

Seksioni 6.01 Kushtet para Hyrjes në Fuqi

Sa më poshtë specifikohen për qëllimet e seksionit 9.02(c) të Termave dhe Kushteve Standardë, si kushte shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjes së Garancisë:

a) Banka do të ketë marrë Statutet e Huamarrësit;

b) Kërkesa e Bankës do të jetë përmbushur, bazuar në progresin e bërë me zbatimin e ESAP-it (Plani i *veprimt mjedisor dhe social*) deri në një datë të tillë, që Huamarrësi do të zbatojë ESAP-it në përputhje të plotë me kërkesat e tij.

Seksioni 6.02 Opinionet Ligjore

a) Për qëllime të seksionit 9.03(a) të Termave dhe Kushteve Standardë, opinionin ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Huamarrësit nga Përgjegjësi i Departamentit Ligjor të Huamarrësit.

b) Për qëllime të seksionit 9.03(b) të Termave dhe Kushteve Standardë, opinionin ose opinionet e këshilltarit do të jepen në emër të Garantuesit nga ministri i Drejtësisë.

Seksioni 6.03 Përfundimi për Moshyrjen në Fuqi

Data 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e seksionit 9.04 të Termave dhe Kushteve Standardë.

Neni VII

Të ndryshme

Të ndryshme

Seksioni 7.01 Njoftimet

a) Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standardë, përveç që çdo njoftim do të konsiderohet se dorëzohet dorazi, me postë ose në formatin PDF ose në format të ngjashëm me postë elektronike:

Për Huamarrësin¹:

OPERATORI I SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SHA

Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 88, H. 1, 1023, Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Ilda Malile

Email: ilda.malile@oshee.al

¹ Huamarrësi të plotësojë kllapat.

**Për BERZH-in:**

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Administrimit të Operacioneve/Operacioni nr. 52468

Telefon: +44 20 7338 6000

Email: oad@ebrd.com

b) Banka mund të ftojë Huamarrësin të regjistrohet për të përdorur ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik dhe, nëse Huamarrësi dhe Banka bien dakord të përdorin ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër nga Huamarrësi për Bankën ose nga Banka për Huamarrësin (përveç ndonjë njoftimi, aplikimi ose komunikimi tjetër që kërkohet nga kjo Marrëveshje [ose ndonjë Marrëveshje tjetër Financimi] të jetë në një kopje origjinale, e vërtetuar ose në letër) mund, sipas termave dhe kushteve të ClientNet ose një formë tjetër të komunikimit elektronik, të jepet ose bëhet, duke postuar këtë njoftim, aplikim ose komunikim tjetër në ClientNet ose të dërguar, në përputhje me kushtet e rëna dakord, në lidhje me atë formë tjetër të komunikimit elektronik.

c) Çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër të dorëzuar dorazë, me postë ose faks ose përmes ClientNet, ose një formë tjetër të komunikimit elektronik të rënë dakord do të jetë efektive vetëm kur merret (ose vibet e Disponueshme) në formë të lexueshme, me kusht që çdo njoftim, aplikim ose komunikim tjetër që merret (ose vibet e Disponueshme) pas orës 05:00 pasdite, në vendin ku pala, së cilës i është dërguar njoftimi, aplikimi ose komunikimi përkatës, ka adresën e saj për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të konsiderohet se bëhet efektive në ditën vijuese.

Në dëshmi të kësaj, palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar rregullisht, kanë siguruar që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në katër kopje dhe të dorëzohet në Tiranë, Republikën e Shqipërisë në ditën dhe vitin e shkruar në fillim.

**OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA**

Nga: _____

Emri: Adrian Çela

Funksioni: Administrator

**BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM**

Nga: _____

Emri: Jurgen Rigtierink

Funksioni: Zëvendëspresident i Parë

SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i Projektit është: i. T'i sigurojë Huamarrësit mbështetjen e likuiditetit për të financuar blerjen e energjisë së brendshme dhe kostot e pagës bruto; dhe 2. Për të financuar ndërtimin e një nënstacioni shpërndarje 110/20 kV në Tiranë, siç përshkruhet më tej në paragrafin 2 më poshtë.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, subjekt i modifikimeve të tyre, siç mund të bien dakord Banka dhe Huamarrësi herë pas here:

Pjesa A: Shpenzimet Operative të Huamarrësit (që do të financohen nga Kësti 1):

a) pagesa për ndërmarrjet shtetërore për furnizime me energji elektrike (përveç importeve të energjisë) për Huamarrësit ose ndonjë prej filialeve të tij; dhe

b) pagesa për furnitorët privatë të energjisë elektrike (përveç importeve të energjisë) për Huamarrësin dhe/ose ndonjë prej filialeve të tij, siç është e pranueshme për Bankën dhe përjashtimin e çdo pagese për shërbimin e borxhit, pagesa të taksave ose shpenzime kapitale.

Pjesa B: Shpenzimet Kapitale (Komponentët e Investimeve) (që do të financohen nga Kësti 2)

Financimi, nga të ardhurat e Këstit 2, i punëve, mallrave dhe shërbimeve për ndërtimin e një nënstacioni për shpërndarjen e energjisë elektrike 110/20 kV në qendër të Tiranës.

Pjesa C: Bashkëpunimi Teknik (Detyra e Konsulencës):

a) përgatitja dhe zbatimi i planit të veprimit antikorrupsion, që synon përmirësimin e proceseve dhe qeverisjes antikorrupsion të Huamarrësit;

b) përgatitja e një udhërrëfyese për zhvillimin e rrjetit inteligjent;

c) përmirësimi i praktikave dhe i proceseve të tij mjedisore, shëndetësore dhe të sigurisë;

d) kryerja e trajnimeve për punonjësit e Huamarrësit, duke rritur aftësitë e tyre teknike me një komponent të theksuar gjinor; dhe

e) mbështetje këshilluese për përgatitjen e projektit, prokurimin, kontraktimin dhe mbikëqyrjen e punëve të parashikuara në pjesën B: Shpenzimet Kapitale.

3. Projekti pritët të përfundojë deri më [31] dhjetor 2024.



SKEDULI 2 – KATEGORITË DHE TËR- HEQJET E FONDIT

1. Tabela më poshtë përcakton Kategoritë, shumën e Huas së alokuar për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në secilën Kategori.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 më lart,

a) asnjë Tërheqje Fondi nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra para datës së marrëveshjes së Huas; dhe

b) asnjë Tërheqje Fondi e Këstit 1 nuk do të bëhet në lidhje me pagesën për një furnitor privat të energjisë elektrike për Huamarrësin, derisa ky furnitor privat të hyjë në një sipërmarrje të ligjshme detyruese të integritetit në formën e shtojcës 4 dhe në përmbajtje të pranueshme për Bankën, dhe ky dokument do t'i bashkëngjitet kërkesës për Tërheqje Fondi.

c) Asnjë tërheqje e Këstit 2 nuk do të bëhet derisa Huamarrësi të ketë emëruar Menaxherin e Projektit.

Bashkëlidhur skedulit 2

Kategoria	Shuma e Huas e alokuar në Monedhën e Huas	% e shpenzimeve që duhet të financohen (duke përjashtuar Taksat)
1. Mbështetja e likuiditetit për komponentët (a), dhe (b) të pjesës A të Projektit		
Kësti 1	EURO 54,450,000	100%
2. Punët, mallrat dhe shërbimet për pjesën B dhe pjesën C(c) dhe (e) të Projektit		
Kësti 2	EURO 14,850,000	100%
3. Komisioni Fillestar për Këstin 1	EURO 550,000	100%
4. Komisioni Fillestar për Këstin 2	EURO 150,000	100%
TOTAL	EURO 70,000,000	



SKEDULI 3 – PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL

PLANI I VEPRIMIT MJEDISOR DHE SOCIAL - 52360 VISP: REAGIMI I OSHEE-së NDAJ PANDEMISË COVID-19

Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësia/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
PR1	Vlerësimi dhe Menaxhimi i Ndikimeve dhe i Çështjeve Mjedisore dhe Sociale						
1.1	Të caktohet brenda OSHEE-së një person që të jetë përgjegjës për zbatimin e ESAP-it (Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social) gjatë kohëzgjatjes së Huas.	Implementimi i kërkesave E&S (Mjedisi & Siguria)	Ligji shqiptar BERZH PR (Kërkesa e Performancës) ¹	OSHEE ⁶¹	Viti 0 sapo të nënshkruhet marrëveshja e financimit me BERZH-in	Përgjegjësia t'i jetë caktuar një personi të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme. BERZH-it t'i jenë dhënë emri dhe kontakti i personit përgjegjës	
1.2	Të sigurohet që të gjitha lejet e dhëna nga autoritetet përkatëse për operacionet në vazhdim janë në funksion përpara fillimit të aktivitetit përkatës.	Zbatimi i kërkesave rregullatore	Legjislacioni Kombëtar	OSHEE	Sikurse kërkohet nga rregulloret kombëtare	Lejet dhe autorizimet të jenë marrë dhe mirëmbajtur.	

⁶¹ OSHEE i referohet OSHEE-së dhe 3 kompanive filiale – OSSH; FHSU dhe FTL, përveç nëse përcaktohet ndryshe

1.3	Të zhvillohet një sistem i integruar i menaxhimit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisor dhe Social (HS-ESMS) që mbulon veprimet ekzistuese dhe funksionimin e nën-stacionit të ri.	Menaxhimi i integruar i HS-ES	BERZH PR1 Legjislacioni Kombëtar	OSSH Konsulent i Jashtëm (Mbështetja TC e ofruar nga BERZH-i)	Mbështetja TC fillon kur menaxheri i H&S (Shëndetit & Sigurisë) është në funksion - caktimi 12 muaj	HS-ESMS të jetë në funksion në përputhje me standardet ISO (45001 dhe 14001)	
1.4	Të krijohet, mirëmbahet dhe forcohet një strukturë organizative që përcakton rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin për të monitoruar dhe për të siguruar zbatimin e HS-ESMS. Minimalisht kjo duhet të përfshijë: - një Menaxher të Shëndetit dhe Sigurisë në nivel të korporatës. Menaxheri i H&S do të jetë minimalisht i pajisur me certifikimin shqiptar për koordinatorët H&S, certifikimin NEBOSH dhe minimalisht 7 vjet përvojë mbi Shëndetin dhe Sigurinë në sektorin e energjisë në Shqipëri; - një specialist për Mjedisin, përgjegjës për çështjet mjedisore në operacionet ekzistuese dhe në monitorimin e kontraktuesve, përfshirë projektin e nënstationit. Specialisti do të ketë minimalisht 5 vjet përvojë në çështjet mjedisore, të paktën 2 prej tyre në sektorin e energjisë në Shqipëri.	Kapaciteti organizativ i H&S (Shëndeti & Siguria) dhe Mjedisit për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet	BERZH PR1 GIP	OSHH	Brenda 6 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes së Huas	Diagrami organizativ dhe rolet dhe përgjegjësitë të jenë përditësuar	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësi/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësi	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
1.5	Si pjesë e ESMS - të sigurohet që dokumentet e tenderit të kontraktuesit përfshijnë klauzola specifike, që kërkojnë zbatimin e HS-ESMS dhe PR2, siç është e përshtatshme për objektin e punëve të kontratës. Këto klauzola do të zbatohen për nënkontraktuesit e angazhuar nga cilido kontraktues në Projekt. - të hartohet një plan për monitorimin e performancës së kontraktuesit HS-ES.	Zbatimi i kërkesave të HS dhe E&S	BERZH PR1, PR2	OSSH	Sipas zhvillimit të HS-ESMS	Procedurat përkatëse të jenë zhvilluar si pjesë e HS-ESMS	
1.6	Të kryhet një vlerësim i rreziqeve të E&S brenda zinxhirit primar të furnizimit, përfshirë potencialin për punë të detyruar dhe punën e fëmijëve.	Rreziqet e E&S në zinxhirin e furnizimit	BERZH PR1 and PR2	OSSH	Sipas zhvillimit të HS-ESMS	Procedurat përkatëse të jenë zhvilluar si pjesë e HS-ESMS	
1.7	Të raportohet te BERZH-i mbi: - Statusin e zbatimit të ESAP dhe ESMP; - Performancën mjedisore dhe sociale të aktiviteteve të projektit.	Monitorimi	BERZH PR1	Pronari i OSHEE ESAP, bazuar në modelin e dhënë nga BERZH-i	Çdo 6 muaj gjatë përgatitjes së projektit Çdo tre muaj gjatë ndërtimit të nënstacionit Çdo vit pas ndërtimit, deri në fund të marrëveshjes së financimit	Raportet t'i jenë paraqitur BERZH-it dhe të jenë miratuar	
Veprimet specifike për Këstin 2							
1.8	Zhvillimi i një ESMP për ndërtimin e nënstacioneve gjatë kujdesit të mëtejshëm të duhur të E&S.	Zbatimi i kërkesave të HS dhe E&S	BERZH PR1 Legjislacioni Kombëtar	OSSH me Mbështetjen e Konsulentit (BERZH TC e financuar - Faza 1 Kujdesi i Duhur	Paralelisht me kujdesin e duhur	ESMP për nënstacionin të jetë në funksion	
1.9	Të merret miratimi i EIA-s (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) për nënstacionin ose miratimi paraprak i EIA-s dhe vendimi i EIA-s nuk kërkohet; lejet e tjera të lidhura me ESHS dhe të sigurohet pajtueshmëria me planin përkatës të zhvillimit hapësinor.	Pajtueshmëria me kërkesat rregullatore	BERZH PR1 Legjislacioni Kombëtar	OSSH	Sikurse kërkohet nga rregulloret kombëtare, dhe për miratimin e EIA-s përpara disbursimit të parë të Këstit 2	Miratimi i EIA-s ose ekuivalenti të jetë funksion; lejet të jenë në funksion dhe projekti të jetë në përputhje me planin e zhvillimit hapësinor	
1.10	Të sigurohet që dokumentet dhe kontratat e tenderit të kontraktorit EPC të nënstacionit përfshijnë klauzola specifike në lidhje me çështjet HS dhe E&S përfshirë pajtueshmërinë me legjislacionin kombëtar, kërkesat e BERZH, ESMP dhe çdo kërkesë përkatëse në këtë ESAP.	Zbatimi i kërkesave të HS dhe E&S	BERZH PR1 Legjislacioni Kombëtar	OSSH	Përpara tenderit të nënstacionit dhe dhënies së kontratës	Të jetë i përfshirë në dokumentacionin e tenderit dhe kontratës	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësia/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
1.11	Kontraktuesi EPC i nënstacionit të hartojë dhe të zbatojë një Plan Menaxhimi Mjedisor dhe Social për Mjedisin (CESMP), për të menaxhuar dhe për të zbutur ndikimet dhe rreziqet e E&S të Projektit. C-ESMP do të përfshijë masat e identifikuara në dokumentacionin kombëtar të lejimit (p.sh. EIA), rezultatet e studimeve të hollësishme të disenjimit dhe çdo masë shtesë pas zbatimit të Operacioneve të ESAP. C-ESMP do të miratohet nga OSHH-ja dhe do të zbatohet para se të fillojë puna.	Zbatimi i kërkesave të HS dhe E&S	BERZH PR1 Legjislacioni Kombëtar	Kontraktori me kërkesë të OSHH	Gjatë projektimit të hollësishëm dhe para fillimit të ndërtimit	C-ESMP të jetë përgatitur nga kontraktori EPC dhe aprovuar nga OSHH. C-ESMP të jetë zbatuar nga kontraktori EPC.	
PR2	Puna dhe Kushtet e Punës						
2.1	Të përditësohet mekanizmi ekzistues i ankesave për të siguruar, që ofron një mekanizëm konfidencial për bërjen e raporteve anonime të incidenteve të ngacmimeve seksuale në vendin e punës. Të sigurohet që sistemi është i arritshëm për kontraktuesit dhe punonjësit e palëve të treta, ose t'u kërkoet kontraktuesve të kenë sisteme ekuivalente.	Menaxhimi i përmirësuar i ankesave duke përfshirë kontraktuesit	BERZH PR2 Legjislacioni Kombëtar	OSHEE	Brenda 6 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit	Mekanizmi i ankesave të përditësohet Materialet që reklamojnë mekanizmin të jenë shfaqur, si për punonjësit, ashtu edhe për fuqinë punëtore kontraktuese	
2.2	Të sigurohet që kodi i sjelljes të përfshijë ndalimin specifik të dhunës dhe ngacmimit bazuar në gjini dhe është, gjithashtu, i zbatueshëm për kontraktuesit që punojnë për OSHEE-në. Të sigurohen trajnime induktive mbi kodin e sjelljes për të gjithë punonjësit dhe kontraktuesit. Të kërkoet që të gjithë punonjësit dhe kontraktuesit të nënshkruajnë kodin e sjelljes.	Politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore në përputhje me PR2	BERZH PR2 Legjislacioni Kombëtar	OSHEE	Brenda 6 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit	Kodi i sjelljes të jetë përditësuar	
2.3	Të kryhen auditime tremujore të stafit të kontraktuesve dhe nënkontraktuesve për të verifikuar që punonjësit që punojnë për Projektin janë punësuar ligjërisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe në përputhje me PR2.	Marrëdhënie dhe menaxhim i përmirësuar punonjës/kontraktor; informim i hershëm i çështjeve të fuqisë punëtore	BERZH PR2 Legjislacioni Kombëtar	OSHH	Brenda 6 dhe 9 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes së financimit	Programi i auditimit të jetë përgatitur dhe auditimet e para tremujore të jenë ndërmarrë	
2.4	Të prezantohet një program trajnimi ri, i përsëritshëm dhe i akredituar kombëtar, për mësim të dyfishtë për të pajisur të paktën 250 të rinj (me përfshirjen e të paktën 50% pjesëmarrësve femra) me nivele më të larta aftësie në partneritet me një koleg teknik lokal.	Zhvillimi i aftësive	Praktika e Mirë Ndërkombëtare BERZH Strategjia e Përfshirjes Ekonomike	OSHEE Konsulent i jashtëm për disenjimin (Mbështetja e TC-së ofruar nga BERZH-i)	Brenda 2 viteve nga nënshkrimi i marrëveshjes së Huas Brenda 4 viteve nga nënshkrimi i marrëveshjes së Huas	Partneriteti me një koleg teknik lokal të jetë krijuar. Oferta për trajnim për programin (e) e përshtatur të mësimi të dyfishtë të jetë zhvilluar dhe zbatuar. Si rezultat 250 të rinj marrin aftësi të akredituara, përfshirë 125 femra	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësi/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësi	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
PR3	Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Kontrolli i Ndotjes						
3.1	Të kryhet një rishikim i substancave dhe i materialeve të rrezikshme të përdorura gjatë operacioneve ekzistuese, përfshirë PCB-të në transformatorë dhe të përcaktohet nëse substancat dhe materialet alternative, më pak të rrezikshme, mund të përvetësohen. Kur nuk ka alternativa, të kryhet një vlerësim i rrezikut dhe zbatohen masat e nevojshme të menaxhimit dhe zbutjes, duke përfshirë procedurat e asgjësimit të mbetjeve.		BERZH PR3 EU Standardet thelbësore mjedisore Legjislacioni kombëtar	OSHH	Brenda 12 muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes së Huas		
Veprimet specifike për Këstin 2							
3.2	Të kryhet një studim i zëvendësimit të SF6. Të projektohet nënstationi për të operuar me një alternativë ndaj SF6 me Potencial më të ulët të Ngrohjes Globale.	Shmangia e ndikimeve në mjedis përmes projektimit	BERZH PR3 EU Standardet thelbësore mjedisore	OSHH me mbështetje të Konsulentëve (financuar nga TC BERZH - Faza 1 Zell i duhet) Konsulent i Projektimit/ Kontraktorë EPC, me kërkesën e OSHH-së	Paralelisht me kujdesin e duhur Gjatë projektimit të nën- stationit dhe para ekspertizës shtetërore dhe miratimit të projektit përfundimtar	Nënstationi falas SF6	
3.3	Të kryhet një vlerësim i ndikimit të zhurmës gjatë projektimit të detajuar, për të përcaktuar emetimet e zhurmës dhe masat e kërkuara zbutëse për të qenë në përputhje me legjislacionin kombëtar, standardet e OBSH-së dhe udhëzimet e IFC EHS (cilado që është më rigoroze) për zhurmën në punë dhe mjedisin.		BERZH PR3 EU Standardet thelbësore mjedisore Legjislacioni kombëtar	Konsulent i Projektimit/ Kontraktorë EPC, me kërkesën e OSHH-së	Gjatë projektimit të nën- stationit dhe para ekspertizës shtetërore dhe miratimit të projektit përfundimtar		



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësia/përfitimet)	Kërkesa (legjislativë, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
PR4	Health and Safety						
4.1	Zhvillimi dhe zbatimi i një Sistemi formal të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë (HSMS), i cili administron të gjitha rreziqet e parashikueshme të shëndetit në punë dhe komunitet, plotëson praktikën e mira ndërkombëtare dhe përputhet me ISO 45001. Sistemi do të përqendrohet posaçërisht në sa vijon: caktimi i një Politike H&S; vendosja e përgjegjësiave brenda organizatës; trajnimi, konsultimi dhe informimi i fuqisë punëtore; sigurimi i një ambienti të sigurt pune, proceseve të punës dhe pajisjeve; dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit.		BERZH PR4 GIP	OSHH Konsulent (Mbështetja TC ofruar nga BERZH-)	Brenda 12 muajve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit Nënstacioni i përfshirë në MS deri në fund të vitit të parë të operimit	HS-ESMS në funksion të jetë në përputhje me standardet ISO (45001 dhe 14001)	
4.2	Të zhvillohet dhe të zbatohet një plan i menaxhimit të rrezikut të sigurisë që identifikon të gjitha kërcënimet e sigurisë ndaj ndërmarrjeve të kompanisë, si dhe rreziqet e parashikueshme për punëtorët dhe komunitetet e prekura nga projekti, duke përfshirë personelin e sigurisë dhe zbutjet përkatëse.	Zbutja e rreziqeve të sigurisë dhe të rreziqeve që lidhen me personelin e sigurisë	BERZH PR4 Legjislacioni Kombëtar	OSHH	Brenda 12 muajve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit	Plani i administrimit të rrezikut të sigurisë të jetë në funksion	
Veprimet specifike për Këstin 2							
4.3	Të zhvillohet një bazë sigurie dhe mjedisore të projektimit (BoD): i. duke përcaktuar kërkesat minimale për shmangien dhe nëse jo zbutjen praktike të ndikimeve të personeli dhe komunitetet lokale; ii. duke siguruar që nën-stacioni të projektohet në përputhje me kërkesat kombëtare, BERZH ESP dhe praktikën e mirë ndërkombëtare, përfshirë sigurinë nga zjarri (p.sh. NFPA 850); hyrja dhe dalja normale dhe e emergjencës; rreziqet natyrore, siç janë tërmetet dhe përmbajtjet; përmbajtja e materialit të rrezikshëm (p.sh. vaji i transformatorit); Fushat elektromagnetike (si për punëtorët ashtu edhe për publikun) etj. Gjatë hartimit të detajuar të zbatohet BoD dhe të kryhet një vlerësim i rrezikut të shëndetit dhe sigurisë dhe mjedisit dhe të zhvillohen masa zbutëse në përputhje me hierarkinë e zbutjes për projektin dhe funksionimin e nën-stacionit.	Zbatimi i hierarkisë së zbutjes	BERZH PR4 Legjislacioni Kombëtar	OSHH me Mbështetjen e Konsulentëve (financuar nga BERZH TC - Faza 1 Kujdesi i Duhur) Kontraktori i EPC, me kërkesë të OSHH-së	Gjatë hartimit paraprak/fizibilitetit Gjatë projektimit të nën-stacionit dhe para ekspertizës shtetërore dhe miratimit të projektit përfundimtar	BoD të jenë zhvilluar Projekti të jetë në përputhje Vlerësimi i rrezikut dhe zbutjet të jenë përfshirë në projektimin ose veprimet HSMP	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësi/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësi	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
4.4	Kontraktorit të EPC t'i kërkohet të caktojë një menaxher të HSE (Shëndeti, Siguria dhe Mjedisë) i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e C-ESMP.	Kapaciteti i E&S i kontraktorit	BERZH PR4	Kontraktuesit, me kërkesën e OSHH-së	Në funksion përpara mobilizimit dhe për kohëzgjatjen e periudhës së ndërtimit	Kërkesa të jetë e përfshirë në dokumentacionin e tenderit Menaxheri i HSE të jetë mobilizuar nga kontraktori.	
4.5	Plani i Menaxhimit të HS (ndërtimi) Kontraktori EPC duhet të përgatisë dhe zbatojë një Plan Menaxhimi të Shëndetit dhe Sigurisë, që plotëson legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e PR2 dhe PR4 për periudhën e ndërtimit (përfshirë në kontraktuesin EPC C-ESMP). Plani do të përgatitet nga kontraktori i EPC përpara se të fillojnë punimet dhe do t'i nënshtrohet miratimit të OSHH.	Zbatimi i kërkesave të H&S	BERZH PR4 Legjislacioni Kombëtar	Kontraktuesit, me kërkesën e OSHH-së	Gjatë projektimit të hollësishëm dhe përpara fillimit të ndërtimit	Plani i Menaxhimit të OHS të jetë përgatitur nga kontraktori EPC dhe aprovuar nga OSHEE-ja. Plani i Menaxhimit të OHS-së të jetë zbatuar nga kontraktori EPC.	
4.6	Plani i Menaxhimit të HS (funksionimi) Kontraktori i EPC duhet të përgatisë dhe OSHEE duhet të zbatojë një plan të Shëndetit dhe Sigurisë që plotëson legjislacionin shqiptar dhe kërkesat PR2 dhe 4 për periudhën e funksionimit të nënstacionit. Plani do të përgatitet nga kontraktori EPC përpara fillimit të operacionit dhe do t'i nënshtrohet miratimit të OSHEE-së. Ky plan do të përfshijë një plan të reagimit ndaj emergjencave në rast zjarri ose emergjence tjetër në nënstacion.	Zbatimi i kërkesave të H&S	BERZH PR4 Legjislacioni Kombëtar	Kontraktori, me kërkesën e OSHH-së	Para fillimit të operacionit Zbatohet gjatë operimit të nënstacionit	Plani i Menaxhimit të OHS të jetë përgatitur nga kontraktori EPC dhe aprovuar nga OSHEE. Plani i Menaxhimit të OHS të jetë zbatuar nga OSHH gjatë operimit	
4.7	Të përfshihen ndikimet dhe lehtësimet e komunitetit mbi Shëndetin dhe Sigurinë në nënstacionin në planet e Menaxhimit të HS (ndërtimi dhe operimi), në konsultim me komunitetin lokal, përdoruesit e zonës lokale dhe autoritetet lokale. Plani duhet të identifikojë rreziqet e mundshme dhe të përfshijë politikën, procedurat dhe kontrollet për të zbutur këto, si dhe masat për monitorimin dhe raportimin dhe duhet të përditësohet duke ndjekur rezultatet e studimeve të projektimit të shënuara në këtë PVPS.	Zbutja e ndikimeve të komunitetit mbi H&S	BERZH PR4	Kontraktori, me kërkesën e OSHH-së	Përpara fillimit të ndërtimit dhe të funksionimit	H&S e komunitetit të përfshihet në fazën e ndërtimit dhe të funksionimit Planet e Menaxhimit të OHS-së.	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësia/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
4.8	Të kryhet një rishikim i pavarur i modelit për të siguruar që ai është në përputhje me kërkesat kombëtare, BERZH ESP dhe praktikat e mira ndërkombëtare.	Siguri mbi modelin për të përmbushur standardet e duhura HS dhe E&S	BERZH Legjislacioni Kombëtar PR4	OSHH Mbështetja e Konsulentëve (financuar nga BERZH TC - Faza 2 Mbështetja për Zbatimin)	Gjatë projektimit të nën-stacionit dhe përpara ekspertizës shtetërore dhe miratimit të projektit përfundimtar	Rishikimi i pavarur të jetë kryer dhe rezultatet të jenë zbatuar	
PR5	Blerja e tokës, risistemimi i pavullnetshëm dhe zhvendosja ekonomike						
Veprimet specifike për Këstin 2							
5.1	Të rishikohet blerja e tokës dhe çdo veprimtari e mëparshme e risistemimit (përfshirë përdoruesit informale), të shoqëruara me vendndodhjen e nën-stacionit. Të zhvillohet një plan veprimi për të mbyllur çdo boshllëk me PR5. Të zbatohet plani i veprimit	Të shmangët ose minimizohet zhvendosja fizike dhe ekonomike	BERZH Legjislacioni Kombëtar PR5	OSHH me Mbështetjen e Konsulentëve (financuar nga BERZH TC - Faza 1 Kujdesi i duhur) OSHH	Paralelisht me kujdesin e duhur Para fillimit të aktiviteteve të ndërtimit në tokë		
PR8	Trashëgimia Kulturore						
Veprimet specifike për Këstin 2							
8.1	Të sigurohet që kontraktori i nënstationit të zhvillojë një Procedurë të Gjetjeve të Shanseve që mbulon, së paku: kuadrin ligjor për trashëgiminë kulturore; procesin që duhet ndjekur në rast të gjetjeve të rastësishë; rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e procedurës dhe një induksion për të gjithë punëtorët, përfshirë stafin e projektit, kontraktuesit dhe agjencitë qeveritare.	Vlerësimi dhe menaxhimi i ndikimeve dhe rreziqeve në trashëgiminë kulturore	BERZH PR8 Legjislacioni Kombëtar	Kontraktuesit, me kërkesën e OSHH	Procedura në funksion përpara ndërtimit dhe zbatohet gjatë ndërtimit	Kërkesa të jetë e përfshirë në tenderin dhe kontratën EPC Procedura të jetë në funksion	
PR10	Zbulimi i Informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesit						



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësi/përfitimet)	Kërkesa (legjislativë, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësi	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
10.1	Të zhvillohet dhe të zbatohet një Plan i Angazhimit të Palëve të Interesit për veprimet ekzistuese dhe një aneks specifik për projektin e nënstacionit që minimalisht mbulon: identifikimin e aktorëve kryesorë, përfshirë gratë dhe njerëzit në nevojë; shqetësimet dhe interesat e tyre në projekt; metodat e synuara të angazhimit me këta aktorë gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit; rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e planit; mbikëqyrjen e kontraktuesit; dhe rregullimet e monitorimit dhe raportimit. Të mirëmbahet SEP gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit, duke përditësuar çdo vit dhe paraprakisht pikat kyçe të projektit. Të mirëmbahet procedura ekzistuese e ankesave për veprimet në vazhdim.	Plani i angazhimit të palëve të interesit të korporatave	BERZH PR10	OSHEE - me Mbështetjen e Konsulentit (financuar nga BERZH TC - Faza 1 Zell i duhet)	Paralelisht me kujdesin e duhur	SEP të jetë zhvilluar dhe zbatuar	
10.2	Të analizohen shkaqet e fataliteteve të palëve të treta dhe të përgatiten programe të ndërgjegjësimi për sigurinë e klientëve dhe të komunitetit (në baza të rregullta) dhe të shpërndahen përmes qendrave të shërbimit ndaj klientëve, faqeve të internetit dhe kanaleve të tjera të mediave sociale.	Angazhimi me klientët dhe komunitetet lokale për çështjet e sigurisë	BERZH PR10	OSHH	Paralelisht me kujdesin e duhur	Raporti të bëhet i ditur për publikun	
10.3	Të sigurohet publikisht një raport vjetor i performancës së E&S në faqen e internetit të OSHEE-së.	Të ofrohet informacioni	BERZH PR10	OSHEE	Raporti i parë brenda 12 muajve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Financimit		
Veprimet specifike për Këstin 2							
10.4	Të zhvillohet dhe zbatohet një mekanizëm i përshtatshëm për ankesat e komunitetit për ndërtimin e nënstacionit. Ekzistenca dhe funksionimi i mekanizmit të ankesave duhet t'u komunikohet njerëzve të prekur, me anë të një larmie kanalesh, dhe të përforcohet gjatë aktivitetëve të angazhimit të palëve të interesit.	Angazhimi me komunitetin dhe palët e tjera të interesit	BERZH PR10 Legjislacioni Kombëtar	Kontraktor me kërkesë të OSHH	Mekanizmi në funksion përpara ndërtimit	Mekanizmi i Ankesave të jetë në funksion dhe të jepet informacion në nivel lokal	



Nr.	Veprimi	Rreziqet Mjedisore dhe Sociale (përgjegjësia/përfitimet)	Kërkesa (legjislative, BERZH KP (Kërkesa e Performancës) Praktika më e Mirë)	Burimet, Nevojat për Investime, Përgjegjësia	Plani kohor	Kriteret e Objektivit dhe të Vlerësimit për Zbatimin e Suksesshëm	Statusi
10.5	Të zhvillohet dhe tregohet një përmbledhje joteknike (NTS) të projektit të nënstacionit në faqen e internetit të OSHEE-së dhe në nivel lokal. Të zhvillohet një takim publik me aktorët e interesit (në internet, nëse u nënshtrohen kufizimeve të COVID-it) gjatë fazës së fizibilitetit dhe para projektimit të hollësishëm për të siguruar që reagimet e palëve të interesit të përfshihen në modelin e detajuar.	Angazhimi me komunitetin dhe palët e tjera të interesit	BERZH PR10 Udhëzues i BERZH-it mbi mekanizmat e ankesave. Legjislacioni Kombëtar	OSHH me Mbështetjen e Konsulentëve (financuar nga BERZH TC - Faza 1 Kujdesi i Duhur)	Paralelisht me kujdesin e duhur	NTS të jepet si informacion. Të zhvillohet takim publik.	



SKEDULI 4 – FORMA E SIPËRMARRJES SË INTEGRITETIT

[vendosni datën]

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
Bulevardi “Gjergj Fishta”, nr. 88, h. 1, 1023,
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Znj. Ilda Malile
Faks³: +355 4 4500996

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Në vëmendje të: Departamenti i Administrimit
të Operimeve
Email: oad@ebrd.com

Në vijim e referuar si “**Banka**”

Lënda: Veprimi nr. 523

**Lënda: Marrëveshja e Huas e datës
[_____] ndërmjet Operatorit të
Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. dhe
Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
("Marrëveshja e Huas").**

Zotëri:

Përveç nëse përcaktohet ndryshe këtu, termat e
përcaktuar do të kenë kuptimin që u është dhënë
atyre në Marrëveshjen e Huas.

Në përputhje me dispozitat e seksionit [3.02 (g)]
të Marrëveshjes së Huas, ne, të nënshkruarit [*Emri i
Kontraktuesit Material*], përfaqësojmë dhe
garantojmë, dhe ndërmarrim, si kusht për marrjen e
fondeve të Huas, sa vijon:

a) as [*Emri i Kontraktuesit Material*] dhe as ndonjë
zyrtar, drejtor, punonjës i autorizuar,
bashkëpunëtor, agjent ose përfaqësues i [*Emri i
Kontraktuesit Material*] nuk ka kryer ose është
angazhuar në ndonjë Praktikë të Ndaluara, në lidhje
me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar
nga Marrëveshja e Huas;

b) [*Emri i Kontraktuesit Material*] nuk do të dhe
nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga zyrtarët,
drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët,
agjentët ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në
ndonjë Praktikë të Ndaluara, në lidhje me Projektin
ose ndonjë transaksion të parashikuar nga
Marrëveshja e Huas. Pavarësisht nga ndonjë
dispozitë tjetër e Marrëveshjes së Huas, [*Emri i
Kontraktuesit Material*] pranon që Banka mund të
kërkojë Politikën e Zbatimit dhe Procedurat⁴, në
lidhje me pretendimet e Praktikave të Ndaluara
(përfshirë në lidhje me seksionin 3.01(f) të
Marrëveshjes së Huas, si e zbatueshme, *mutatis
mutandis*, për [*Emri i Kontraktuesit Material*], në lidhje
me Projektin dhe transaksionet e parashikuara nga
Marrëveshja e Huas;

c) [*Emri i Kontraktuesit Material*] do të njoftojë
menjëherë Bankën nëse [*Emri i Kontraktuesit
Material*] merr ndonjë informacion, në lidhje me
shkeljen e seksionit 3.01(f) ose seksionit 3.02(k) të
Marrëveshjes së Huas, siç zbatohet, *mutatis mutandis*,
për [*Emri i Kontraktuesit Material*] ose nëse ndonjë
institucion financiar ndërkombëtar ka vendosur
ndonjë sanksion mbi [*Emri i Kontraktuesit Material*]
për ndonjë Praktikë të Ndaluara. [*Emri i Kontraktuesit
Material*] do të bashkëpunojë në mirëbesim me
Bankën dhe përfaqësuesit e saj për të vlerësuar nëse
ka ndodhur një shkelje e tillë dhe do t'i përgjigjet
menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo kërkesë
nga Banka, në lidhje me ndonjë shkelje të tillë të
pretenduar dhe do të sigurojë mbështetje
dokumentare për një përgjigje të tillë me kërkesën e
Bankës; dhe

d) [*Emri i Kontraktuesit Material*] do t'i paraqesë
Bankës menjëherë informacione të tjera që Banka
herë pas here mund të kërkojë me arsye dhe do të
lejojë përfaqësuesit e Bankës (përfshirë, çdo
këshilltar të angazhuar nga Banka) të vizitojnë
Projektin ose ndonjë nga ambientet e tjera ku
kryhet biznesi i [*Emri i Kontraktuesit Material*] ose ku
po kryhet Projekti dhe të ketë akses në asetet, librat,
llogaritë dhe regjistrat e [*Emri i Kontraktuesit
Material*] (përfshirë, me qëllim: i. për të lehtësuar
monitorimin dhe vlerësimin e Projektit nga Banka
dhe për t'i dhënë mundësi Bankës të shqyrtojë dhe

⁴ BERZH, Politika dhe Procedurat e Zbatimit të
Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
("BERZH"), e datës 4 tetor 2017 disponohet në adresën:
<https://www.ebrd.com/neës/publications/policies/enforcement-policy-and-procedures.html>

² Për konfirmim nga Huamarrësi.

³ Për konfirmim nga Huamarrësi.



adresoje çdo ankesë, në lidhje me Projektin e bërë bazuar në Mekanizmin e Ankesave të Projektit; dhe ii. për të vlerësuar nëse ka ndodhur një Praktikë e Ndaluar, në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara këtu).

Me respekt,

Për dhe në emër të [Emri i Kontraktuesit Material]

Nga: _____

Emri:

Funksioni:

Për njohje dhe konfirmim:

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Nga: _____

Emri:

Funksioni:

SKEDULI 5 – LLOGARIA E VEÇANTË

1. Për qëllimet e këtij skeduli, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

“Kategori e Kualifikuar” nënkupton Kategoritë [_____] dhe [_____].

“Shpenzime të Kualifikueshme” nënkupton shpenzimet, në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin, të cilat do të financohen nga të ardhurat e Huas dhe të cilat shpërndahen herë pas here në një Kategori të Kualifikuar, në përputhje me dispozitat e shtojcës 2.

“Bilanci Maksimal i Llogarisë së veçantë” nënkupton një shumë të barabartë me [_____].

“Shuma minimale e Tërheqjes së Fondit” nënkupton një shumë të barabartë me [_____] të Llogarisë së Veçantë.

2. Pagesat nga Llogaria e Veçantë do të bëhen ekskluzivisht për Shpenzimet e Kualifikueshme, në përputhje me dispozitat e këtij skeduli.

3. Pasi Banka të ketë marrë dëshmi të pranueshme se Llogaria e Veçantë është hapur siç duhet, në përputhje me termat dhe kushtet e pranueshëm për Bankën, Huamarrësi mund të tërheqë nga Shuma e Disponueshme dhe të depozitojë në Llogarinë e Veçantë një shumë fillestare që nuk do tejkalojë Bilancin Maksimal të

Llogarisë së Veçantë dhe nuk duhet të jetë më e vogël se Shuma Minimale e Tërheqjes së Fondit të Llogarisë së Veçantë.

4. Më pas, Huamarrësi mund të tërheqë shuma shtesë nga Shuma e Disponueshme dhe t'i depozitojë këto shuma në Llogarinë e Veçantë, në bazë të kufizimeve të specifikuara në paragrafin 6, si më poshtë dhe përmbushjes së kushteve të mëposhtme për secilën Tërheqje Fondi të kërkuar:

a) Huamarrësi ka dorëzuar në llogarinë bankare deklarata dhe dokumente, dhe çdo provë tjetër të kërkuar nga Banka, për të treguar se shumata e disbursuara nga Llogaria e Veçantë janë aplikuar, shqyrtuar dhe konfirmuar për qëllime të tilla nga auditori referuar në seksionin 4.01(b), në një raport të dedikuar të përgatitur nga auditori për qëllimin e Tërheqjes së Fondit.

b) Pas hyrjes në fuqi të Tërheqjes së Fondit të kërkuar dhe depozitimit të shumës së kësaj Tërheqjeje Fondi në Llogarinë e Veçantë, gjendja e Llogarisë së Veçantë nuk duhet të kalojë Bilancin Maksimal të Llogarisë së Veçantë.

c) Me përjashtim të rastit kur Banka mund të bie dakord herë pas here, shuma e Tërheqjes së Fondit të kërkuar për depozitim në Llogarinë e Veçantë nuk do të jetë më e vogël se shuma minimale e Tërheqjes së Fondit të Llogarisë së Veçantë.

5. Pa cenuar kërkesën e paragrafit 4(a) më sipër, Huamarrësi do të paraqesë, në çdo kohë që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, një raport mbi gjendjen dhe detaje të tjera të Llogarisë së Veçantë, duke përfshirë deklaratat e llogarisë dhe dokumente dhe dëshmi të tjera që Banka mund të kërkojë për të treguar se pagesat e kryera nga Llogaria e Veçantë janë kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë Program - një raport i tillë i përgatitur nga auditori referuar në seksionin 4.01(b).

6. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 4 të këtij skeduli, Huamarrësi nuk do të tërheqë fonde nga Shuma e Disponueshme për depozitim në Llogarinë e Veçantë, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe:

a) nëse, në çdo kohë, Banka ka përcaktuar që të gjitha Tërheqjet e mëtejshme të Fondit duhet të bëhen në përputhje me dispozitat e seksionit 2.03(a); ose

b) kur shuma e disponueshme e alokuar për kategoritë e pranueshme është e barabartë me



dyfishin e shumës së bilancit maksimal të Llogarisë së Veçantë.

Pas kësaj, Tërheqjet e Fondit të alokuara për kategoritë e pranueshme do të ndjekin procedurat e tilla, që Banka mund të specifikojë duke njoftuar Huamarrësin. Tërheqjet e tilla të mëtejshme të Fondit do të bëhen vetëm pasi dhe në masën që Banka është bindur që të gjitha shumat e mbetura në depozitë në Llogarinë e Veçantë, që nga data e njoftimit të tillë do të përdoren në kryerjen e pagesave për Shpenzimet e Kualifikueshme.

7. Nëse Banka përcakton në çdo kohë që çdo pagesë nga, ose çdo përdorim i Llogarisë së Veçantë:

a) është bërë për një shpenzim ose në një shumë që nuk është e pranueshme, në përputhje me paragrafin 2 të kësaj shtojce; ose

b) nuk ishte justifikuar nga provat e paraqitura në Bankë,

atëherë Banka mund të kërkojë nga Huamarrësi që:

1. Të sigurojë prova shtesë, të tilla siç mund të kërkojë Banka; dhe/ose

2. Të depozitojë në Llogarinë e Veçantë (ose, nëse Banka e kërkon, të ripaguajë Bankën) një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë ose pjesën e saj jo aq të pranueshme ose të justifikuar.

Në rast se Banka bën një përcaktim të tillë, sipas pikës “a” ose “b” më sipër, nuk do të bëhet asnjë Tërheqje tjetër e Fondit, përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, për t’u depozituar në Llogarinë e Veçantë deri në kohën kur Huamarrësi ose: A. ka depozituar në Llogarinë e Veçantë ose i ka ripaguar Bankës një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë (ose një pjesë të saj) e përcaktuar të mos jetë e pranueshme ose e justifikuar; ose B. ka siguruar prova shtesë të pranueshme për Bankën se shumat e disbursuara më parë nga Llogaria e Veçantë janë aplikuar si duhet.

8. Nëse:

a) Banka përcakton në çdo kohë që çdo shumë e papaguar në Llogarinë e Veçantë nuk do të kërkohej për të mbuluar pagesa të mëtejshme për Shpenzimet e Kualifikueshme; ose

b) Banka udhëzon Huamarrësin që t’i kthejë Bankës një shumë në përputhje me paragrafin 7(2), atëherë Huamarrësi, menjëherë pas njoftimit nga Banka, do t’i parapaguajë Bankës një pjesë të Huas të barabartë me atë shumë. Për këtë qëllim,

do të hiqet dorë nga kërkesa që parapagimet e Huas duhet të ndodhin në datat e pagesës së interesit, në varësi të paragrafit 10 më poshtë.

9. Huamarrësi mund, me njoftimin paraprak për Bankën, të dhënë në përputhje me seksionin 3.07(a) të Termave dhe Kushteve Standardë, të parapaguajë në çdo Datë të Pagesës së Interesit të gjitha ose ndonjë pjesë të fondeve të depozituara në Llogarinë e Veçantë.

10. Çdo parapagim në përputhje me paragrafët 8 ose 9 më sipër do të bëhet në përputhje me seksionin 3.07 të Termave dhe Kushteve Standardë; megjithatë, me kusht që: a) pavarësisht nga seksioni 3.07(c)(i)(A) i Termave dhe i Kushteve Standardë, ky parapagim nuk do të jetë sipas Shumës Minimale të Parapagimit; dhe b) çdo parapagim që është bërë në një datë tjetër, përveç një date të pagesës së interesit do t’i nënshtrohet pagimit të kostove të marrëveshjes së mëparshme, në përputhje me seksionin 3.10 të Termave dhe Kushteve standardë. Çdo parapagim, në përputhje me paragrafët 8 ose 9 më sipër do të zbatohet nga Banka, në përputhje me seksionin 3.07(c)(ii) të Termave dhe Kushteve Standardë.

DEKRET

Nr. 13314, datë 9.11.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 104/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për marrëveshjen e huas ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE) dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e OSHEE-së për reagimin ndaj krizës së pandemisë COVID-19”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

**LIGJ**
Nr. 106/2021

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 30, DATË
27.9.2021, “PËR MIRATIMIN E DISA
NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA
NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN
DHE FURNIZIMIN NGA DHE
NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,
MINISTRIT TË SHTETIT PËR
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË
SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME
AKTIN NORMATIV NR. 3,
DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 30, datë 27.9.2021, “Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”.

Miratuar më datë 4.11.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 13318, datë 10.11.2021,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta.**

DEKRET
Nr. 13318, datë 10.11.2021**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 106/2021, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 30, datë 27.9.2021 Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 108/2021

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
SHTETIT TË IZRAELIT, PËR
SHMANGIEN E TAKSIMIT TË
DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E
EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME
TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të



dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datë 4.11.2021.

Shpallur me dekreten nr. 13320, datë 10.11.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**KONVENTË NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT
PËR SHMANGIEN E TAKSIMIT TË DYFISHTË
DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL
NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit;

Me qëllim realizimin e një Konvente për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimin mbi të ardhurat, pa krijuar mundësitë për mos-tatim ose tatim të reduktuar nëpërmjet evazionit ose shmangies tatimore (duke përfshirë nëpërmjet marrëveshjeve mbi zbatimin e traktateve të favorshme, të cilat synojnë të përfitojnë lehtësirat e ofruara në këtë Konventë për përfitim të tërthortë të banorëve të Shteteve të treta);

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Kapitulli I

OBJEKTI I KONVENTËS

NENI 1

Personat e Përfshirë

1. Kjo Konventë zbatohet për personat që janë rezidentë në njërin ose në të dyja Shtetet Kontraktuese.
2. Për qëllimet e kësaj Konvente, të ardhurat e gjeneruara nga ose nëpërmjet një subjekti ose marrëveshjeje, e cila trajtohet si plotësisht apo pjesërisht transparente nga pikëpamja tatimore sipas ligjit për tatimet të secilit Shtet Kontraktues, konsiderohen si të ardhurat e një rezidenti të një Shteti Kontraktues, por vetëm deri në masën që këto të ardhura trajtohen për qëllimet e tatimit nga ai Shtet, si të ardhura të një rezidenti të atij Shteti. Në asnjë rast, dispozitat e këtij paragrafi nuk interpretohen se cenojnë të drejtat e një Shteti Kontraktues për të tatuar rezidentët e atij Shteti Kontraktues.
3. Dispozitat e kësaj Konvente të cilat kërkojnë që një Shtet Kontraktues të përjashtojë nga tatimi mbi të ardhurat ose të kryejë një zbritje apo kreditim të barabartë me tatimin e paguar mbi të ardhurat, në lidhje me të ardhurat e gjeneruara nga një rezident i atij Shteti Kontraktues, të cilat mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues sipas dispozitave të kësaj Konvente, nuk zbatohen deri në masën që këto dispozita e lejojnë tatimin nga ai Shtet tjetër Kontraktues vetëm sepse të ardhurat janë gjithashtu të ardhura të cilat realizohen nga një rezident i atij Shteti tjetër Kontraktues.



NENI 2

Tatimet e Përfshira

1. Kjo Konventë zbatohet për tatimin mbi të ardhurat të vendosur në emër të një Shteti Kontraktues ose të nënndarjeve të tij politike apo autoriteteve vendore, pavarësisht mënyrës sesi janë vendosur.

2. Tatime mbi të ardhurat konsiderohen të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat totale ose mbi elementet e të ardhurave, duke përfshirë tatimin mbi fitimin nga tjetërsimi i pronës së luajtshme apo të paluajtshme, tatimet mbi shumat totale të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet, si dhe tatimi mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat do të zbatohet Konventa janë në veçanti:

a) në Izrael:

- i) tatimi mbi të ardhurat dhe tatimi mbi shoqëritë (përfshirë tatimin mbi fitimin kapital);
- ii) tatimi i vendosur mbi fitimet nga tjetërsimi i pronës sipas Ligjit për Tatimin e Pasurive të Paluajtshme;

(në vijim i referuar si “tatimi i Izraelit”);

b) në Shqipëri:

- i) tatimet mbi të ardhurat, përfshirë tatimin mbi fitimin e shoqërive, tatimin mbi të ardhurat personale dhe tatimin mbi fitimet e kapitalit nga tjetërsimi i pronës së luajtshme ose të paluajtshme.
- ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

(në vijim i referuar si “tatimi i Shqipërisë”)

4. Konventa zbatohet edhe për të gjitha tatimet e njëjta apo kryesisht të ngjashme që zbatohen pas datës së nënshkrimit të Konventës, në vazhdim ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën për të gjitha ndryshimet e rëndësishme në legjislacionin e tyre tatimor.

Kapitulli II

PËRKUFIZIMET

NENI 3

Përkufizimet e Përgjithshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe:

- a) termi “Izrael” do të thotë Shteti i Izraelit dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, përfshin territorin në të cilin Qeveria e Shtetit të Izraelit ka të drejta tatimore, përfshirë territorin detar, si edhe ato zona detare në afërsi të kufirit të jashtëm të territorit detar, duke përfshirë shtratin e detit dhe



tabanin e tij, mbi të cilin Shteti i Izraelit, në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe me ligjet e Shtetit të Izraelit, ushtron sovranitetin e tij ose të drejtat e tjera dhe juridiksionin.

- b) termi "Shqipëri" do të thotë Republika e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik përfshin territorin e Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë në të cilat, sipas ligjeve të saj dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin dhe tabanin e detit dhe me burimet e tyre natyrore;
- c) termat "Shtet Kontraktues" dhe "Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë Izraelin ose Shqipërinë, siç e kërkon konteksti;
- d) termi "person" përfshin një individ, shoqëri dhe çdo organe tjetër personash;
- e) termi "shoqëri" nënkupton çdo organ shoqërie ose çdo subjekt, i cili trajtohet si organ shoqërie për qëllime tatimore;
- f) termi "ndërmarrje" zbatohet për kryerjen e çdo biznesi;
- g) termi "ndërmarrje e një Shteti Kontraktues" dhe "ndërmarrje e një Shteti tjetër Kontraktues" nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i njërit Shtet Kontraktues dhe një ndërmarrje të realizuar nga një rezident i një Shteti tjetër Kontraktues;
- h) termi "trafik ndërkombëtar" do të thotë çdo transport nëpërmjet një anijeje apo mjeti fluturues të vënë në funksionim nga një ndërmarrje, e cila e ka vendin e menaxhimit të saj efektiv në njërin Shtet Kontraktues, me përjashtim të rasteve kur anija apo mjeti fluturues vihen në funksionim vetëm midis vendeve në Shtetin tjetër Kontraktues;
- i) termi "autoritet kompetent" do të thotë:
 - (i) në Izrael, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;
 - (ii) në Shqipëri, Ministri i Financave ose përfaqësuesi i tij i autorizuar;
- j) termi "shtetas", në lidhje me njërin Shtet Kontraktues, do të thotë:
 - (i) çdo individ, i cili zotëron shtetësinë e atij Shteti Kontraktues; dhe
 - (ii) çdo person juridik, partneritet ose shoqëri e cila e përfiton statusin e saj sipas ligjeve në fuqi në atë Shtet Kontraktues;
- k) termi "biznes" përfshin realizimin e shërbimeve profesionale dhe të aktiviteteve të tjera të një karakteri të pavarur.



2. Për sa i përket zbatimit të Konventës në çdo kohë nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përveçse kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllimet tatimore në të cilat zbatohet Konventa, çdo kuptim sipas ligjeve tatimore të zbatueshme të atij Shteti që prevalon ndaj një kuptimi të dhënë atij termi sipas ligjeve të tjera të atij Shteti.

NENI 4 **Rezidenti**

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person, i cili, sipas ligjeve të atij Shteti, është përgjegjës për tatimet e tij për shkak të vendlindjes së tij, vendbanimit, vendit të menaxhimit, vendit të themelimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe përfshin gjithashtu atë Shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet vendor të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin çdo person, i cili është përgjegjës për tatimet në atë Shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burime në atë Shtet.

2. Kur në bazë të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja Shtetet Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si më poshtë:

- a) ai do të konsiderohet se është rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka vendbanim të përhershëm në dispozicion të tij; nëse ka një vendbanim të përhershëm në dispozicion të tij në të dyja Shtetet, ai do të konsiderohet rezident vetëm i Shtetit në të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetike);
- b) nëse Shteti në të cilin ka qendrën e interesave të tij jetike, nuk mund të përcaktohet apo nëse nuk ka vendbanim të përhershëm në dispozicion të tij në asnjërin Shtet, ai do të konsiderohet rezident vetëm në Shtetin në të cilin ka vendbanimin e zakonshëm;
- c) nëse ka vendbanim të zakonshëm në të dyja Shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet se është rezident vetëm i Shtetit në të cilin ka shtetësinë;
- d) nëse ka shtetësinë e të dyja Shteteve ose të asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues do ta zgjidhin çështjen nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët.

3. Kur në bazë të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga individit është rezident në të dyja Shtetet Kontraktuese, autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues do të përpiqen të caktojnë me marrëveshje të përbashkët Shtetin Kontraktues në të cilin do të konsiderohet se ky person është rezident, për qëllimet e Konventës, duke marrë parasysh vendin e tij të menaxhimit, vendin ku është regjistruar ose ndryshe themeluar dhe të gjithë faktorët e tjerë përkatës. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje, ky person nuk do të ketë të drejtë për asnjë rimbursim apo përjashtim nga taksat, të dhënë nga kjo Konventë, përveç deri në masën dhe në mënyrën për të cilën mund të jetë rënë dakord nga autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese.



NENI 5
Selia e Përherëshme

1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “seli e përherëshme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit një biznes”i një ndërmarrjeje zhvillohet plotësisht ose pjesërisht.

2. Termi “seli e përherëshme” përfshin në mënyrë të veçantë:

- a) një vend menaxhimi;
- b) një degë;
- c) një zyrë;
- d) një fabrikë;
- e) një repart; dhe
- f) një minierë, pus naftë apo gazi, gurorë ose çdo vend tjetër për nxjerrjen, eksplorimin ose shfrytëzimin e burimeve natyrore.

3. Termi “seli e përherëshme” përfshin gjithashtu:

a) një shesh ndërtimi, ndërtim, projekt montimi apo instalim ose aktivitete mbikëqyrjeje në lidhje me to, por vetëm nëse këto kantiere, projekte ose aktivitete zgjasin më shumë se nëntë muaj;

b) ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë shërbimet këshillimore ose personelin tjetër, nga një ndërmarrje nëpërmjet punonjësve ose personelit tjetër të angazhuar nga ndërmarrja për këto qëllime, por vetëm nëse këto aktivitete zgjasin më shumë se dymbëdhjetë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përherëshme” konsiderohet se nuk përfshin:

- a) përdorimin e ambienteve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave apo artikujve që i përkasin ndërmarrjes;
- b) mirëmbajtjen e stokut të mallrave apo artikujve që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime të magazinimit, ekspozimit ose shpërndarjes;
- c) mirëmbajtjen e stokut të mallrave apo artikujve që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;
- d) mirëmbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm me qëllimin e blerjes së mallrave ose artikujve apo për mbledhjen e informacionit për ndërmarrjen;
- e) mirëmbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm me qëllimin e kryerjes së çdo aktiviteti tjetër për ndërmarrjen;
- f) mirëmbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët a) deri e),

me kusht që ai aktivitet ose, në rastin e nënparagrafit f), aktiviteti i përgjithshëm i vendit të qëndrueshëm të biznesit, të jetë i një karakteri përgatitor dhe ndihmës.

4.1 Paragrafi 4 nuk zbatohet për një vend të caktuar të një biznesi, i cili përdoret ose mbahet nga një ndërmarrje, nëse ajo ndërmarrje ose një ndërmarrje e lidhur ngushtë me të, e zhvillon aktivitetin e biznesit në të njëjtin vend ose në një vend tjetër në të njëjtin Shtet Kontraktues dhe



- a) ai vend ose një vend tjetër përbën seli të përhershme për ndërmarrjen ose për ndërmarrjen e lidhur ngushtë sipas dispozitave të këtij neni ose
- b) aktiviteti i përgjithshëm që rezulton nga kombinimi i aktiviteteve të zhvilluara nga të dyja ndërmarrjet në të njëjtin vend ose nga të njëjtat ndërmarrje apo nga ndërmarrje të lidhura ngushtë në të dyja vendet, nuk është i një karakteri përgatitor dhe ndihmës,

me kusht që aktiviteti i biznesit, i kryer nga të dyja ndërmarrjet në të njëjtin vend ose nga të njëjtat ndërmarrje apo nga ndërmarrje të lidhura ngushtë në të dyja vendet, të përbëjë funksione plotësuese të cilat janë pjesë e funksionimit të njëkohshëm të biznesit.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, por në bazë të dispozitave të paragrafit 6, në rastet kur një person vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje, dhe duke vepruar kështu ai zakonisht lidh kontrata ose zakonisht luan rol kryesor në drejtimin e lidhjes së kontratave, të cilat si rregull lidhen pa ndonjë ndryshim material nga ndërmarrja dhe këto kontrata janë:

- a) në emër të ndërmarrjes, ose
- b) për transferimin e pronësisë ose për dhënien e të drejtës së përdorimit, të pronës së zotëruar nga ajo ndërmarrje ose të cilën ndërmarrja ka të drejtë të përdorë, ose
- c) për ofrimin e shërbimeve nga ajo ndërmarrje,

ajo ndërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në atë Shtet në lidhje me çdo aktivitet, të cilin ai person e ndërmerr për ndërmarrjen, përveç rastit kur aktivitetet e këtij personi janë të kufizuara tek ato që janë përmendur në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nga një vend i qëndrueshëm biznesi (i ndryshëm nga një vend i qëndrueshëm biznesi në të cilin mund të zbatohet paragrafi 4.1), nuk do ta bëjnë këtë vend të qëndrueshëm biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. a) Paragrafi 5 nuk do të zbatohet në rastet kur personi që vepron në njërin Shtet Kontraktues në emër të një ndërmarrjeje të një Shteti tjetër Kontraktues zhvillon biznes në Shtetin e sipërpërmendur si një agjent i pavarur dhe vepron për një ndërmarrje në zhvillimin normal të atij biznesi. Megjithatë, në rastet kur një person vepron në mënyrë ekskluzive në emër të një ose më shumë ndërmarrjeve me të cilat është i lidhur ngushtë, ai person nuk do të konsiderohet se është agjent i pavarur brenda kuptimit të këtij paragrafi në lidhje me çdo ndërmarrje të tillë.

b) Për qëllimet e këtij neni, një person është i lidhur ngushtë me një ndërmarrje nëse, në bazë të gjitha fakteve dhe rrethanave përkatëse, njëri ka kontrollin e tjetrit ose të dy janë në kontrollin e personave ose ndërmarrjeve të njëjta. Në çdo rast, një person do të konsiderohet se është i lidhur ngushtë me një ndërmarrje nëse njëri zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 50 për qind të interesit të përfutur nga tjetra (ose, në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votave dhe të vlerës totale të aksioneve të shoqërisë apo të interesit në kapitalin përfutur të shoqërisë) ose nëse një person tjetër zotëron në mënyrë të



drejtpërdrejtë ose të tërthortë më shumë se 50 për qind të interesit të përfituar (ose, në rastin e një shoqërie, më shumë se 50 për qind të votave dhe të vlerës totale të aksioneve të shoqërisë apo të interesit në kapitalin përfitues të shoqërisë) ndaj personit dhe ndërmarrjes.

7. Fakti që një shoqëri, e cila është rezidente në njërin Shtet Kontraktues, kontrollon ose është e kontrolluar nga një shoqëri që ushtron veprimtarinë në Shtetin tjetër Kontraktues ose zhvillon biznes në atë Shtet tjetër (qoftë nëpërmjet selisë së përhershme ose ndryshe), asnjëra shoqëri nuk do të përbëjë në vetvete një seli të përhershme të tjetrës.

Kapitulli III

TATIMI I TË ARDHURAVE

NENI 6

Të Ardhurat nga Pasuria e Paluajtshme

1. Të ardhurat që realizohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues, nga pasuria e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pyjet), e cila ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtetin tjetër.
2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues në të cilin ndodhet prona në fjalë. Në çdo rast, ky term do të përfshijë pasuritë, të cilat janë pjesë e pasurisë së paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pyje, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me zbatimin e pronësisë mbi tokën, çdo mundësi ose të drejtë të ngjashme për të përvtsuar pasuri të paluajtshme, uzufukti i pasurisë të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose të ndryshueshme për sa i përket shfrytëzimit ose të drejtës për të shfrytëzuar depozitat minerare, vendburimet dhe burimet e tjera natyrore; anijet, barkat dhe mjetet fluturuese nuk do të konsiderohen pasuri të paluajtshme.
3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që realizohen nga përdorimi i drejtpërdrejtë, qiraja ose përdorimi në çdo formë tjetër të pasurisë së paluajtshme.
4. Dispozitat e paragrafit 1 dhe 3 zbatohen edhe për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

NENI 7

Fitimet nga Biznesi

1. Fitimet e një ndërmarrjeje në njërin Shtet Kontraktues do të tatohen vetëm në atë Shtet, me përjashtim të rasteve kur ndërmarrja zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme e cila ndodhet aty. Nëse ndërmarrja e zhvillon aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet që i atribuohen selisë së përhershme në përputhje me dispozitat e paragrafit 2, duhet të tatohen në atë Shtet tjetër.
2. Për qëllimet e këtij neni dhe të nenit 22 (Eliminimi i Tatimit të Dyfishtë), fitimet të cilat në çdo Shtet Kontraktues janë të atribueshme ndaj selisë së përhershme të



referuar në paragrafin 1, janë fitimet që do të kishte, veçanërisht në marrëdhëniet e saj me pjesët e tjera të ndërmarrjes, sikur të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e pavarur, e angazhuar në aktivitete të njëjta ose të ngjashme në kushte të njëjta ose të ngjashme, duke pasur parasysh funksionet e kryera, pasuritë e përdorura dhe rreziqet e supozuara nga ndërmarrja nëpërmjet selisë së përhershme dhe pjesëve të tjera të ndërmarrjes.

3. Në rastet kur, në përputhje me paragrafin 2, njëri Shtet Kontraktues i rregullon fitimet të cilat janë të atribuueshme ndaj selisë së përhershme të një ndërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe i taton në përputhje me rrethanat fitimet e ndërmarrjes që ka detyrime tatimore në Shtetin tjetër, Shteti tjetër, deri në masën që është e nevojshme do të heqë tatimin e dyfishtë për këto fitime, duke kryer një rregullim të përshtatshëm në shumën e detyrimeve tatimore për këto fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktues, nëse është e nevojshme do të këshillohen me njëri-tjetrin.

4. Në rast se fitimi përfshin zëra të të ardhurave që janë trajtuar në mënyrë të veçantë në nenet e tjera të kësaj Konvente, atëherë dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

NENI 8

Transporti Detar dhe Ajror

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve ose e mjeteve fluturuese në trafikun ndërkombëtar do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të një ndërmarrjeje të transportit detar ose të një ndërmarrjeje transporti të rrugëve ujore të brendshme është në bordin e një anijeje ose barke, atëherë ai do të konsiderohet se ndodhet në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti bazë i qëndrimit të anijes ose barkës, ose nëse nuk ka një port të tillë të qëndrimit bazë, në Shtetin Kontraktues në të cilin është banor operatori i anijes ose i barkës.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen edhe për fitimet nga pjesëmarrja në një bashkësi shoqërisht të ndryshme, biznes të përbashkët ose agjenci që ushtron aktivitet në nivel ndërkombëtar.

NENI 9

Ndërmarrjet e Lidhura

1. Në rastet kur:

- a) një ndërmarrje e njërit Shtet Kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues; ose
- b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në menaxhimin, në kontrollin ose në kapitalin e një ndërmarrjeje të njërit Shtet Kontraktues dhe një ndërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues;



dhe në cilindo nga rastet janë hartuar ose vendosur kritere ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare, të cilat ndryshojnë nga ato që duhet të bëhen ndërmjet ndërmarrjeve të pavarura, atëherë të gjitha fitimet të cilat, me përjashtim të atyre kritereve, do të ishin llogaritur për një nga ndërmarrjet, por për shkak të këtyre kritereve nuk janë llogaritur në këtë mënyrë, duhet të përfshihen në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të taten në përputhje me rrethanat.

2. Në rastet kur njëri Shtet Kontraktues i përfshin fitimet e një ndërmarrjeje të atij Shteti dhe i taton në përputhje me rrethanat, fitimet për të cilat ndërmarrja e Shtetit tjetër Kontraktues ka detyrime tatimore në atë Shtet tjetër dhe fitimet e përfshira për këtë janë fitime të cilat duhet të ishin llogaritur për ndërmarrjen e Shtetit të përmendur në fillim, nëse kriteret e vendosura ndërmjet të dyja ndërmarrjeve kanë qenë ato që duhet të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë ai Shtet tjetër duhet të kryejë një rregullim të përshtatshëm të shumës së detyrimeve të tij tatimore për ato fitime. Për të përcaktuar këtë rregullim, duhet të merren parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente dhe autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese, nëse është e nevojshme do të këshillohen me njëri-tjetrin.

NENI 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një shoqëri e regjistruar në njërin Shtet Kontraktues, një banori të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në këtë Shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin është e regjistruar Shoqëria që paguan dividendë dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse përfituesi i dividendëve është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, detyrimi tatimor nuk duhet të tejkalojë:

a) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve në qoftë se përfituesi i dividendëve është një shoqëri (e ndryshme nga partneriteti apo nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme), e cila mban në mënyrë të drejtpërdrejtë të paktën 25% të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët gjatë të gjithë periudhës 365 ditore, e cila përfshin ditën e pagesës së dividendëve (për qëllime të llogaritjes të kësaj periudhe, nuk do të merret parasysh asnjë ndryshim i pronësisë, i cili mund të rezultojë drejtpërdrejt nga një riorganizim i shoqërisë, siç është riorganizimi i bashkimit apo i ndarjes, të shoqërisë që mban aksionet ose të asaj që paguan dividendët);

b) 15 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk do të cenojë tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Shpërndarjet e kryera nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme, i cili është regjistruar në një Shtet Kontraktues, për një banor të Shtetit tjetër Kontraktues, mund të taten në atë Shtet tjetër. Megjithatë, këto shpërndarje mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin është i regjistruar fondi i investimeve në pasuritë e paluajtshme, i cili kryen shpërndarjet dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse përfituesi i këtyre shpërndarjeve është banor i Shtetit



tjetër Kontraktues dhe mban në mënyrë të drejtpërdrejtë më pak se 10 për qind të kapitalit të atij fondi investimesh në pasuritë e paluajtshme, detyrimi tatimor i vendosur nuk duhet të kalojë 15 për qind të shumës bruto të shpërndarjes.

Ky paragraf nuk do të cenojë tatimin e fondit të investimeve në pasuritë e paluajtshme në lidhje me fitimet nga të cilat janë kryer shpërndarjet.

4. Termi "dividendë", sipas përdorimit në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet "e gëzimit të të drejtave ose pronësisë" ose të drejtat "e gëzimit të të drejtave ose pronësisë", aksionet në miniera, aksionet e themeluesve ose të drejtat e tjera, të cilat nuk janë pretendime borxhi, pjesëmarrëse në fitime, si dhe të gjitha të ardhurat nga të drejtat e tjera të korporatës të cilat janë subjekt i të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet, nga ligjet e Shtetit në të cilin është e regjistruar shoqëria që kryen shpërndarjen.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk do të zbatohen nëse përfituesi i dividendëve ose i shpërndarjeve nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin shoqëria që paguan dividendët apo fondi i investimeve në pasuritë e paluajtshme i cili bën shpërndarjen është rezident, nëpërmjet një selie të përhershme të ndodhur aty dhe mbajtja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët apo shpërndarjet është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këto raste do të zbatohen dispozitat e nenit 7 (Fitimet nga Biznesi).

6. Në rastet kur një shoqëri që është rezidente në një Shtet Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky Shtet tjetër mund të mos vendosë tatim mbi dividendët e paguar nga shoqëria, përveç për atë kohë sa këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij Shteti tjetër ose për atë kohë sa mbajtja në lidhje me të cilën janë paguar dividendët është efektivisht e lidhur me një seli të përhershme, e cila ndodhet në këtë Shtet tjetër, as t'i nënshtrojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë ndaj një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, pavarësisht nëse dividendët e paguar apo fitimet e pashpërndara përbëhen plotësisht apo pjesërisht nga fitimet ose të ardhurat e krijuara në këtë Shtet tjetër.

Ky paragraf zbatohet edhe për shpërndarjet e kryera nga një shoqëri investimesh në pasuritë e paluajtshme.

NENI 11 **Interesi**

1. Interesi që krijohet në një Shtet Kontraktues dhe paguhet ndaj një rezidenti të një Shteti tjetër Kontraktues mund të tatohet në atë Shtetin tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin krijohet dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse përfituesi i interesit është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, detyrimi tatimor nuk duhet të tejkalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit.



3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, interesi i krijuar në një Shtet Kontraktues do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse është paguar:

- a) për Qeverinë e Shtetit tjetër Kontraktues, një nënndarje politike, autoritet vendor ose për Bankën Qendrore të tij;
- b) nga Qeveria e atij Shteti Kontraktues, një nënndarje politike, autoritet vendor ose për Bankën Qendrore të tij;

4. Term "interes", sipas përdorimit në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga pretendimet për borxhe të çfarëdo lloji, pavarësisht nëse janë apo jo të siguruar nga kolaterali dhe pavarësisht nëse mbartin apo jo një të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë të qeverisë dhe të ardhurat nga bonot ose obligacionet, duke përfshirë primet dhe çmimet e bashkëlidhura me këto letra me vlerë, bono ose obligacione. Detyrimet e penaliteteve për pagesa të vonuara nuk do të konsiderohen si interes për këtë qëllim nga ky Nen.

5. Dispozitat e paragrafëve 1, 2 dhe 3 nuk do të zbatohen nëse përfituesi i interesit, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohet interesi, nëpërmjet një selie të përhershme e cila ndodhet aty dhe pretendimit për borxh në lidhje me të cilin paguhet interesi është i lidhur në mënyrë efektive me këtë seli të përhershme. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 (Fitimet nga biznesi).

6. Interesat do të konsiderohen se janë krijuar në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi që paguan interesin, pavarësisht nëse është apo jo rezident i Shtetit Kontraktues, ka në Shtetin Kontraktues një seli të përhershme në lidhje me të cilën ka lindur borxhi për të cilin paguhet interesi dhe ky interes ka lindur nga kjo seli e përhershme, atëherë ky interes do të konsiderohet se është krijuar në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme.

7. Në rastet kur, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe zotëruesit përfitues ose midis këtyre të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e interesit në lidhje me pretendimin për borxh për të cilin është paguar, e tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe zotëruesit përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij Neni për shumën e fundit të përmendur. Në këto raste, pjesa e tejkaluar e pagesave do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

NENI 12 **Honoraret**

1. Honoraret e krijuara në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në Shtetin tjetër.

2. Megjithatë, këto honorare mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues në të cilin janë krijuar dhe në përputhje me ligjet e atij Shteti, por nëse përfituesi i honorareve



është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, detyrimi tatimor nuk duhet të tejkalojë 5 për qind të shumës bruto të honorareve.

3. Termi “honorare”, sipas përdorimit në këtë Nen, nënkupton pagesat e çfarëdo lloji të marra në konsideratë për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori letrar, punimi artistik ose shkencor duke përfshirë filmat kinematografikë, të gjitha patentat, markat tregtare, projektet ose modelet, planet, formulat ose proceset sekrete ose për përdorimin e tyre apo të drejtën për të përdorur pajisje industriale, tregtare ose shkencore ose për informacion (njohuri) në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse përfituesi i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues në të cilin krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme që ndodhet aty dhe e drejta ose pronësia në lidhje me të cilën janë paguar honoraret është e lidhur në mënyrë efektive me këtë seli të përhershme. Në këto raste, do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 (Fitimet nga Biznesi).

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur paguesi është rezident i atij Shteti. Megjithatë, në rastet kur personi i cili paguan honoraret, pavarësisht nëse është apo jo rezident i Shtetit Kontraktues, ka në Shtetin Kontraktues një seli të përhershme në lidhje me të cilën ka ndodhur detyrimi për të paguar honoraret dhe kur këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme, atëherë këto honorare do të konsiderohen se krijohen në Shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme.

6. Në rastet kur, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis paguesit dhe zotëruesit përfitues ose midis atyre të dyve dhe ndonjë personi tjetër, shuma e honorarëve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin janë paguar, e tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord ndërmjet paguesit dhe zotëruesit përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm për shumën e fundit të përmendur. Në këto raste, pjesa e tejkaluar e pagesave do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Konvente.

NENI 13

Fitimet e Kapitalit

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i Shtetit Kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të referuar në Nenin 6 (Të Ardhurat nga Pasuria e Paluajtshme) dhe të ndodhura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme, e cila përbën pjesë të pronësisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje në një Shtet Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues, duke përfshirë fitime të tilla nga tjetërsimi i këtyre selive të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen), mund të tatohen në atë Shtet tjetër.



3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose mjeteve fluturuese që operojnë në trafikun ndërkombëtar ose pasuritë e luajtshme, të cilat i përkasin operimit të këtyre anijeve, mjeteve fluturuese ose barkave, do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendqëndrimi i përhershëm i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e realizuara nga një rezident i Shtetit Kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të krahaseshme, të tilla si interesat në një partneritet ose trust, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues nëse, në çdo kohë gjatë periudhës 365 ditore para tjetërsimit, këto aksione ose interesa të krahaseshme, të realizuara më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë nga pasuria e paluajtshme e që ndodhet në atë Shtet tjetër Kontraktues (me përjashtim të pasurisë së paluajtshme ose një pjese të saj, e cila është tjetërsuar ndërmjet asaj kohe dhe kohës së tjetërsimit të aksioneve ose interesave të ngjashme, për aq kohë sa asnjë pjesë e vlerës së këtyre aksioneve ose interesave të ngjashme është realizuar nga ajo pasuri e paluajtshme ose pjesa e saj e cila është tjetërsuar, në kohën e atij tjetërsimi të mëpasshëm).

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo prone të ndryshme nga sa është referuar në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin është banor tjetërsuesi, nëse ai banor është zotërues përfitues për të gjithë periudhën për të cilën janë llogaritur fitimet e kapitalit.

NENI 14

Të ardhurat nga Punësimi

1. Në bazë të dispozitave të Neneve 15 (Tarifat e Drejtorëve), 17 (Pensionet, Pensionet Vjetore dhe Pagesat e Sigurimeve Shoqërore), 18 (Shërbimet Qeveritare) dhe 19 (Profesorët, Mësuesit dhe Studiuesit), pagat, rrogat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet, përveç rasteve kur punësimi ushtrohet në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë formë, ky shpërblim, ashtu siç realizohet atje, mund të tatohet në atë Shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pagesa e realizuar nga një rezident i një Shteti Kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të jetë i tatueshëm vetëm në Shtetin e përmendur në fillim nëse:

- a) marrësi është i pranishëm në Shtetin tjetër për një periudhë ose për periudha të cilat nuk i kalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose mbaron në vitin ushtrimor në fjalë; dhe
- b) pagesa është paguar nga ose në emër të një punonjësi, i cili nuk është banor i Shtetit tjetër; dhe
- c) pagesa nuk ka lindur nga një seli e përhershme të cilën ka punonjësi në Shtetin tjetër.



3. Pavarësisht nga dispozitat pararendëse të këtij Neni, shpërblimi i realizuar në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose mjeti fluturues, i cili operon në trafikun ndërkombëtar ose në bordin e një mjeti lundrues të përfshirë në transportin në ujërat e brendshëm, mund të tatohet në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Të ardhurat nga pagesa për largimin nga puna të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, duke marrë në konsideratë punësimin e kaluar në të dyja Shtetet Kontraktuese, do të tatohen në secilin Shtet Kontraktues në përputhje me periudhën e punësimit në atë Shtet.

NENI 15 **Tarifat e Drejtorëve**

Tarifat e Drejtorëve dhe pagesat e tjera të ngjashme, të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i një bordi drejtorësh të një shoqërie që është rezidente në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

NENI 16 **Artistët dhe Sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 14 (Të ardhurat nga Punësimi), të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, si interpretues, si artist në një teatër, kinematografi, radio ose televizion apo një muzikant ose sportist, nga aktivitetet e tij personale siç mund të ishin ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në atë Shtet tjetër.

2. Në rastet kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një interpretues ose sportist në cilësinë e tij si i tillë rriten jo për interpretuesin apo për sportistin, por për një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e Nenit 14 (Të ardhurat nga Punësimi), mund të tatohen në Shtetin Kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e interpretuesit apo të sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga aktivitetet e ushtruara në një Shtet Kontraktues nga një interpretues ose sportist i cili është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, nëse vizita në Shtetin Kontraktues të përmendur fillimisht është e mbështetur plotësisht ose pjesërisht nga Shteti tjetër Kontraktues ose nga një nënndarje politike apo nga autoritetet vendore të tij.

NENI 17 **Pensionet, Pensionet Vjetore dhe Pagesat e Sigurimeve Shoqërore**

1. Në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të Nenit 18 (Shërbimet Qeveritare), pensionet, pensionet vjetore dhe shpërblime të tjera të ngjashme të paguara nga një banor i një Shteti Kontraktues, duke pasur parasysh punësimet e kaluara, do të tatohen vetëm në atë Shtet.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet e paguara dhe pagesat e tjera të kryera sipas legjislacionit për sigurimet shoqërore të një Shteti Kontraktues,



pensionet vjetore dhe pagesat e tjera periodike ose rastësore të kryera nga qeveria e një Shteti Kontraktues ose nga një nënndarje politike apo nga autoritetet vendore të tij në lidhje me sigurimin e personelit të tij ndaj aksidenteve, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

NENI 18 **Shërbimet Qeveritare**

1. a) Pagat, rrogat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme, të paguara nga një Shtet Kontraktues ose nga një nënndarje politike apo nga një autoritet vendor i tij ndaj një individi në lidhje me shërbimet e kryera në atë Shtet apo nënndarje ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto paga, rroga dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse shërbimet janë kryer në atë Shtet dhe individi është rezident i atij Shteti në të cilin:
 - (i) është me shtetësi të atij Shteti; ose
 - (ii) nuk bëhet banor i atij Shteti vetëm për qëllimin e kryerjes së shërbimeve.
2. a) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të paguara nga ose prej fondeve të krijuara nga një Shtet Kontraktues ose nga një nënndarje politike apo autoritet vendor i tij ndaj një individi në lidhje me shërbimet e kryera në atë Shtet apo nënndarje ose autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë Shtet.

b) Megjithatë, këto pensione dhe shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse individi është rezident dhe me shtetësi atij Shteti.
3. Dispozitat e Neneve 14 (Të ardhurat nga Punësimi), 15 (Tarifat e Drejtorëve), 16 (Artistët dhe Sportistët) dhe 17 (Pensionet, Pensionet Vjetore dhe Pagesat e Sigurimeve Shoqërore) do të zbatohen për pagat, rrogat, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, për sa i përket shërbimeve të kryera në lidhje me një biznes të zhvilluar nga një Shtet Kontraktues ose nënndarje politike apo autoritet vendor i tij.

NENI 19 **Profesorët, Mësuesit dhe Studiuesit**

1. Një individ që viziton një nga Shtetet Kontraktuese për një periudhë që nuk i kalon dy vjet, për qëllime të mësimdhënies ose angazhimit studimor në një universitet, kolegji, shkollë apo institucion tjetër arsimor të njohur në atë Shtet Kontraktues dhe që menjëherë përpara asaj vizite ka qenë rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, për një periudhë që nuk kalon dy vjet nga data e mbërritjes së tij të parë në atë Shtet të përmendur fillimisht për atë qëllim, do të përjashtohet nga tatimi në atë Shtet Kontraktues mbi shpërblimin për këtë mësimdhënie ose studim.



2. Asnjë përjashtim nuk do të jepet sipas paragrafit 1, në lidhje me çfarëdolloj shpërblimi për kërkime, nëse këto kërkime janë ndërmarrë jo për interesin publik por kryesisht për përfitime private të një personi ose personave të caktuar.

NENI 20 **Studentët**

Pagesat që një student apo praktikant biznesi, i cili është ose ka qenë menjëherë përpara vizitës në një Shtet Kontraktues, rezident i Shtetit tjetër Kontraktues dhe që është i pranishëm në Shtetin e përmendur fillimisht vetëm për qëllime të arsimit apo trajnimit të tij, e merr për qëllime të jetesës, arsimit ose trajnimit të tij, nuk do të tatóhet në atë Shtet, me kusht që këto pagesa të krijohen nga burime jashtë atij Shteti.

NENI 21 **Të ardhurat e tjera**

1. Llojet e të ardhurave të përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues, kudo që të krijohen, të patrajuara në Nenet pararendëse të kësaj Konvente, do të tatóhen vetëm në atë Shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1, nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat prej pasurive të paluajtshme sipas përcaktimit në paragrafin 2 të Nenit 6 (Të Ardhurat nga Pasuria e Paluajtshme), nëse përfituesi i këtyre të ardhurave, duke qenë banor i njërit Shtet Kontraktues, zhvillon biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të ndodhur atje dhe e drejta e pronësisë në lidhje me të cilën është paguar e ardhura, është e lidhur në mënyrë efektive me këtë seli të përhershme. Në këto raste, do të zbatohen dispozitat e Nenit 7 (Fitimet nga Biznesi).

3. Në rastet kur, për shkak të një marrëdhënieje të veçantë midis rezidentit të referuar në paragrafin 1 dhe ndonjë personi tjetër apo midis atyre të dyve dhe ndonjë personi të tretë, shuma e të ardhurave e referuar në atë paragraf e tejkalon shumën (nëse ka), e cila mund të ishte rënë dakord midis tyre në mungesë të kësaj marrëdhënieje, dispozitat e këtij Neni do të zbatohen vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e të ardhurave do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera në fuqi të kësaj Konvente.

Kapitulli IV

METODAT PËR ELIMINIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË

NENI 22 **Eliminimi i Tatimit të Dyfishtë**

1. Në rastin e Izraelit, tatimi i dyfishtë do të shmanget si vijon:

- a) Në rastet kur një rezident i Izraelit realizon të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të tatóhen në Shqipëri, (në bazë të ligjeve të Izraelit në lidhje me lejimin e kreditimit të tatimeve të huaja, të



cilat nuk cenojnë parimet themelore në përmbajtje të këtij paragrafi), Izraeli do të lejojë një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, në një shumë të barabartë me tatimet e paguara në Shqipëri.

- b) Megjithatë, këto zbritje nuk do të tejkalojnë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat që është llogaritur para miratimit të zbritjes, e cila i atribuohet të ardhurave që mund të ishin tatuar në Shqipëri.

2. Në rastin e Shqipërisë, tatimi i dyfishtë do të shmanget si vijon:

- a) Në rastet kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, mund të taten në Izrael, Shqipëria do të lejojë një zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, në një shumë të barabartë me tatimet e paguara në Izrael.
- b) Megjithatë, në raste të tjera kjo zbritje nuk do të tejkalojnë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat që është llogaritur përpara miratimit të zbritjes, e cila i atribuohet sipas rastit, të ardhurave që mund të ishin tatuar në Izrael.

3. Në rastet kur, në përputhje me të gjitha dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht se të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues janë përjashtuar nga tatimi në atë Shtet, ai Shtet, për të llogaritur shumën e tatimit të pjesës së mbetur, mund të marrë në konsideratë të ardhurat e përjashtuara.

Kapitulli V

DISPOZITA TË VEÇANTA

NENI 23

Mosdiskriminimi

1. Shtetasit e një Shteti Kontraktues nuk i nënshtrohen, në Shtetin tjetër Kontraktues, asnjë tatimi apo çfarëdolloj kërkesë të lidhur me to, e cila është e ndryshme ose më rënduese sesa tatimi dhe kriteret e lidhura, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen shtetasit e atij Shteti tjetër në të njëjtat rrethana, në veçanti në lidhje me vendbanimin.

2. Tatimi në një seli të përhershme, të cilën një ndërmarrje e një Shteti Kontraktues e ka në Shtetin tjetër Kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë Shtet tjetër sesa tatimi i vendosur në ndërmarrjet e atij Shteti tjetër, të cilat zhvillojnë të njëjtat aktivitete.

3. Asgjë në këtë Nen nuk interpretohet si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i dhënë banorëve të Shtetit tjetër Kontraktues ndihma personale, kompensime dhe zbritje për qëllime tatimore, për llogari të statusit civil ose përgjegjësiwe familjare, të cilat u jep banorëve të vet.

4. Me përjashtim të rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të Nenit 9 (Ndërmarrjet e Lidhura), paragrafit 7 të Nenit 11 (Interesi), paragrafit 6 të Nenit 12



(Honoraret) ose paragrafit 3 të Nenit 21 (Të ardhurat e tjera), interesat, honoraret dhe pagesat e tjera të disbursueshme nga një ndërmarrje e njërit Shtet Kontraktues ndaj një rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, me qëllim përcaktimin e fitimit të tatueshëm të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur të kishin qenë paguar ndaj një rezidenti të Shtetit të përmendur në fillim.

5. Ndërmarrjet e njërit Shtet Kontraktues, kapitali i të cilave është i kontrolluar plotësisht ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nga një ose më shumë rezident të Shtetit tjetër Kontraktues, në Shtetin e përmendur në fillim nuk do të nënshtrohen ndaj ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, e cila është e ndryshme ose më rënduese se tatimi dhe kriteret e lidhura ndaj të cilave mund të nënshtrohen ndërmarrjet e tjera të ngjashme në Shtetin e përmendur në fillim.

6. Dispozitat e këtij Neni zbatohen ndaj tatimeve të referuara në Nenin 2 (Tatimet e Mbuluara) të kësaj Konvente.

NENI 24

Procedura e Marrëveshjes së Përbashkët

1. Në rastet kur një person çmon se veprimet në njërin apo në të dy Shtetet Kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të, në tatime të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, pavarësisht rimbursimeve të dhëna nga ligji vendas në ato Shtete, ai mund ta paraqesë rastin e vet në autoritetin kompetent të Shtetit Kontraktues në të cilin është rezident ose, nëse rasti i tij lidhet me paragrafin 1 të Nenit 23 (Mosdiskriminimi) të atij Shteti Kontraktues ku ai ka shtetësinë. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetëve nga njoftimi i parë i veprimit, i cili rezulton në tatim jo në përputhje me dispozitat e Konventës.

2. Autoriteti kompetent do të përpiqet, nëse kundërshtimi rezulton i justifikuar dhe nëse ai vetë nuk mund të arrijë një zgjidhje të kënaqshme, për ta zgjidhur çështjen në marrëveshje të përbashkët me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, nga pikëpamja e shmangies së tatimit të dyfishtë i cili nuk është në përputhje me Konventën. Çdo marrëveshje e arritur do të zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të Shtetit Kontraktues.

3. Autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje të përbashkët të gjitha vështirësitë ose dyshimet e krijuara për interpretimin ose zbatimin e Konventës. Ata gjithashtu mund të këshillohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet e paparashikuara në Konventë.

4. Autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues mund të komunikojnë me njëri-tjetrin drejtpërdrejt, duke përfshirë edhe nëpërmjet një komisioni të përbashkët, i cili përbëhet prej tyre ose përfaqësuesve të tyre, për qëllimet e arritjes së një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm.



NENI 25

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shtetit Kontraktues do ta shkëmbejnë këtë informacion sipas parashikimit përkatës për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente ose për administrimin ose zbatimin e ligjeve vendase të Shtetit Kontraktues në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo Konventë, të vendosura për llogari të Shtetit Kontraktues apo nënndarjeve të tij politike ose autoriteteve lokale, për aq kohë sa tatimi në bazë të tyre nuk bie ndesh me këtë Konventë. Shkëmbimi i informacionit nuk është i kufizuar nga Neni 1 (Personat e Mbuluar).

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë sipas ligjeve vendase të atij Shteti dhe do të nxirret vetëm për personat ose autoritetet (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative), të cilat trajtojnë vlerësimin ose mbledhjen e tij, me zbatimin ose ndjekjen penale në lidhje me të, me përcaktimin e apelimeve në lidhje me tatimet e çfarëdo lloji dhe përshkrimin ose mbikëqyrjen e sa më sipër. Këta persona ose autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ato mund ta nxjerrin informacionin në procedimet gjyqësore publike ose në vendimet juridike.

3. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të interpretohen sikur e vendosin njërin Shtet Kontraktues përpara detyrimit që:

- a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij Shteti apo të një Shteti tjetër Kontraktues;
- b) të japë informacion që nuk është siguruar sipas ligjeve ose në zhvillimin normal të administrimit të tij ose të një Shteti tjetër Kontraktues;
- c) të japë informacion që nuk do të zbulojë asnjë sekret tregtar, biznesi, industrial, shkëmbimi tregtar ose profesional apo proces tregtar ose informacion, nxjerrja e të cilit mund të jetë në kundërshtim me politikën publike (*ordre public*).

4. Nëse ky informacion kërkohet nga njëri Shtet Kontraktues në përputhje me këtë Nen, Shteti tjetër Kontraktues do ta përdorë informacionin e tij për të marrë masa që të sigurojë informacionin e kërkuar, megjithëse atij Shteti tjetër mund të mos i nevojitet ky informacion për qëllimet e tij tatimore. Detyrimet sipas fjalisë pararendëse i nënshtrohen kufizimeve të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk do të interpretohen si lejim i njërit Shtet Kontraktues për të refuzuar dhënien e informacionit vetëm për shkak se ai nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 3 nuk do të interpretohen si lejim i njërit Shtet Kontraktues për të refuzuar dhënien e informacionit vetëm sepse ky informacion mbahet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar apo person që vepron në një agjenci ose cilësi mirëbesimi apo meqë lidhet me interesat e pronësisë së një personi.



NENI 26

Kufizimi i Përfitimeve

1. Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Konvente, një përfitim sipas kësaj Konvente nuk do të jepet në lidhje me një element të të ardhurave ose të kapitalit, nëse është e arsyeshme të konkludohet, duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse, se marrja e atij përfitimi ka qenë një nga qëllimet kryesore të çdo rregullimi ose transaksioni, i cili ka rezultuar drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë në atë përfitim, përveç rasteve kur konstatohet se dhënia e atij përfitimi në këto rrethana duhet të ishte në përputhje me objektin dhe qëllimin e dispozitave përkatëse të kësaj Konvente.

2. a) Në rastet kur:

- i) një ndërmarrje në njërin Shtet Kontraktues realizon të ardhura nga një Shtet tjetër Kontraktues dhe Shteti i përmendur në fillim i trajton këto të ardhura si të atribuueshme ndaj një selie të përhershme të ndërmarrjes së ndodhur në një juridiksion të tretë dhe

- ii) fitimet e atribuueshme ndaj asaj selie të përhershme janë të përjashtuara nga tatimi në Shtetin e përmendur në fillim.

përfitimet e kësaj Konvente nuk do të zbatohen për asnjë element të të ardhurave mbi të cilat tatimi në juridiksionin e tretë është më pak se 60 për qind i tatimit që duhet të ishte vendosur në Shtetin e përmendur në fillim për atë element të të ardhurave, nëse ajo seli e përhershme do të ndodhej në Shtetin e përmendur në fillim. Në këto raste, çdo e ardhur ndaj të cilave zbatohen dispozitat e këtij paragrafi do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjin vendas të Shtetit tjetër, pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e Konventës.

- b) Dispozitat pararendëse të këtij paragrafi nuk do të zbatohen nëse të ardhurat e realizuara nga Shteti tjetër burojnë nga ose janë karakteristike për sjelljen aktive të një biznesi të zhvilluar nëpërmjet selisë së përhershme (i ndryshëm nga biznesi i kryerjes, menaxhimit ose thjesht mbajtjes së investimeve për llogari të vetë ndërmarrjes, përveç rasteve kur këto janë aktivitete bankare, sigurimesh ose aktivitete të letrave me vlerë të kryera përkatësisht nga një bankë, ndërmarrje sigurimesh ose tregtar i regjistruar i letrave me vlerë).
 - c) Nëse përfitimet sipas kësaj Konvente, pavarësisht se në përputhje me dispozitat e mësipërme të këtij paragrafi janë mohuar në lidhje me një element të të ardhurave të realizuara nga një banor i njërit Shtet Kontraktues, autoriteti kompetent i Shtetit tjetër Kontraktues mund t'i japë këto të drejta në lidhje me atë element të të ardhurave, nëse ky autoritet kompetent përcakton se dhënia e këtyre përfitimeve është e justifikuar, duke marrë parasysh arsyen se ky banor nuk i plotëson kriteret e këtij paragrafi. Autoriteti kompetent i Shtetit Kontraktues në të cilin është bërë kërkesa sipas fjalisë së mësipërme, do të këshillohet me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues përpara dhënies ose mohimit të kërkesës.

**NENI 27****Anëtarët e Misioneve Diplomatike
dhe Posteve Konsullore**

Asgjë në këtë Konventë nuk do të cenojë privilegjet tatimore të anëtarëve të misioneve diplomatike ose të korrierëve diplomatikë sipas rregullave të përgjithshme të të Drejtës Ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

Kapitulli VI**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE****NENI 28****Hyrja në Fuqi**

Secili nga Shtetet Kontraktuese do të njoftojë Shtetin tjetër Kontraktues, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave të kërkuara nga ligjet e tij për hyrjen në fuqi të kësaj Konvente.

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së këtyre njoftimeve dhe për këtë arsye do të ketë efekt:

- a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim për shumat e paguara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin ka hyrë në fuqi Konventa;
- b) në lidhje me tatimet e tjera, për tatimet e vendosura për periodhat që fillojnë në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik në të cilin ka hyrë në fuqi Konventa.

NENI 29**Përfundimi**

Kjo Konventë do të mbetet në fuqi derisa të përfundojë nga njëri Shtet Kontraktues. Secili Shtet Kontraktues mund t'i japë fund kësaj Konvente, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftim për përfundimin, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të një viti kalendarik, i cili fillon në ose pas përfundimit të një periudhe prej pesë vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në një rast të tillë, Konventa do të pushojë së pasuri efekt:

- a) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, për shumat e paguara në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pas vitit në të cilin është dhënë ky njoftim;
- b) në lidhje me tatimet e tjera, për tatimet e vendosura për periodhat që fillojnë në ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik pas vitit të cilin është dhënë ky njoftim.



NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë këtu të autorizuar sipas rregullave nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në dy kopje në *Jerusalem* në datën *03* të muajit *Maj* 20*21* e cila korrespondon me *21* ditën *7.4.21* të Kalendarit Hebraik, në gjuhën shqipe, hebraike dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të çfarëdo shmangieje nga dispozitat e kësaj Konvente, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e
Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Për Qeverinë
e Shtetit të Izraelit



PROTOKOLL

Në nënshkrimin e Konventës ndërmjet Qeverisë së Shtetit të Izraelit dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal në lidhje me Tatimin mbi të Ardhurat, Qeveria e Shtetit të Izraelit dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kanë rënë dakord se dispozitat e mëposhtme do të jenë pjesë përbërëse e Konventës.

1. Në përgjithësi:

Pranohet se Konventa nuk do ta pengojë një Shtet Kontraktues të zbatojë dispozitat e ligjit të tij vendas mbi parandalimin e evazionit tatimor ose shmangien e tatimeve në rastet kur ato dispozita përdoren për të kundërshtuar marrëveshje, të cilat përbëjnë shpërdorim të Konventës.

2. Duke iu referuar Nenit 2 (Tatimet e Mbuluara) të Konventës:

Pranohet se tatimet e përshkruara në klauzolën 3(a)(i) përfshijnë edhe tatimet e vendosura sipas *Ligjit Nr. 5771-2011 Për Tatimin e Fitimit të Naftës në rastin e Izraelit dhe të Ligjit Nr. 7811/1994 "Sistemi tatimor në Sektorin e Naftës", i ndryshuar në rastin e Shqipërisë.*

3. Duke iu referuar nënparagrafit c të paragrafit 1 të Nenit 3 (përkufizimet):

Pranohet se përkufizimi "person" përfshin një plan pensionesh dhe një trust.

"plan pensionesh" nënkupton çdo plan, skemë, fond, trust ose rregullim tjetër të vendosur në njërin Shtet Kontraktues, i cili:

(a) (i) në rastin e Izraelit, është një plan pensionesh i miratuar në përputhje me dispozitat e Aktit për Kontrollin e Shërbimeve Financiare (Fondet e Dhëna) 2005, si Fond për dhënien e Pensioneve;

(ii) në rastin e Shqipërisë, është një plan pensionesh që rregullohet sipas Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 "Për Fondet e Pensioneve Vullnetare", i ndryshuar;

dhe

(b) vepron kryesisht për të administruar ose dhënë pension, ose përfitime të daljes në pension, përfitime për të punësuarit ose të vetëpunësuarit, ose për të fituar të ardhura në interes të një ose më shumë marrëveshjeve të tilla.

4. Duke iu referuar paragrafit 3 të Nenit 4 (Rezidenti) të Konventës:

Pranohet se në përpjekjet për të përcaktuar vendin e regjistrimit të një trusti për një periudhë të caktuar, autoritetet kompetente do të marrin në konsideratë të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë:

a) vendbanimin e rezidentit në kohën që trusti është vendosur dhe në periudhën në fjalë;



- b) Shteti në të cilin janë banorë përfituesit e trustit për periudhën në fjalë.
- c) ekzistenca e lidhjeve familjare midis banorëve dhe përfituesve; dhe
- d) vendndodhja e pasurive të trustit.

5. Duke iu referuar paragrafit 3 të Nenit 8 (Transporti Detar dhe Ajror) të Konventës

Pranohet se dispozitat e paragrafit 3 të Nenit 8 do të zbatohen për fitimet nga pjesëmarrja në një bashkësi shoqërisht të ndryshme, biznes të përbashkët ose agjenci veprimtarish ndërkombëtare, vetëm deri në masën që fitimet e realizuara në këtë mënyrë janë të atribuueshme ndaj pjesëmarrësit në përpjesëtim me aksionet e tij në veprimtarinë e përbashkët.

6. Duke iu referuar Nenit 10 (Dividendët) të Konventës:

Pranohet se termi "dividendët" nuk përfshin "shpërndarjet nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme".

Termi "shpërndarjet nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme" në rastin e Izraelit, nënkupton shpërndarjet nga një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme sipas Nenit 64A3 të Urdhërësës së Izraelit për Tatimin mbi të Ardhurat.

Një "Fond Investimesh në Pasuritë e Paluajtshme" nënkupton një fond investimesh në pasuritë e paluajtshme sipas Nenit 64A3 të Urdhërësës së Izraelit për Tatimin mbi të Ardhurat.

7. Duke iu referuar Nenit 13 (Fitimet e Kapitalit):

Pranohet se Neni 13 nuk e pengon një Shtet Kontraktues që të tatojë një person, i cili ka qenë rezident i tij dhe është bërë rezident i Shtetit tjetër Kontraktues në lidhje me fitimet e kapitalit të pronës së atij personi menjëherë para ndryshimit të vendbanimit, sipas ligjeve vendase të Shtetit të përmendur në fillim.

8. Duke iu referuar Nenit 22 (Eliminimi i Tatimit të Dyfishtë) të Konventës:

Pranohet se secili Shtet Kontraktues do të kreditojë detyrimet tatimore në Shtetin tjetër Kontraktues sipas ligjeve të tij mbi fitimin në lidhje me tjetërsimin e supozuar për emigracionin sipas paragrafit 7 të këtij Protokoll.

Bërë në dy kopje në Jeruzalem në datën 03 të muajit Maj 2021 e cila korrespondon me 21 ditën 1445 të Kalendarit Hebraik, në gjuhën shqipe, hebraike dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentikë. Në rast të çfarëdo shmangieje nga dispozitat e kësaj Konvente, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Këshillin e
Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Për Qeverinë
e Shtetit të Izraelit



DEKRET

Nr. 13320, datë 10.11.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 108/2021, “Për ratifikimin e konventës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Izraelit për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 109/2021

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS
SË KËSHILLIT TË EVROPËS
PËR BASHKËPRODHIMIN
KINEMATOGRAFIK (E RISHIKUAR),
ROTTERDAM, 30.1.2017**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa e Këshillit të Evropës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.1.2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.11.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13319, datë 10.11.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**KONVENTA E KËSHILLIT TË EVROPËS
PËR BASHKËPRODHIMIN
KINEMATOGRAFIK
(e rishikuar)**

[Rotterdam, 30.1.2017]

Parathënie

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera palë në Konventën Kulturore Evropiane (ETS nr. 18), nënshkruese të saj,

duke marrë parasysh se qëllimi i Këshillit të Evropës është që të arrijë një bashkim më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllimin, në veçanti, për të ruajtur dhe për të nxitur idealet dhe parimet që formojnë trashëgiminë e përbashkët;

duke marrë parasysh se liria e krijimtarisë dhe liria e shprehjes përbëjnë elemente themelore të këtyre parimeve;

duke marrë parasysh se mbrojtja e larmisë kulturore të vendeve të ndryshme evropiane është një nga qëllimet e Konventës Kulturore Evropiane;

duke pasur parasysh Konventën e UNESCO-s mbi Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore (Paris, 20 tetor 2005), e cila e njeh diversitetin kulturor si karakteristikë përcaktuese të njerëzimit dhe synon të forcojë krijimin, prodhimin, përhapjen, shpërndarjen dhe gëzimin e shprehjeve kulturore;

duke marrë parasysh se bashkëprodhimi kinematografik, si mjet i krijimtarisë dhe i shprehjes së larmisë kulturore në shkallë globale, duhet të forcohet më tej;

të vetëdijshëm që filmi është mjet i rëndësishëm i shprehjes kulturore dhe artistike me rol thelbësor në përkrahjen e lirisë së shprehjes, diversitetit dhe krijimtarisë, si dhe të qytetarisë demokratike;



të vendosur për t'i zhvilluar këto parime dhe duke rikujtuar rekomandimet e Komitetit të Ministrave në fushën e kinemasë dhe atë audiovizuale dhe, veçanërisht, rekomandimin R (86) 3 mbi nxitjen e prodhimit audiovizual në Evropë, si edhe Rekomandimin Rek/KM (2009) 7 mbi politikat kombëtare të filmit dhe diversitetin e shprehjeve kulturore;

duke pranuar që Rezoluta Rez (88) 15 për krijimin e një Fondi Evropian Mbështetës për Kopjimin dhe Shpërndarjen e Veprave Krijuese Kinematografike dhe Audiovizuale “Eurimages” është ndryshuar për të lejuar aderimin e shteteve joanëtare;

të vendosur për të arritur këta objektiva falë një përpjekjeje të përbashkët për të nxitur bashkëpunimin dhe për të përcaktuar rregullat që përshtaten me bashkëprodhimet kinematografike në tërësi;

duke marrë parasysh që miratimi i rregullave të përbashkëta synon të zvogëlojë kufizimet dhe të inkurajojë bashkëpunimin në fushën e bashkëprodhimit kinematografik;

duke marrë parasysh evolucionin teknologjik, ekonomik dhe financiar të industrisë së filmit, që nga hapja për nënshkrimin e Konventës Evropiane për Bashkëprodhimin Kinematografik (ETS Nr. 147) në vitin 1992;

duke besuar se ky zhvillim kërkon një rishikim të Konventës së vitit 1992, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia dhe efektiviteti i këtij kuadri për bashkëprodhimin kinematografik;

duke pranuar që kjo Konventë synon të zëvendësojë Konventën Evropiane për Bashkëprodhimin Kinematografik,

kanë rënë dakord si vijon:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi i Konventës

Palët në këtë Konventë marrin përsipër që të nxisin zhvillimin e bashkëprodhimit kinematografik ndërkombëtar, në përputhje me dispozitat që vijojnë më poshtë.

Neni 2 Fusha e veprimit

1. Kjo Konventë do të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet Palëve në fushën e bashkëprodhimeve kinematografike shumëpalëshe në territorin e Palëve.

2. Kjo Konventë do të zbatohet, për:

a) bashkëprodhimet që përfshijnë të paktën tre bashkëprodhues, të vendosur në tri vende të ndryshme Palë të kësaj Konvente; dhe

b) bashkëprodhimet që përfshijnë të paktën tre bashkëprodhues të vendosur në tri vende të ndryshme Palë të kësaj Konvente dhe një apo më shumë bashkëprodhues, të cilët nuk janë të vendosur në këto vende Palë. Kontributi i përgjithshëm i bashkëprodhuesve, të cilët nuk janë të vendosur në vendet Palë të kësaj Konvente, megjithatë nuk duhet të kalojë 30% të kostos së përgjithshme të prodhimit.

Në të gjitha rastet, kjo Konventë do të zbatohet vetëm me kushtin që vepra të përputhet me përkufizimin e një vepre kinematografike të bashkëprodhuar zyrtarisht, siç përcaktohet në nenin 3, nënparagrafi “c”, më poshtë.

3. Dispozitat e marrëveshjeve dypalëshe të lidhura ndërmjet Palëve të kësaj Konvente do të vazhdojnë të zbatohen për bashkëprodhimet dypalëshe. Në rastin e bashkëprodhimeve shumëpalëshe, dispozitat e kësaj Konvente do të kenë përparësi mbi ato të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve Palë në këtë Konventë. Dispozitat në lidhje me bashkëprodhimet dypalëshe do të mbeten në fuqi, në rast se nuk bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente.

4. Nëse nuk ka asnjë marrëveshje që rregullon marrëdhëniet e bashkëprodhimit dypalësh ndërmjet dy Palëve të kësaj Konvente, Konventa do të zbatohet, gjithashtu, ndaj bashkëprodhimeve dypalëshe, përveç kur është bërë një rezervë nga njëra nga Palët e përfshira, sipas kushteve të nenit 22.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

a) termi “vepër kinematografike” do të nënkuptojë një vepër të çfarëdo gjatësie apo mjeti, në veçanti veprat kinematografike krijuese, ato me



kartonë dhe dokumentarët, të cilat janë në përputhje me dispozitat që rregullojnë industrinë e filmit, që janë në fuqi në secilën nga Palët e interesuara dhe që ka për qëllim të shfaqet në kinema;

b) termi “bashkëprodhues” do të nënkuptojë shoqëritë e prodhimit kinematografik apo prodhuesit të vendosur në vendet Palë të kësaj Konvente dhe të lidhura në një kontratë bashkëprodhimi;

c) termi “vepër kinematografike e bashkëprodhuar zyrtarisht” (referuar më poshtë si “filmi”) do të nënkuptojë një vepër kinematografike, që plotëson kushtet e përcaktuara në shtojcën II, që është pjesë përbërëse e kësaj Konvente;

d) termi “bashkëprodhim shumëpalësh” do të nënkuptojë një vepër kinematografike të prodhuar të paktën nga tre bashkëprodhues, siç përcaktohet në nenin 2, paragrafi 2, më lart.

KREU II RREGULLAT E ZBATUESHME PËR BASHKËPRODHIMET

Neni 4

Përfshirja në filmat vendës

1. Veprat kinematografike të prodhuara si bashkëprodhime shumëpalëshe dhe që janë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, do të gëzojnë përfitimet që u jepen filmave vendës nga dispozitat legislative dhe rregulluese në fuqi në secilën nga Palët e kësaj Konvente, që marrin pjesë në bashkëprodhimin në fjalë.

2. Përfitimet do të jepen për secilin bashkëprodhues nga Pala në vendin e të cilit është vendosur bashkëprodhuesi, sipas kushteve dhe kufizimeve të vendosura nga dispozitat legislative dhe rregulluese në fuqi në atë Palë dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 5

Kushtet për të përfituar statusin e bashkëprodhimit

1. Çdo bashkëprodhim i veprave kinematografike do t'i nënshtrohet miratimit të autoriteteve kompetente të Palëve, në vendet e të cilave janë vendosur bashkëprodhuesit, pas

këshillimit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në shtojcën I. Kjo shtojcë do të jetë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

2. Kërkesat për statusin e bashkëprodhimit do të paraqiten për miratim para autoriteteve kompetente, në përputhje me procedurën e aplikimit të përcaktuar në shtojcën I. Ky miratim do të jetë përfundimtar, përveç në rastin kur nuk mund të përmbushen sipërmarrjet fillestare në lidhje me çështjet artistike, financiare dhe teknike.

3. Projekteve të një natyre të qartë pornografike ose atyre që përkrahin diskriminimin, urrejtjen apo dhunën, nuk mund t'u jepet statusi i bashkëprodhimit.

4. Përfitimet e siguruar nga statusi i bashkëprodhimit do t'u jepen bashkëprodhuesve, të cilët vlerësohen se kanë mjetet e përshtatshme teknike e financiare dhe kualifikimet e mjaftueshme profesionale.

5. Secili Shtet Kontraktues do të përcaktojë autoritetet kompetente të përmendura në paragrafin 2 më lart, me anë të një deklarate të bërë në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton aktin e vet të ratifikimit, pranimit, miratimit apo hyrjes. Kjo deklaratë mund të ndryshohet në cilëndo datë të mëvonshme.

Neni 6

Pjesët e kontributeve nga secili bashkëprodhues

1. Në rastin e bashkëprodhimit shumëpalësh, kontributi minimal nuk mund të jetë më i ulët se 5% dhe kontributi maksimal nuk mund të kalojë 80% të kostos totale të prodhimit të veprës kinematografike. Kur kontributi minimal është më pak se 20% ose bashkëprodhimi është vetëm financiar, Pala e interesuar mund të ndërmarrë hapa për të reduktuar apo për të penguar hyrjen në skemat e mbështetjes së prodhimit vendës.

2. Kur kjo Konventë merr cilësinë e një marrëveshjeje dypalëshe ndërmjet dy Palëve, sipas dispozitave të nenit 2, paragrafi 4, kontributi minimal nuk mund të jetë më i vogël se 10% dhe kontributi maksimal nuk mund të kalojë 90% të kostos totale të prodhimit të veprës kinematografike. Kur kontributi minimal është më pak se 20% ose bashkëprodhimi është vetëm financiar, Pala e interesuar mund të ndërmarrë hapa



për të reduktuar ose penguar hyrjen në skemat e mbështetjes së prodhimit vendës.

Neni 7

Të drejtat e bashkëprodhuesve në veprën kinematografike

1. Kontrata e bashkëprodhimit duhet të garantojë për secilin bashkëprodhues pronësinë e përbashkët të të drejtave të pronësisë së preکشme dhe të paprekshme të filmit. Kontrata do të përfshijë dispozitën që shirit/negativi i filmit (versioni i parë i plotë) do të mbahet në një vend të pranuar reciprokisht nga bashkëprodhuesit dhe do t'u garantojë atyre hyrje të lirë në të.

2. Kontrata e bashkëprodhimit duhet, gjithashtu, t'i garantojë secilit bashkëprodhues të drejtën për të pasur akses në material dhe negativin e filmit për t'u përdorur si mjet duplikimi.

Neni 8

Pjesëmarrja teknike dhe artistike

1. Kontributi i secilit nga bashkëprodhuesit do të përfshijë pjesëmarrjen efektive teknike dhe artistike. Në parim dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, të cilave u nënshtrohen Palët, kontributi i bashkëprodhuesve në lidhje me personelin krijues, teknik e artistik, aktorët dhe mjediset, duhet të jenë në përpjesëtim me investimin e tyre.

2. Sipas detyrimeve ndërkombëtare, të cilave u nënshtrohen Palët dhe kërkesave të skenarit, ekipi teknik dhe mbështetës të përfshirë në filmimin e veprës, duhet të përbëhet nga shtetas të shteteve, të cilët janë partnerë në bashkëprodhim dhe faza e pasprodhimit do të zhvillohet normalisht në ato shtete.

Neni 9

Bashkëprodhimet financiare

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 8 dhe në bazë të kushteve dhe kufizimeve të hollësishme të përcaktuara në ligjet dhe rregulloret në fuqi në çdo Palë, bashkëprodhimet mund t'u jepet statusi i bashkëprodhimit, sipas dispozitave të kësaj Konvente, në rast se ato plotësojnë kushtet në vijim:

a) përfshijnë një apo më shumë kontribute të vogla, të cilat mund të jenë vetëm financiare, në

përputhje me kontratën e bashkëprodhimit, me kusht që çdo pjesë nga secili vend të mos jetë më pak se 10% dhe as më shumë se 25% e kostove të prodhimit;

b) përfshijnë një bashkëprodhues kryesor, i cili jep një kontribut efektiv teknik dhe artistik dhe përmbush kushtet për veprën kinematografike që të njihet si vepër kombëtare në vendin e tij ose të saj;

c) ndihmojnë që të nxitet diversiteti kulturor dhe dialogu ndërkulturor; dhe

d) përfshihen në kontrata bashkëprodhimi, të cilat përfshijnë dispozita për shpërndarjen e faturave.

2. Bashkëprodhimet financiare do të kualifikohen për statusin e bashkëprodhimit, vetëm pasi autoritetet kompetente të kenë dhënë miratimin e tyre në secilin rast individualisht, veçanërisht duke pasur parasysh dispozitat e nenit 10 më poshtë.

Neni 10

Ekulibri i përgjithshëm

1. Një ekuilibër i përgjithshëm duhet ruajtur në marrëdhëniet kinematografike të Palëve, si në lidhje me shumën e përgjithshme të investuar, edhe në lidhje me pjesëmarrjen teknike dhe artistike në veprat kinematografike të bashkëprodhuara.

2. Një Palë, e cila për një periudhë të arsyeshme kohe, vëren mangësi në marrëdhëniet e saj të bashkëprodhimit ndaj një apo më shumë Palëve të tjera, mund të mos japë miratimin e saj për një bashkëprodhim vijues, derisa të rivendosen marrëdhënie të ekuilibruara kinematografike në lidhje me atë apo ato Palë.

Neni 11

Hyrja dhe qëndrimi

Në përputhje me ligjet dhe rregulloret, si edhe me detyrimet ndërkombëtare në fuqi, secila palë do të lehtësojë hyrjen dhe qëndrimin, si edhe dhënien e lejeve të punës në territorin e saj, për personelin teknik dhe artistik nga Palët e tjera që marrin pjesë në një bashkëprodhim. Në mënyrë të ngjashme, secila Palë do të lejojë importimin e përkohshëm dhe rieksporimin e pajisjeve të nevojshme për prodhimin dhe shpërndarjen e veprave kinemato-



grafike, që janë brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente.

Neni 12

Atributet e vendeve bashkëprodhuese

1. Vendeve bashkëprodhuese do t'u jepen attribute në veprat e bashkëprodhuara kinematografike.

2. Emrat e këtyre vendeve do të përmenden qartë në titujt e attributeve në të gjitha materialet e publicitetit dhe të reklamës, si edhe kur shfaqen veprat kinematografike.

Neni 13

Eksporti

Kur një vepër kinematografike e bashkëprodhuar eksportohet në drejtim të një vendi, ku importi i veprave kinematografike u nënshtrohet kuotave dhe njëra nga Palët bashkëprodhuese, nuk gëzon të drejtën e hyrjes së lirë të veprave të saj kinematografike për në vendin importues:

a) vepra kinematografike do t'i shtohet normalisht kuotës së vendit që ka pjesëmarrjen më të madhe;

b) në rastin e një vepre kinematografike që përfshin një pjesëmarrje të barabartë nga vende të ndryshme, vepra kinematografike do t'i shtohet kuotës së vendit që ka mundësitë më të mira për të eksportuar në drejtim të vendit importues;

c) kur dispozitat e nënparagrafëve “a” dhe “b” më lart nuk mund të zbatohen, vepra kinematografike do të përfshihet në kuotën e Palës, e cila dërgon drejtuesin e saj.

Neni 14

Gjuhët

Kur është në përputhje me statusin e bashkëprodhimit, autoriteti kompetent i një Pale mund të kërkojë nga bashkëprodhuesi i përcaktuar atje, një version përfundimtar të veprës kinematografike në një nga gjuhët e asaj Pale.

Neni 15

Festivalet

Përveçse kur bashkëprodhuesit vendosin ndryshe, veprat kinematografike të bashkëprodhuara do të shfaqen në festivalet ndërkombëtare nga Pala ku është vendosur bashkëprodhuesi kryesor ose në rast të pjesëmarrjes së barabartë financiare, nga Pala e cila dërgon drejtuesin.

KREU III

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Efektet e Konventës

1. Kjo Konventë do të zëvendësojë, në lidhje me Shtetet Palë të saj, Konventën Evropiane për Bashkëprodhimin Kinematografik, e cila u hap për nënshkrim më 2 tetor 1992.

2. Në marrëdhëniet ndërmjet një Pale të kësaj Konvente dhe një Pale të Konventës së vitit 1992, e cila nuk e ka ratifikuar këtë Konventë, do të vazhdojë të zbatohet Konventa e vitit 1992.

Neni 17

Ndjekja e Konventës dhe ndryshimet në shtojcat I dhe II

1. Bordi i Menaxhimit të Fondit Mbështetës Evropian për Bashkëprodhimin dhe Shpërndarjen e Veprave Krijuese Kinematografike dhe Audiovizuale “Eurimages” do të jetë përgjegjës për ndjekjen e kësaj Konvente.

2. Çdo Palë e kësaj Konvente, e cila nuk është anëtare e “Eurimages” mund të përfaqësohet dhe të ketë një votë në Bordin e Menaxhimit të “Eurimages”, kur Bordi kryen detyrat që i janë caktuar nga kjo Konventë.

3. Me qëllim nxitjen e zbatimit efektiv të Konventës, Bordi i Menaxhimit të “Eurimages” mund të:

a) bëjë propozime për të lehtësuar shkëmbimin midis Palëve me përvojë dhe praktikë të mirë;

b) formulojë mendimin e tij për çdo çështje që lidhet me zbatimin dhe ekzekutimin e kësaj Konvente dhe të bëjë rekomandime specifike për Palët në këtë drejtim.



4. Me qëllim përditësimin e dispozitave të shtojcave I dhe II të kësaj Konvente, për të siguruar lidhjen e tyre të vazhdueshme me praktikën e zakonshme në industrinë kinematografike, mund të propozohen ndryshime nga çdo Palë, nga Komiteti i Ministrave ose nga Bordi i Menaxhimit të Fondit Mbështetës Evropian për Bashkëprodhimin dhe Shpërndarjen e Veprave Krijuese Kinematografike dhe Audiovizuale “Eurimages”. Ato do t’u komunikohen palëve nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.

5. Pas konsultimit me palët, Komiteti i Ministrave mund të miratojë një amendament të propozuar, në përputhje me paragrafin 4 nga shumica e parashikuar në nenin 20(d) të Statutit të Këshillit të Evropës. Amendamenti do të hyjë në fuqi pas skadimit të një periudhe prej një viti pas datës kur u është dërguar Palëve. Gjatë kësaj periudhe, çdo Palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm për çdo kundërshtim për hyrjen në fuqi të amendamentit në lidhje me të.

6. Nëse një e treta e Palëve njofton Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për një kundërshtim për hyrjen në fuqi të amendamentit, ky i fundit nuk hyn në fuqi.

7. Nëse më pak se një e treta e Palëve njoftojnë një kundërshtim, amendamenti do të hyjë në fuqi për ato Palë që nuk kanë njoftuar kundërshtimin.

8. Sapo një ndryshim të ketë hyrë në fuqi, në përputhje me paragrafët 5 dhe 7 të këtij neni dhe një Palë ka njoftuar një kundërshtim ndaj tij, ky ndryshim do të hyjë në fuqi në lidhje me Palën e interesuar në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën Pala ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës për pranimin e saj të amendamentit. Pala që ka bërë një kundërshtim, mund ta tërheqë atë në çdo kohë, duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

9. Nëse Komiteti i Ministrave miraton një amendament, një shtet ose Bashkimi Evropian mund të mos shprehë pëlqimin e tij për t’u detyruar ligjërisht nga Konventa, pa pranuar në të njëjtën kohë ndryshimin.

Neni 18

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe Shtetet e tjera Palë të Konventës

Kulturore Evropiane, të cilat mund të shprehin pëlqimin e tyre për t’u detyruar ligjërisht, nga:

a) nënshkrimi pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose

b) nënshkrimi që u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

Neni 19

Hyrja në fuqi

1. Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tri Shtetet, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t’u nënshtuar Konventës, në përputhje me dispozitat e nenit 18.

2. Në lidhje me cilindo Shtet nënshkrues që më pas shpreh pëlqimin e tij për t’u nënshtuar asaj, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të periudhës tre mujore, pas datës së nënshkrimit ose depozitimit të aktit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 20

Hyrja e shteteve joanëtare

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës, pas konsultimit të Palëve, mund të ftojë çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Evropës, si dhe Bashkimit Evropian, për t’u bërë anëtar në këtë Konventë, me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20(d), të Statutit të Këshillit të Evropës dhe nga vota unanime e përfaqësuesve të Shteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të jenë pjesë e Këshillit të Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues ose të Bashkimit Evropian, në rast të pranimit të tij, kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit, në vijim të mbarimit të periudhës tremujore, pas datës së depozitimit të aktit të pranimit me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.



Neni 21

Dispozita territoriale

1. Që në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton aktin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit ose hyrjes, çdo shtet mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat do të zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Palë, në një datë të mëvonshme, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, mund të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në këtë deklaratë. Në lidhje me këtë territor, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit, pas përfundimit të afatit prej tre muajsh nga data e marrjes së një deklarate të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në dy paragrafët e mësipërm, në lidhje me çdo territor të përcaktuar në një deklaratë të tillë, mund të tërhiqet nga një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të përfundimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 22

Rezervat

1. Cilido shtet, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton aktin e tij të ratifikimit, pranimi, miratimit apo hyrjes mund të deklarojë se neni 2, paragrafi 4, nuk zbatohet për marrëdhëniet e tij dypalëshe të bashkëprodhimit me një apo më shumë Palë. Gjithashtu, ai mund të rezervojë të drejtën për të caktuar një pjesëmarrje maksimale të ndryshme nga ajo që përcaktohet në nenin 9, paragrafi 1(a). Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Cilado Palë që ka bërë një rezervë, sipas paragrafit pararendës mund ta tërheqë atë pjesërisht apo tërësisht me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Tërheqja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së një njoftimi të tillë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 23

Denoncimi

1. Cilado Palë mund ta denoncojë këtë Konventë në çdo kohë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit në vijim të mbarimit të një periudhe prej gjashtë muajsh, pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 24

Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe Bashkimin Evropian apo çdo shtet që është bërë pjesë e kësaj Konvente ose është ftuar ta bëjë këtë, për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitim të çdo akti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 19, 20 dhe 21;
- d) çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës të bërë në përputhje me nenin 22;
- e) çdo deklaratë të bërë në përputhje me nenin 5, paragrafi 5;
- f) çdo denoncim të njoftuar, në përputhje me nenin 23;
- g) çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në [Rotterdam], në ditën e [30] të [janarit 2017], në anglisht dhe frëngjisht, në dyja tekste njëloj autentike, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të përcjellë kopje të vërtetuara në shtetet e përmendura në nenin 18, paragrafi 1, si dhe në Bashkimin Evropian dhe çdo shtet që është ftuar të bëhet pjesë e kësaj Konvente.



SHTOJCA I PROCEDURA E APLIKIMIT

Për të përfutur nga dispozitat e kësaj Konvente, bashkëprodhuesit e vendosur në vendet Palë, në kohën e duhur përpara fillimit të fotografimit të parë ose animacionit të parë, duhet të paraqesin një kërkesë për statusin e bashkëprodhimit dhe të bashkëlidhin dokumentet e renditura më poshtë. Këto dokumente duhet të arrijnë tek autoritetet kompetente në numër të mjaftueshëm kopjesh për t'iu shpërndarë autoriteteve të Palëve të tjera jo më vonë se një muaj para fillimit të xhirimeve:

- deklaratë të situatës së të drejtës së autorëve;
- një përmbledhje e filmit;
- një listë të përkohshme të kontributeve teknike dhe artistike të secilit prej vendeve të përfshira;
- një buxhet dhe një plan financimi të përkohshëm;
- një program prodhimi të përkohshëm;
- kontratën e bashkëprodhimit ose një formë të shkurtër marrëveshjeje ("marrëveshje memo") të lidhur ndërmjet bashkëprodhuesve. Ky dokument duhet të përfshijë klauzola që parashikojnë shpërndarjen e faturave ose territoreve ndërmjet bashkëprodhuesve.

Statusi përfundimtar i bashkëprodhimit jepet me përfundimin e filmit dhe pas shqyrtimit të dokumenteve prodhuese përfundimtare të mëposhtme nga autoritetet kombëtare:

- një zinxhir të plotë të titullit;
- një skenar përfundimtar;
- një listë përfundimtare të kontributeve teknike dhe artistike nga secili prej vendeve të përfshira;
- një raport të koston përfundimtare;

- një plan financiar përfundimtar;
- kontrata e bashkëprodhimit e lidhur ndërmjet bashkëprodhuesve. Kjo kontratë duhet të përfshijë klauzola që parashikojnë shpërndarjen e faturave ose të territoreve midis bashkëprodhuesve.

Autoritetet kombëtare mund të kërkojnë çdo dokument tjetër të nevojshëm për vlerësimin e aplikimit, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Aplikimi dhe dokumentet e tjera duhet të paraqiten, nëse është e mundur, në gjuhën e autoriteteve kompetente ku janë dorëzuar.

Autoritetet kompetente kombëtare do t'i dërgojnë njëra-tjetrës aplikimin dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, pas marrjes së tyre. Autoriteti kompetent i Palës me pjesëmarrjen financiare më të ulët, nuk do të japë miratimin e vet derisa të merret mendimi i Palës me pjesëmarrjen financiare më të lartë.

SHTOJCA II PËRCAKTIMI I PROCESIT TË KUALIFIKIMIT TË NJË VEPRE KINEMATOGRAFIKE

1. Një vepër kinematografike krijuese kualifikohet si bashkëprodhim zyrtar në kuptim të nenit 3, nënparagrafi "c", nëse në lidhje me elementet që vijnë nga Shtetet Palë të Konventës, fiton të paktën 16 pikë nga një total i mundshëm prej 21 pikësh, sipas listës së elementeve të paraqitura më poshtë.

2. Duke pasur parasysh karakteristikat e bashkëprodhimit, pas konsultimit me njëra-tjetrën, autoritetet kompetente mund, t'i japin statusin e bashkëprodhimit një vepre me numër pikësh që është më pak se 16 pikët e kërkuara normalisht.



Elementet me origjinë nga Shtetet Palë të Konventës	Pikët e ponderuara
Drejtor	4
Skenarist	3
Kompozitor	1
Roli i parë	3
Roli dytësor	2
Roli i tretë	1
Shefi i Departamentit – Kinematografi	1
Shefi i Departamentit – Zëri	1
Shefi i Departamentit – Montimi i fotografive	1
Shefi i Departamentit – Prodhimi ose disenjimi i kostumeve	1
Studioja ose vendi i xhirimit	1
Efektet vizuale (VFX) ose vendndodhja e imazheve të gjeneruara nga kompjuteri (CGI)	1
Vendi i pasprodhimit	1
	21
Shënim	
Roli i parë, i dytë dhe i tretë përcaktohen nga numri i ditëve të punës.	

3. Një vepër e animuar kinematografike kualifikohet si bashkëprodhim zyrtar në kuptim të nenit 3, nënparagrafi c, nëse fiton të paktën 15 pikë nga një total i mundshëm prej 23 pikësh, sipas listës së elementeve të paraqitura më poshtë.

4. Duke pasur parasysh karakteristikat e bashkëprodhimit, pas konsultimit me njëra-tjetrën, autoritetet kompetente mund, t'i japin statusin e bashkëprodhimit një vepre me numër pikësh që është më pak se 15 pikët e kërkuara normalisht.

Elementet me origjinë nga Shtetet Palë të Konventës	Pikët e ponderuara
Konceptimi	1
Skenari	2
Disenjimi i karakterit	2
Përbërja muzikore	1
Regjatura	2
Përmbledhja	2
Dekoratori kryesor	1
Sfondet kompjuterike	1
Plan (2D) ose plan dhe blloqe kamerash (3D)	2
75% e shpenzimeve për animacion në Shtetet Palë të Konventës	3
75% e pastrimit, ndërmjetësimit dhe ngjyrosjes në Shtetet Palë të Konventës (2D) ose	
75% e ngjyrosjes, ndriçimit, pajisjeve, modelimit dhe strukturimit në Shtetet Palë të Konventës (3D)	3
Kompozimi ose kamera	1
Redaktimi	1
Zëri	1
	23

5. Një vepër kinematografike dokumentar kualifikohet si bashkëprodhim zyrtar në kuptim të nenit 3, nënparagrafi “c”, nëse fiton të paktën 50% të totalit të pikëve të aplikueshme, sipas listës së elementeve të paraqitura më poshtë.

6. Duke marrë parasysh karakteristikat e bashkëprodhimit, pas konsultimit me njëri-tjetrin, autoritetet kompetente mund t'i japin statusin e bashkëprodhimit një vepre me më pak se 50% të pikëve të kërkuara normalisht nga pikat totale të aplikueshme.



Elementet me origjinë nga Shtetet Palë të Konventës	Pikët e ponderuara
Drejtori	4
Skenaristi	1
Kamera	2
Redaktori	2
Hulumtuesi/kërkuesi	1
Kompozitori	1
Zëri	1
Vendi i xhirimit	1
Vendi i pasprodhimit	2
Efektet vizuale (VFX) ose vendndodhja e imazheve të gjeneruara nga kompjuteri (CGI)	1
	16

DEKRET**Nr. 13319, datë 10.11.2021****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 109/2021 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Bashkëprodhimin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.1.2017”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 13310, datë 8.11.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020 “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Zdrafko Branko Brajović (Stefoja)
2. Eduard Muharem Peposhi

Faqe | 15704

3. Redi Behari Çumanaj

4. Alfio Refat Shkreta

5. Elkjer Bujar Shakaj

6. Fatjon Beqir Loka

7. Stela Jorgo Kalavace

8. Erion Kastriot Kanani

9. Drazhan Miter Rajçeviq

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 670, datë 10.11.2021**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.
1140, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRATEGJISË KUNDËR KRIMIT TË
ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË
RËNDA 2021–2025 DHE PLANIN E
VEPRIMIT 2021–2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1140, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet shtojca 1, me titull “Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër



Trafikimit të Personave 2021–2023”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT
PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË
PERSONAVE
2021–2023

TABELA E PËRMBAJTJES
SHKURTIMET

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi

2. Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

2.1 Konteksti i përgjithshëm

2.2 Kuadri ligjor

2.3 Kuadri institucional

3. Vizioni dhe parimet e përgjithshme

3.1 Vizioni

3.2 Parimet

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE
OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT
STRATEGJIK

2.1 Qëllimi i politikave të PKV-së

2.1.1 Qëllimi i politikës 1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

2.1.2 Qëllimi i politikës II. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

2.1.3 Qëllimi i politikës III. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E
INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA,
RAPORTIMI DHE MONITORIMI

III.1 Zbatimi i PKV-së antitrafikim

III.2 Monitorimi dhe raportimi

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE

Aneks 1. Tabela e PKV-së antitrafikim

SHKURTIMET

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AP	Autoriteti përgjegjës
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DSHSB	Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashki
DVKM	Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin
DRSHSSH	Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnim në Hetimet Penale
ICMPD	Qendra Ndërkombëtare për Zhvillimin e Politikave të Migrimin
KB/UN	Kombet e Bashkuara
KK	Koordinatori Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave
KRAT	Komitetet Rajonale Antitrafikim
KSH	Komiteti Shtetëror
KKSAT	Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafikim
MB	Ministria e Brendshme
MKR	Marrëveshja për Mekanizmin Kombëtar të Referimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë



MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MKR	Mekanizmi i referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel lokal
MMDHF	Mekanizmi i Mbrojtjes ndaj Dhunës së Fëmijëve
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NJL	Njësi lëvizëse
OJF	Organizata jofitimprurëse
ON	Organizata ndërkombëtare
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve
PSV	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi
SPZ	Specialisti i policisë së zonës
TQNJ	Trafiku i qenieve njerëzore
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat
VT	Viktimë trafikimi
VMT	Viktimë e mundshme trafikimi
ZKKA	Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave

PJESA I. KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023 është një instrument që synon koordinimin e aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë, përfshirë organizatat ndërkombëtare, të angazhuar në luftën kundër trafikimit të personave. PKV-ja bazohet në planin e mëparshëm, që mbulonte periudhën 2018–2020, si dhe në Raportin e Monitorimit për zbatimin e PKV 2018–2020, i cili ofron një analizë të detajuar të nivelit të realizimit të masave të parashikuara, fazën në të cilën ndodhet zbatimi i tyre, si edhe rekomandime dhe sugjerime për periudhën vijuese. Rekomandimet e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në lidhje me situatën e trafikimit të personave janë përfshirë për sa është e mundur dhe e realizueshme përgjatë periudhës 2021–2023.

Ky dokument reflekton edhe praktikën më të mira ndërkombëtare, si dhe situatën e kohëve të fundit që lidhet me pandeminë, për sa u përket faktorëve nxitës të trafikimit dhe formave të shfaqjes së tij, duke qenë se trafikimi i qenieve njerëzore përfshin si vendet fqinje dhe vendet anëtare të BE-së dhe ka tipare të ngjashme në të gjitha vendet pavarësisht diferencave që ato kanë nga pikëpamja sociale, ekonomike dhe kulturore.

Trafikimi i personave në Shqipëri mbetet ende një fenomen shqetësues, i cili mund të trajtohet

vetëm në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ku do të përfshihet një gamë e gjerë e aktorëve

Plani i Veprimit përbën dokumentin më të rëndësishëm politik dhe strategjik të vendit në fushën antitrafikim. Ky dokument është vazhdim i përpjekjeve dhe objektivave antitrafikim të parashikuara në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020, por të përshtatura me dinamikën e trafikimit, vizionin e ri qeverisës në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit për të krijuar një platformë të mirë orientuar synimesh e objektivash strategjike në përputhje me dokumentet e tjera strategjike kombëtare, si dhe rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë.

Po ashtu, miratimi i këtij dokumenti është një nga masat e parashikuara në Planin Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) në kuadër të angazhimeve të Ministrisë së Brendshme, si në nivel kombëtar, ashtu dhe në atë ndërkombëtar.

Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020 ishte një plan gjithëpërfshirës me 143 masa konkrete dhe aktorë të identifikuar dhe ngarkuar me detyra konkrete për zbatimin e tij. Sipas vlerësimeve të Raportit të Monitorimit për zbatimin e PKV 2018–2020, ka rezultuar se janë realizuar plotësisht 125



masa që përfaqësojnë 87.4%, janë pjesërisht të realizuara dhe në proces 8 masa që përfaqësojnë 5.6%, ndërkohë që 10 masa janë të paralizuar që zënë 7%.

PKV 2021–2023, i cili bazohet ngushtësisht mbi raportin e monitorimit, përfshin masat e paralizuar dhe ato të realizuara pjesërisht, si edhe përfshin masa të cilat janë raportuar të realizuara, por që konsistojnë në objektiva e veprimtarisë të cilat janë aktuale në çdo kohë, të tilla si: ndërgjegjësimi, ngritja e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë, bashkërendimi i ndërhyrjeve dhe financimi i tyre i përshtatshëm.

Me qëllimin e hartimit të një plani gjithëpërfshirës, aktual, të realizueshëm dhe konform detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka edhe në planin ndërkombëtar, janë analizuar dhe marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të organizatave ndërkombëtare për sa i përket situatës së trafikimit të personave në Shqipëri dhe, konkretisht: Progresraporti i BE-së, Këshilli i Evropës (GRETA) dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drogat.

PKV-ja, së bashku me objektivat specifike dhe masat, reflektojnë për sa është e mundur edhe zhvillimet në nivelin evropian lidhur me zbatimin e direktivave antitrafik dhe paralajmërimit të Europol, për sa i përket efektit të situatës së pandemisë në rritjen e mundshme të rrezikut për shfrytëzim seksual dhe në punë.

2. Konteksti i reformës dhe kuadri ligjor dhe institucional

2.1 Konteksti i përgjithshëm

Synimi strategjik i këtij dokumenti është realizimi i një sistemi të integruar të adresimit të të gjitha hallkave dhe elementeve që lidhen me trafikimin e personave dhe pasojat e tij, i cili bazohet në ndërveprimin efektiv institucional, brenda e jashtë vendit dhe bashkërendimin e veprimtarive. Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe nënligjor, si dhe një bazë të konsiderueshme dokumentesh strategjike, që adresojnë çështjet e krimit të organizuar. Një nga prioritetet kryesore në Programin e Qeverisë Shqiptare dhe prioritetet e Ministrisë së Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, duke parashikuar këtu luftën kundër krimit të organizuar e trafikëve të paligjshme.

Sikurse parashikohet dhe në Strategjinë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–

2025 vlerësohet i domosdoshëm miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021–2023, duke qenë se trafikimi i personave:

- është një fenomen kompleks, që shkon përtej luftës kundër krimit të organizuar dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e të drejtave të njeriut;

- është një fenomen që kërkon një qasje të fokusuar, gjithëpërfshirëse, më të gjerë se forcimi i aspekteve të hetimit dhe ndjekjes penale;

- kërkon garanci parandaluese dhe partneritet, mbrojtje dhe asistencë për viktimat e trafikimit, garanci që i jep një përjasje specifike, të veçantë dhe multidimensionale.

Plani Kombëtar i Veprimit bazohet në një analizë të përgjithshme mbi situatën aktuale të trafikimit në Shqipëri që identifikon faktorët determinues që qëndrojnë në themel të trafikimit, si dhe grupet më të prekura të shoqërisë, si: gratë/vajzat, fëmijët dhe komunitetet etnike romë dhe egjiptiane. Krahës renditjes së disa prej arritjeve më të rëndësishme gjatë periudhës 2018–2020, në Planin e Veprimit identifikohen si fusha që synohet të përmirësohen gjatë zbatimit të këtij plani:

- garantimi i përputhjes së legjislacionit kombëtar penal dhe procedural penal mbi trafikimin e personave me standardet evropiane dhe ndërkombëtare;

- forcimi i mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale (qasja, aksesimi në drejtësi);

- përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtëm të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, në drejtëm të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit;

- sigurimi i identifikimit fillestar dhe referimeve për mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve si viktimat/viktima të mundshme trafikimi për qëllime shfrytëzimi dhe referimi i menjëhershëm i tyre pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të);

- garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të;



- garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit (fëmijë dhe të rritur në qendra ose jashtë, përfshirë asistencë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të standardeve kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve;

- nxitja e kthimit dhe riintegrit, si dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar, rritur ose që të kthehen në trafikues;

- përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit;

- rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët etj.), si dhe pasojat e tij;

- forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar;

- bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe, veçanërisht, me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Sistemit të Integruar të Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel qendror dhe lokal;

- përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e personave, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik;

- sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

PKV-ja bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025, për të adresuar këto qëllime të politikës:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, me objektiv specifik 1.2 “Goditja e trafikeve të paligjshme”;

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë, me objektiva specifikë 2.1 “Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'u nënshtruar shtrengimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar” dhe 2.2 “Rritja e profesionalizmit”;

3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, me objektiv specifik 3.1 “Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar” dhe 3.2 “Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël”.

2.2 Kuadri ligjor

Kuadri ligjor që adreson, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, luftën kundër trafikimit të personave, përfshin:

1. *Legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë:*

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;

- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve për sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale;

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe Protokolli shtesë i Konventës për të Drejtat e Fëmijës për Shitjen e Fëmijës, Prostitucionin e Fëmijës dhe Pornografinë e Fëmijës;

- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;

- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli shtesë mbi parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve”;

- Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional/ “Protokolli kundër Kontrabandimit të Emigrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrore dhe Detare”;

- Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW;

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;

- Konventa evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”;

- Konventa e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin



dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për ligjin e zbatueshëm për detyrimet ushqimore”;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve në lidhje me detyrimet ushqimore”;

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimeve seksuale”;

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesës”;

- Konventa e Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”;

- Konventa e Konferencës së Hagës “Për rivendosjen ndërkombëtare të detyrimit ushqimor ndaj fëmijëve dhe formave të tjera të mbështetjes për anëtarët e tjerë të familjes” (miratuar në parim, nga Këshilli i Ministrave, në mbledhjen e datës 26.5.2011);

- Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore;

- konventat e ILO-s nr. 29 “Për punën e detyrueshme”, 138 “Mosha minimale për pranimin në punë” dhe 182 “Për ndalimin dhe veprimet e menjëhershme për eliminimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve”.

Legjislacionin shqiptar:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Kodi Penal, neni 110/a “Trafikimi i të rriturve”, neni 128/b “Trafikimi i të miturve”, neni 298 “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”, neni 117 “Pornografia” dhe Kodi i Procedurës Penale, të ndryshuar;

- ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;

- ligji nr. 108/2014, “Për policinë e shtetit”, i ndryshuar;

- ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”;

- ligji nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”;

- ligji nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”;

- ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar;

- ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar;

- ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit përmes masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;

- ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike”;

- ligji nr. 98/2017, “Për tarifatat gjyqësore në RSH”;

- ligji nr. 37/2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”;

- ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;

- ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;

- ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

- ligji nr. 10 383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

- vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1140, datë 24.12.2020, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2022”;

- vendimi nr. 195, datë 11.4.2007, i Këshillit të Ministrave, “Standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi në qendrat rezidenciale”;

- vendimi nr. 933, datë 2.7.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përfaqësimin e Ministrisë së Brendshme me oficerë kontakti në Britaninë e Madhe, Belgjikë, Itali, Greqi, Turqi, Kosovë dhe Europol”, i ndryshuar;

- udhëzimi i përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014, “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;

- urdhri nr. 805, datë 1.8. 2017, i ministrit të Brendshëm, “Për forcimin e kontrollit të shtetasve shqiptarë që kalojnë kufirin shtetëror”;

- memorandum i mirëkuptimit, i Ministrisë së Brendshme, i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe i Prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë në Shqipëri (OSCE) “Për promovimin dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual në Turizëm” (nënshkruar në vitin 2007);



- marrëveshja e bashkëpunimit për funksionimin e mekanizmit kombëtar të referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave (MKR), datë 15 qershor, 2012.

Plani i Veprimit angazhon me detyrime një numër të gjerë institucionesh dhe agjencish shtetërore dhe joshtetërore, duke përcaktuar përgjegjësitë, detyrimet dhe kontributin e secilës prej tyre në parandalimin e trafikimit të personave dhe garantimin e një mbrojtjeje gjithëpërfshirëse për viktimat e trafikimit. PKV-ja ruan frymën e një bashkëveprimi të ndërsjellë të krijuar tashmë ndërmjet të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërore dhe synon forcimin e këtij bashkëpunimi dhe institucionalizimin e tij nëpërmjet aplikimit të një politike të hapur, proaktive dhe gjithëpërfshirëse. Një pjesë e mirë e aktiviteteve të nisura gjatë zbatimit të PKV 2018–2020, parashikohen të konsolidohen dhe fuqizohen më tej në Planin e Veprimit 2021–2023. Shembujt dhe praktikat e mira janë shprehur në aktivitete konkrete dhe të matshme.

2.3 Kuadri institucional

Sipas VKM-së nr. 604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, MB-ja është autoriteti kryesor shtetëror përgjegjës që bashkërendon punën për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe riintegrimin e tyre.

Zbatimi i këtij plani veprimi bazohet në bashkëpunimin e shumë aktorëve shtetërorë ku rol më të spikatur ka Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë dhe përfshin një listë të gjerë aktorësh të tjerë shtetërorë, si dhe është planifikuar të realizohet në bashkëpunim dhe me aktorë joshtetërorë, që përfshin organizatat ndërkombëtare dhe organizata jofitimprurëse që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e antitrafikimit dhe adresimit të faktorëve nxitës të tij.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, që janë përgjegjëse dhe/ose bashkëpunojnë me Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit dhe për të shkëmbyer informacion, janë:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve;
- Shërbimi Social Shtetëror;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- komitetet rajonale antitrafikim;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

3. Vizioni dhe parimet e përgjithshme

3.1 Vizioni

Përgjatë gjithë dokumentit strategjik përçohet vizioni, se trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses vetëm nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të grupeve dhe personave në nevojë, zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe fuqizimit të shërbimeve dhe kapaciteteve në ndihmë të personave të trafikuar, qofshin këta viktimat apo viktimat të mundshme të trafikimit. Gjithashtu, ngritja e mekanizmave bashkërendues, duke filluar nga niveli bazë do të mundësonte qëllimin përfundimtar të çdo nisme antitrafik, që është identifikimi i çdo viktime trafikimi për t'i dhënë ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për një riintegrim efektiv dhe të qëndrueshëm në shoqëri.

PKV-ja bazohet në vizionin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda dhe, në veçanti, synon të sigurojë që *qeveria shqiptare dhe të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë janë të angazhuar dhe përkushtuar për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e personave dhe për të siguruar mbrojtjen e individëve dhe grupeve vulnerabël nga trafikimi, marrjen e masave efektive ligjore ndaj autorëve të krimit të trafikimit të personave, si dhe mbrojtjen e respektimit të të drejtave të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe, veçanërisht, fëmijëve e grave.*

Ky vizion është në përputhje dhe me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim “*Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar*



dhe kërcënime terrorizmi, dhe me imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”, në lidhje me objektivat e parashikuara për krijimin e një mjedisi të sigurt për shoqërinë, uljes së trafikimit të paligjshëm dhenë veçanti, e trafikimit të qenieve njerëzore nga/përmes Shqipërisë, si dhe krijimin e një shërbimi hetimor bashkëkohor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal.

Misioni i PKV-së është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndër-institucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen së shoqërisë civile dhe komunitetit.

3.2 Parimet

Ky plan veprimi mbështetet në parimet e mëposhtme:

Përgjegjësia shtetërore: shteti ka përgjegjësi të marrë masa për të reaguar dhe përgjigjur ndaj situatës së trafikimit në kohë, me efektivitet, në mënyrë gjithëpërfshirëse, të koordinuar dhe në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Respektimi i të drejtave të njeriut është konsideratë parësore: të drejtat e personave të trafikuar duhet të jenë në qendër të të gjitha përpjekjeve për të parandaluar e luftuar trafikimin dhe për të mbrojtur viktimat. Masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht te të drejtat e njeriut dhe dinjiteti i personave dhe veçanërisht te viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit.

Sigurimi i mbështetjes efektive të viktimave të trafikut/viktimave të mundshme të trafikut: mbështetja e viktimave dhe të mbijetuarve të trafikimit bazohet në një qasje holistike, të ndjeshme nga pikëpamja gjinore, të përshtatur nga pikëpamja kulture, që ka në qendër viktimat dhe konsideron efektet e traumës.

PJESA II. QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT E VEÇANTË TË KUADRIT STRATEGJIK

2.1 Qëllimi i politikave të PKV-ë

PKV-ja bazohet dhe del në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 dhe për më shumë reflekton gjetjet dhe rekomandimet e Raportit Global të vitit 2021 të Departamentit Amerikan të Shtetit për

Trafikimin e Personave⁵. Ky raport edhe pse vlerëson përpjekjet e shtuara të ndërmarra nga vendi ynë në luftën kundër trafikimit të personave vë në dukje se nuk janë arritur standardet minimale për eliminimin e trafikimit në disa fusha kyçe si ndjekja penale, mbrojtja e VT/VMT, parandalimi dhe profilizimi i trafikimit.

Bazuar në këto gjetje, prioritizimet e rekomanduara në raport, si dhe në një qasje shumëdimensionale dhe të koordinuar, fushat kryesore të këtij plani kombëtar veprimi, janë:

1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda nëpërmjet ndryshimeve të legjislacionit penal dhe adoptimit të një ligji të veçantë kundër trafikimit dhe për mbrojtjen e VT/VMT, duke përafuar dhe legjislacion të BE-së në këtë fushë. Për më shumë realizimi i këtij objekti do të mbështetet nga veprimtari trajnuese të strukturave ligjzbatuese, veprimtari koordinuese mes tyre për kryerjen efektive të hetimeve dhe veprimtari monitoruese. Një rëndësi i është kushtuar trajnimit të strukturave të vijës së parë me qëllim identifikimin proaktiv të viktimave.

2. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat dhe format e disponueshme të mbështetjes së VT/VMT, trajnimit të profesionistëve dhe strukturave mbështetëse për mbrojtjen sociale dhe riintegrimin e qëndrueshëm të tyre në shoqëri. Mbrojtja e viktimave është bazuar në një qasje që ka në qendër viktimën dhe garanton mbrojtjen e përshtatshme të tyre nëpërmjet ndihmës juridike, psikologjike me një fokus të veçantë në shëndetin mendor, kujdesit shoqëror dhe riintegrimin ekonomik. Për më shumë, shkëmbimi efektiv i informacioneve dhe përditësimi i bazës së të dhënave, do të kontribuojnë në profilizimin e VT/VMT dhe organizimin efektiv dhe të fokusuar të burimeve dhe mbështetjes ndaj VT/VMT.

3. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Ky objektiv mbështetet nga masa që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit qytetar dhe ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë në komunitet, rritjen e besimit dhe bashkëpunimit të tyre me institucionet

⁵<https://www.state.gov/reports/2021-trafficking-in-persons-report/albania/>



përgjegjëse në përgjigje të përpjekjeve për identifikimin dhe parandalimin e faktorëve nxitës të trafikimit.

2.1.1 Qëllimi i politikës 1. Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Treguesit kryesorë i rezultatit për këtë qëllim politik është:

- Raporti i numrit të çështjeve për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore të referuara në prokurori dhe gjykatë përkundrejt atyre të evidentuara nga policia e shtetit.

Objekti i specifik 1.1. Goditja e trafikeve të paligjshme

Masat në lidhje me këtë objekt, janë:

1.1.1 Ndryshimi i Kodit Penal në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të RSH-së dhe rekomandimet (finalizimi i miratimit të ndryshimeve ligjore për nenet 124 /b, 128/b për të parashikuar shfrytëzimin ekonomik dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve, edhe në kuadër të PKV-së për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019–2021), 52/a, 110/a, 114 (2) të Kodit Penal), si edhe ndryshimi për trafikimin e organeve njerëzore (sipas Konventës së Këshillit të Evropës).

1.1.2 Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”: ngritja e grupit të punës; sigurimi i ekspertizës për draftimin e ligjit; konsultimi publik.

1.1.3 Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika speciale të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e hetimeve financiare në kuadër të veprave të trafikimit, për të zbatuar sanksione proporcionale dhe shkatërruese dhe për të siguruar që kohëzgjatja e procedurave gjyqësore të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe standardet e përcaktuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

1.1.4 Trajnimi i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve

të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve, përfshirë stafin mjekësor për rritjen e kapaciteteve për identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe, veçanërisht, fëmijëve të pashoqëruar, pavarësisht aftësisë dhe/ose gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar, sidomos në situata emergjente, si në rastin e COVID-19.

1.1.5 Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit “Shqiponja” dhe strukturave të tjera përgjegjëse për identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit për të rritur dhe fëmijë, si dhe bashkëpunimin ndërsektorial.

1.1.6 Monitorimi dhe identifikimi i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe inkurajimi i publikut për raportimin e zyrtarëve të korruptuar.

1.1.7 Forcimi i bashkërendimit në hetimet financiare me qëllim identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta për rritjen e numrit të procedimeve penale të suksesshme.

1.1.8 Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim, DPPSH-ja, ISHPSHSH-ja dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

1.1.9 Krijimi i një praktike të re koordinimi për shkëmbim informacioni periodik lidhur me evidentimin dhe referimin e çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore.

Treguesit në nivel masash:

- Kodi Penal, i ndryshuar;
- ligji i veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT i miratuar;
- numri i strukturave gjyqësore të trajnuar për veprat penale të trafikimit, ndarë sipas çështjeve të trajtimeve;
- numri i viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar nga DK&M;
- numri i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor që kane njohuri mbi identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar;



- numri i përfituesve të trajnimeve mbi identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial, Ndarja sipas pozicioneve: punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë; repartit “Shqiponja; struktura të tjera përgjegjëse.

- numri i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore të proceduar;

- numri i operacioneve identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe hetimeve financiare të përbashkëta të kryera;

- marrëveshja e rishikuar dhe aprovuar;

- numri i rasteve të identifikuara në lidhje me shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të përbashkëta mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH-ja, ISHPSHSH-ja;

- praktika e re e koordinimit funksionale.

2.1.2 Qëllimi i politikës II. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë

Treguesit kryesorë të rezultatit për këtë qëllim politik, janë:

- numri i shërbimeve të nevojshme bazë të ofruara për riintegrimin e personave të trafikuar/ rrezik trafikimi (shërbime: psikologjike, ligjore, akses në arsim/formim profesional, shërbime shëndetësore etj.) për periudhën 2021–2023;

- numri i viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuara deri në fund të vitit 2023.

Objektivi specifik 2.1. Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar

Masat në lidhje me këtë objektivi janë:

2.1.1 Informimi i VT/VMT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit

2.1.2 Ndërmarrja e hapave përkatës për garantimin e mbrojtjes së posaçme dhe efektive si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për VT/VMT, dëshmitarët dhe anëtarët e familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga hakmarrja dhe kërcënimi i mundshëm gjatë të gjitha fazave të procedimit penal duke inkurajuar rritjen e bashkëpunimit të personave të trafikuar me

institucionet e zbatimit të ligjit dhe, duke aplikuar një qasje të orientuar te mbrojtja e VT/VMT;

2.1.3 Raportimi efektiv dhe periodik i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT, me qëllim përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale kur janë në kushtet e mbrojtjes nga ligji, analizimin e tyre dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve të drejtësisë;

2.1.4 Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT për sa u përket kompetencave të profesionistëve të përfshirë dhe mjedisit në të cilin zhvillohen intervistat, që të jetë i përshtatur e miqësor, si dhe aplikimin e mjeteve audiovizive me qëllim evitimin e intervistimit të përsëritur, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre;

2.1.5 Hartimi i broshurave orientuese për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat joanëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve;

2.1.6 Parandalimi/identifikimi i trafikimit të VT/VMT të mitur në kufi (përfshirë kalimin e paligjshëm të kufirit nga fëmijët), vetëm ose të shoqëruar me të rritur nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët;

2.1.7 Rishikimi i MKR-së, me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar

2.1.8 Organizimi i takimeve periodike të anëtarëve të MKR-së;

2.1.9 Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të VT/VMT për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve nga autoriteti përgjegjës, si dhe raportimi periodik pranë MKR-së;

2.1.10 Rishikimi i udhëzimit të AP-së; përfshirja në AP e përfaqësuesve nga ISHPSHSH/ AKPA/ AMSHDF; krijimi i grupit të punës organizimi i takimeve; udhëzimi i rishikuar;

2.1.11 Informimi i përshtatshëm i VT/VMT (veçanërisht për fëmijët, duke përdorur një gjuhë sa më miqësore) në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre, me qëllim marrjen e vendimeve të informuara nga ana e VT/VMT, si edhe informimi i vazhdueshëm i VT/VMT;

2.2.12 Informimi i vazhdueshëm i VT/VMT për ndryshimet që ndodhin në rrethanat që prekin



situatën e tyre përfshirë ndalimet, mbulimin nga media, ndryshimin e akuzave, ndërprerjen e procedurave etj.;

2.1.13 Sigurimi i financimit të vazhdueshëm të shërbimeve për VT/VMT, me qëllim që qendrat pritëse dhe riintegruese për VT/VMT të respektojnë standardet e kërkuara;

2.1.14 Vlerësimi i nevojave për sigurimin e strehimit, akomodimit, dhe qasjes në shërbime për VT/VMT meshkuj;

2.1.15 Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit;

2.1.16 Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit dhe vetëpunësimit;

2.1.17 Promovimi i ndërmarrjeve sociale, sipërmarrjeve të tjera sociale dhe partneritetit publik-privat në iniciativa që angazhojnë VT/VMT, përfshirë personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike;

2.1.18 Sigurimi i efektshmërisë së njësive lëvizëse për identifikimin e VT/VMT, nëpërmjet zgjerimit të tyre, qoftë nga pikëpamja e përfshirjes gjeografike, ashtu dhe në rritjen e numrit të anëtarëve të NJL-së;

2.1.19 Monitorimi i rasteve të fëmijëve VT/VMT, të menaxhuara nga NJMF/PMF.

Treguesit në nivel masash:

- numri i rasteve të VT/VMT të asistuar në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në faze të hershme të procesit;

- numri i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbrojtje të posaçme;

- numri i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT;

- raporte monitorimi mbi zbatimin e masave të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT;

- numri i materialeve informuese të prodhuara për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat e mbrojtjes në bashki, strukturat joanëtare të MKR-së, në lidhje me zbatimin e PSV-ve;

- numri i personave të informuar në lidhje me zbatimin e PSV-ve;

- numri i të miturve VT/VMT të identifikuar gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit në PKK;

- marrëveshja për funksionimin e MKR-së e finalizuar;

- numri i problematikave/çështjeve të trajtuara në takimet periodike të MKR-së;

- numri i rasteve të reja të reflektuara në bazën e të dhënave të VT/VMT;

- udhëzimi i AP-së i rishikuar;

- numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse;

- numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfituar nga shërbimet ndihmëse;

- standardet e riintegritit të përfunduara;

- numri i rasteve që kanë marrë paketat e shërbimeve në qendra dhe në komunitet;

- studim fizibiliteti për nevojat për strejim, akomodim dhe qasjen në shërbime për VT/VMT meshkuj;

- numri i kthimeve të asistuar VT/ VMT sipas procedurave të unifikuara;

- numri i VT/VMT që kanë përfituar nga arsimit, formimi profesional dhe programet e nxitjes;

- numri i VT/VMT që janë punësuar ndarë sipas kategorive: vetëpunësuar, punësuar në sektorin privat;

- numri i ndërmarrjeve sociale dhe partneriteteve publik-privat, të cilat angazhojnë VT/VMT përfshirë shtetasit e huaj e personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike të promovuara;

- numri i rasteve të identifikuar nga njësitë lëvizëse;

- numri i monitorimeve të kryera për rastet e fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF.

Objektivi specifik 2.2. Rritja e profesionalizmit

Masat në lidhje me këtë objektiv, janë:

2.2.1 Trajnimi i avokatëve për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT;

2.2.2 Trajnimi i vazhduar ndërdisiplinor i profesionistëve që punojnë me fëmijët/ të rinjtë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT;

2.2.3 Trajnimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në



lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT/VMT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, ngrirjen e pasurive dhe mbështetjen e pretendimeve për kompensim të viktimave;

2.2.4 Trajnimi i avokatëve të specializuar për të mbështetur VT/VMT në pretendimin e kompensimit;

2.2.5 Trajnimi i grupeve të tjera profesionale përfshirë inspektorët e punës, punonjësit shëndetësorë (përfshirë punonjësit e shëndetit mendor), socialë, arsimorë dhe konsullorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.

Treguesit në nivel masash:

- numri i avokatëve të trajnuar për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT;

- numri i profesionistëve që punojnë me fëmijët për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT;

- numri i punonjësve të drejtësisë të trajnuar për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës. Ndarë: prokurorë; gjyqtarë;

- numri i trajnimeve të zhvilluara;

- numri i avokatëve të specializuar për të mbështetur viktimat në pretendimin e kompensimit;

- numri i personave nga grupet profesionale të trajnuar në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve.

2.1.3 Qëllimi i politikës III. Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda

Treguesi kryesorë i rezultatit për këtë qëllim politik, është:

- Përqindja e të rinjve, të cilët kanë njohuri mbi çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore.

Objektivi specifik 3.1. Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar

Masat në lidhje me këtë objektivi, janë:

3.1.1 Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuere në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me format e trafikimit të qenieve njerëzore dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin

për të drejtat e VT/VMT (veçanërisht gjatë muajve tetor, si muaj dedikuar çështjeve të antitrafikut), nëpërmjet platformave të komunikimit:

- spote ndërgjegjësuere mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio dhe televizion lokale dhe kombëtare;

- fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe *online* nëpërmjet faqes zyrtare të MB-së dhe medieve sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit *online*;

- materiale ndërgjegjësuere të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale.

3.1.2 Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006 dhe aplikacionit “Raporto dhe shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet:

- prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi linjën kombëtare dhe aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 bashki, pikat e kalimit kufitar, qendrat informuese etj.;

- trajnimit të punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi;

3.1.3 Informimi e ndërgjegjësimi i punonjësve të hotelarisë dhe turizmit për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror;

3.1.4 Informimi dhe këshillimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit me një fokus të veçantë të marrëdhëniet e rreme të punës edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019–2023;

3.1.5 Informimi i vazhdueshëm i azilkërkuesve, migrantëve të parregullt, në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit

3.1.6 Rritja e mundësive sociale dhe ekonomike për personat që i përkasin grupeve vulnerabël nëpërmjet masave efektive integruese në kuadër të zbatimit të dokumenteve të tjera politike (PKV-ja për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, PKV-ja për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019–2021, Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe



Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022; Strategjia e Strehimit Social 2016–2025), që synojnë arsimimin, punësimin dhe përfshirjen sociale

3.1.7 Ngritja e një qendre emergjence dhe multifunksionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshitetorë për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VTM;

3.1.8 Trajnimi i anëtarëve të komiteteve rajonale dhe tryezave teknike antitrafikim dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal në 12 qarqet e vendit;

3.1.9 Ndërmarrja e veprimtarive edukuese dhe këshilluese për gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë);

3.1.10 Kryerja e trajnimeve/takimeve ndërgjegjësuese për gazetarët, mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media, si dhe respektimin e garantimit të të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VTM dhe, veçanërisht, të fëmijëve, si kategoria më vulnerabël;

3.1.11 Rritja e ndërgjegjësimin të sektorit privat në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e bizneseve për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore në zinxhirët e tyre të furnizimit, për të mbështetur rehabilitimin dhe shërimin e viktimave në përputhje me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CM/Rec (2016) 3) për të drejtat e njeriut dhe biznesin, si dhe përfshirja e bizneseve në veprimtaritë riintegruese të VT/VTM;

3.1.12 Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në shkollat në lidhje me fenomenin e trafikimit, efektet e tij negative, mënyrat e parandalimit dhe raportimit dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt nga nxënësit;

3.1.13 Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore parauniversitare (mësuesit, drejtuesit, psikologët dhe punonjës socialë, stafi mbështetës, si pastrues e punonjës sigurie etj.) për zbatimin me rigorozitet të PSV-së, veçanërisht për identifikimin e fëmijëve/të rinjve VT/VTM.

Treguesit në nivel masash:

- numri i fushatave kombëtare dhe lokale të organizuara për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë (ndarja sipas fushatave të zhvilluara në televizion dhe media sociale);

- numri i personave të informuar përmes fushatave kombëtare dhe lokale;

- numri i rasteve të raportuara nga linja kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto! Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. (Ndarja: nr. i raportimeve në linjën kombëtare dhe atyre në aplikacion;

- numri i operatorëve të të linjës kombëtare falas 116-006 për këshillimin dhe referimin e çështjeve të raportuara të trajnuar;

- numri i trajnimeve të zhvilluara;

- numri i fushatave të organizuara në mediet sociale për promovimin e linjës kombëtare dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto!”;

- numri i punonjësve të hotelierisë dhe turizmit të informuar për identifikimin dhe raportimin e VT/VTM, kryesisht gjatë sezonit veror;

- numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit të informuar dhe këshilluar nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit;

- numri i azilkërkuesve të informuar në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit;

- kryerja e një sondazhi që do të shërbejë edhe si baseline në lidhje me: numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar përmes arsimit, punësimit, dhe përfshirjes sociale”. Mbi bazën e shifrës baseline të përlogaritur do të kemi edhe rritje në % të targets;

- Qendra Multifunksionale e ngritur dhe funksionale në veri të vendit;

- numri i aktoreve antitrafik të trajnuar;

- numri i gazetarëve të medias së shkruar dhe vizive të trajnuar (ndarja sipas gazetarëve të medieve vizive dhe të shkruar);

- numri i trajnimeve me pjesëmarrjen e gazetarëve të medieve vizive dhe të shkruar të zhvilluara;

- numri i gazetarëve të trajnuar mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VTM dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël;



- numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore: ndarë sipas: masa parandaluese; masa për riintegrimin e viktimave;

- numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete informuese dhe edukuese në shkolla;

- numri i stafeve arsimore të trajnuar për zbatimin me rigorozitet të PSV-së.

Objekti i specifik 3.2. Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/huaj për zona dhe komunitete vulnerabël

Masat në lidhje me këtë objekt, janë:

3.2.1 Përmirësimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit policor nëpërmjet një përfshirjeje më aktive në planet e veprimit operativ EMPACT në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë;

3.2.2 Finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Raporterit Kombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave pranë Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”;

3.2.3 Negociimi/zbatimi i marrëveshjeve të veçanta/protokolleve shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)

3.2.4 Organizimi i seminareve/trajnimeve për prezantimin e PKV 2021–2023, të të gjithë aktorët dhe partnerët që do të përfshihen në zbatimin e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të diskutuar/informuar mbi detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse që parashikon PKV, si dhe dhënia e udhëzimeve mbi hartimin e planeve të burimeve vjetore dhe planeve të monitorimit që parashikon ky plan;

3.2.5 Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe hartimi i raporteve periodike të monitorimit;

3.2.6 Përditësimi i vazhdueshëm në faqen zyrtare të MB-së me aktorë dhe projekte/masa të marra në fushën antitrafikim;

3.2.7 Vazhdimësia e raportimit nga të gjitha agjencitë zbatuese të MB-ja mbi veprimtaritë e tyre aktuale dhe ato të planifikuara mbi situatën dhe veprimtarinë antitrafik;

3.2.8 Intensifikimi i rolit të Bordit Këshillimor të VT/VTM, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për politikën dhe programet për parandalimin, mbrojtjen dhe riintegrimin;

3.2.9 Organizimi i vazhdueshëm i takimeve me grupe bashkërenduese kombëtare për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së, sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit.

Treguesit në nivel masash:

- numri i aksioneve të përbashkëta policore të kryera në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë;

- memorandumit të bashkëpunimit i firmosur mes palëve;

- numri i rasteve të menaxhuara bazuar në bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi);

- numri i zyrtarëve publikë dhe aktorëve të tjerë të informuar lidhur me PKV 2021–2023 në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor;

- numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antitrafikim të hartuara dhe publikuara;

- numri i përditësimeve çdo vit të kryera në faqen zyrtare të ZKKA-së;

- raporte periodike vjetore me rekomandime të Bordit Këshillimor të VT/VTM;

- numri i takimeve për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit të kryer.

PJESA III. ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

III.1 Zbatimi i PKV-së antitrafikim

PKV-ja antitrafikim do të zbatohet gjatë periudhës 2021–2023. MB-ja është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ecursisë së zbatimit të këtij dokumenti, mbështetur kryesisht nga DPPSH-ja dhe nga disa institucione të tjera.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë plan veprimi janë paraqitur në Planin e Veprimit (format II). Në Planin e Veprimit janë përcaktuar gjithashtu afatet kohore, kostot indikative, burimet e financimit për zbatimin



e tij dhe hendeku financiar. Për secilën nga masat është parashikuar institucioni përgjegjës për zbatimin e veprimtarisë dhe raportimin e saj. Për zbatimin e masave të parashikuara në PKV antitrafikim do të bashkëpunohet me disa nga ministratë e linjës, institucionet e zbatimit të ligjit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.

III.2 Monitorimi dhe raportimi

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të ngarkuara për zbatimin e tyre konsiderohet i nevojshëm për të analizuar situatën reale gjatë dhe për të mbikëqyrur ecurinë periodike, me qëllim përmbushjen e tyre në mënyrë sa më efektive, në kohë dhe sipas targeteve të përcaktuara.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si: mbledhja e të dhënave; analizimi i të dhënave; hartimi i raporteve periodike në nivel institucioni. Të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e Planit të Veprimit do të hartojnë raporte të unifikuara 6-mujore në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

Drejtoria e Antitrafikut dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme do të jetë institucioni përgjegjës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij plani veprimi.

Raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit do të paraqiten për rekomandime edhe pranë Komitetin Shtetëror kundër Trafikimit.

PJESA IV. ANALIZA BUXHETORE


Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e PKV-së kundër trafikimit të personave 2021–2023. Efektet financiare janë përlogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuar në Planin e Veprimit. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e masave.

Procesi i kostimit u mbështetet në konsultimin e dokumenteve të tjera kombëtare, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 (faza III), dhe propozimet sipas taveve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022–2024, konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës. Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i PKV-së është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikave të planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduar nga IPSIS-ja.


Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e PKV antitrafikim 2021–2023 është **412,552,420 lekë** ose **3,300,419 euro**. Kursi mesatar për referencë është përlogaritur me 125 lekë për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 3 viteve të zbatimit PKV.

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Hendeku Financiar
		2021-2023	PBA 2021-2023	2021-2023
		Buxheti dhe Donoret		
Qëllimi i Politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korente	50,677,784	47,478,584	3,199,200
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i Politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	Korente	138,302,992	132,507,000	8,670,992
	Kapitale	5,750,000	2,875,000	
Qëllimi i Politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korente	214,946,644	182,012,644	35,809,000
	Kapitale	2,875,000	0	
TOTALI [Leke]		412,552,420	364,873,228	47,679,192
TOTALI [Euro] 1 euro 125 Leke		3,300,419	2,918,986	381,434


Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021–2023, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 85.0% të financimit të nevojshëm, 5% pritet të financohet nga donatorët, ndërsa 10.0% është hendek financiar.



Kostot korente zënë rreth 98.0% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (2.0%) është e parashikuar për kosto kapitale.



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë:



Qëllimi i politikës III, pritet të ketë në terma financiare peshën më të madhe në zbatimin e strategjisë, përkatësisht 52.8 %. Qëllimi i politikës II kap vlerën 34.9%, ndërsa qëllimet e politikës I kapin 12.3 % të kostos së përgjithshme të PKV-së.

Për masat e PKV-së që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.

Moszbatimi i planit për mungesë fondesh mbetet një risk, por ky është i ulët pasi hendeku financiar është i ulët dhe është kryesisht në vitin e dytë dhe të tretë.



ANEKS 1
TABELA E PKV-së ANTITRAFIKIM

I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT										
QËLLIMI I POLITIKËS 1: ULJA E KËRCËNIMIT DHE NDIKIMIT TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA										
OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1. Goditja e trafikeve të paligjshme										
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
1.1.1	Ndryshimi i Kodit Penal në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të RSH-së dhe rekomandimet (finalizimi i miratimit të ndryshimeve ligjore për nenet 124 /b, 128/b për të parashikuar shfrytëzimin ekonomik dhe trafikimin e brendshëm të fëmijëve (edhe në kuadër të PKV për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, përfshirë Fëmijët në Situatë Rruge 2019-2021), 52/a, 110/a, 114 (2) të Kodit Penal), si edhe ndryshimi për trafikimin e organeve njerëzore (sipas Konventës së Këshillit të Evropës)	MD	MB MSHMS PP DPPSH	2021	2023	Kodi Penal i ndryshuar	0		1	
1.1.2	Miratimi i një ligji të veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT dhe përafrimi për aq sa është e mundur me direktivën 2011/36 “Mbi parandalimin dhe luftën e trafikut të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tyre”: Ngritja e grupit të punës; Sigurimi i ekspertizës për draftimin e ligjit; Konsultimi publik	MB	MD, MSHMS, MKR AP, KKSAT, ON OJF Ekspertë të fushës	2021	2023	Ligji i veçantë kundër trafikimit të personave dhe për mbrojtjen e VT/VMT i miratuar	0			1
1.1.3	Trajnimi i strukturave gjyqësore për t'u specializuar për veprat penale të trafikimit me qëllim për të hetuar në mënyrë proaktive rastet e trafikimit të personave, për të kryer në mënyrë efektive procedurat e ndjekjes penale, për të përdorur teknika speciale të hetimit, për të fuqizuar kryerjen e hetimeve financiare në kuadër të veprave të trafikimit, për të zbatuar sanksione proporcionale dhe shkatërruese dhe për të siguruar që kohëzgjatja e procedurave gjyqësore të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe standardet e përcaktuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)	SHM	MB/DPPSH PP KKSAT ON/OJF	2021	2023	Numri i strukturave gjyqësore të trajnuar për veprat penale të trafikimit, ndarë sipas çështjeve të trajnimeve	50	60	70	80
1.1.4	Trajnimi i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të	DPPSH/DK&M	MB/Azili NJMF	2021	2023	Numri i viktimave të mundshme të trafikimit të	2	2	4	6



	qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor për rritjen e kapaciteteve për identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar, pavarësisht aftësisë dhe/ose gatishmërisë së tyre për të bashkëpunuar, sidomos në situata emergjence, si në rastin e COVID-19.		DPD, MSHMS, ON, OJF			identifikuara nga DK&M; Numri i punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit, punonjësve doganorë, punonjësve të azilit dhe stafit të qendrave të pritjes dhe akomodimit të migrantëve përfshirë stafin mjekësor që kanë njohuri mbi identifikimin e VT/VMT mes azilkërkuesve, migrantëve dhe veçanërisht fëmijëve të pashoqëruar	1500	1500	1700	1900
1.1.5	Trajnimi i punonjësve të patrullës së përgjithshme të policisë, të repartit “Shqiponja” dhe strukturave të tjera përgjegjëse për identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit për të rritur dhe fëmijë si dhe bashkëpunimi ndërsektorial	DPPSH/ Akademia e Sigurisë	MKR, KKSAT OJF ON	2021	2023	Numri i përfutësve të trajnimeve mbi identifikimin, hetimin, mbledhjen e informacionit për çështjet e trafikimit dhe bashkëpunimin ndërsektorial Ndarja sipas pozicioneve - punonjësve të patrullës së përgjithshme - të policisë - repartit “Shqiponja - struktura të tjera përgjegjëse	300	200	300	400
1.1.6	Monitorimi dhe identifikimi i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe inkurajimi i publikut për raportimin e zyrtarëve të korruptuar	SHÇBA	DPPSH OJF	2021	2023	Numri i zyrtarëve dhe punonjësve të institucioneve publike ligjzbatuese, të cilët janë përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore të proceduar	0	0	0	0
1.1.7	Forcimi i bashkërendimit në hetimet financiare me qëllim identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta për rritjen e numrit të procedimeve penale të suksesshme	MB/DPPSH	PP SPAK	2021	2023	Numri i operacioneve identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe hetimeve financiare të përbashkëta të kryera	1	1	2	3
1.1.8	Rishikimi i marrëveshjes së bashkëpunimit antitrafikim mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHPSHSH dhe përfshirja në të edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve	MB	ISHPSHSH DPPSH DPT ON OJF	2022	2023	Marrëveshja e rishikuar dhe aprovuar Numri i rasteve të identifikuara në lidhje me	0 0	- 0	- 0	1 3



						shfrytëzimin për punë, si rrjedhojë e inspektimeve të përbashkëta mes Koordinatorit Kombëtar, DPPSH, ISHPSHSH				
1.1.9	Krijimi i një praktike të re koordinimi për shkëmbim informacioni periodik lidhur me evidentimin dhe referimin e çështjeve penale të trafikimit të qenieve njerëzore	MB	PP KKSAT MKR DPPSH	2022	2023	Praktika e re e koordinimit funksionale	0		1	
I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT										
QËLLIMI I POLITIKËS II. MBROJTJA E QYTETARËVE, INSTITUCIONEVE DHE EKONOMISË										
2.1	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t'iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar									
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
2.1.1	Informimi i VT/VMT në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT, duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit	MB,KKSAT	MD PP AP	2021	2023	Numri i rasteve të VT/VMT të asistuara në lidhje me të drejtën për shërbime juridike dhe psikologjike dhe lehtësimi i aksesit në drejtësi për VT/VMT duke i siguruar ndihmë juridike të specializuar dhe falas që në fazë të hershme të procesit.	86	85	170	250
2.1.2	Ndërmarrja e hapave përkatës për garantimin e mbrojtjes së posaçme dhe efektive si dhe vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për VT/VMT, dëshmitarët dhe anëtarët e familjes së tyre, brenda apo jashtë vendit, nga hakmarrja dhe kërcënimet mundshëm gjatë të gjitha fazave të procedimit penal, duke inkurajuar rritjen e bashkëpunimit të personave të trafikuar me institucionet e zbatimit të ligjit dhe duke aplikuar një qasje të orientuar te mbrojtja e VT/VMT	DPPSH	PP KKSAT	2021	2023	Numri i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore që kanë marrë mbrojtje të posaçme	1	1	1	2
2.1.3	Raportimi efektiv dhe periodik i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT, me qëllim përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale kur janë në kushtet e mbrojtjes nga ligji, analizimin e tyre dhe vlerësimin e nevojave për trajnim të punonjësve të drejtësisë	DPPSH	PP	2021	2023	Numri i rasteve kur ndaj VT/VMT ka filluar ndjekja penale dhe më pas identifikohen si VT/VMT	1	0	0	0
2.1.4	Zbatimi i masave të posaçme të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/ të rinjtë VT/VMT për sa u përket kompetencave të profesionistëve të përfshirë dhe mjedisit në të cilin zhvillohen intervistat që të jetë i përshtatur e miqësor, si	DPPSH	PMF PP	2021	2023	Raporte monitorimi mbi zbatimin e masave të mbrojtjes në praktikë për fëmijët/të rinjtë VT/VMT	0	1	2	3



	dhe aplikimin e mjeteve audiovizive me qëllim evitimin e intervistimit të përsëritur nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të tyre									
2.1.5	Hartimi i broshurave orientuese për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat joanëtare të MKR, në lidhje me zbatimin e PSV-ve	MB	ASHMDF NJVQV MEPJ, OJF, ON Ekspertë të fushës	2022	2023	Numri i materialeve informuese të prodhuara për stafin konsullor, njësitë lëvizëse, strukturat e mbrojtjes në bashki, strukturat joanëtare të MKR, në lidhje me zbatimin e PSV-ve.	0	0	7000	7000
						Numri i personave të informuar në lidhje me zbatimin e PSV-ve	2000	2000	2020	2040
2.1.6	Parandalimi/identifikimi i trafikimit të VT/VMT të mitur në kufti (përfshirë kalimin e paligjshëm të kufirit nga fëmijët), vetëm ose të shoqëruar me të rritur nëpërmjet kontrollit të detyrueshëm të dokumentacionit për fëmijët	DK&M	DPPSH, PMF,	2021	2023	Numri i të miturve VT/VMT të identifikuar gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit në PKK.	3	3	5	6
2.1.7	Rishikimi i MKR me qëllim garantimin e funksionimit të vazhdueshëm efektiv dhe efikas të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar	MB	MKR, AP, OJF, ON	2022	2023	Marrëveshja për Funksionimin e MKR-së e finalizuar	0	0	1	
2.1.8	Organizimi i takimeve periodike të anëtarëve të MKR-së	MB	MKR ON	2021	2023	Numri i problematikave /çështjeve të trajtuara në takimet periodike të MKR-së	3	3	5	7
2.1.9	Përditësimi i vazhdueshëm i bazës së të dhënave të VT/VMT për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve nga Autoriteti Përgjegjës, si dhe raportimi periodik pranë MKR-së	MB	AP MKR KKSAT	2021	2023	Numri i rasteve të reja të reflektuara në bazën e të dhënave të VT/VMT	86	85	170	250
2.1.10	Rishikimi i udhëzimit të AP-së; Përfshirja në AP e përfaqësuesve nga ISHPSHSH/AKPA/AMSHDF; Krijimi i grupit të punës Organizimi i takimeve; Udhëzimi i rishikuar	MB	AP Ekspertë të fushës	2022	2023	Udhëzimi i AP-së i rishikuar	0		1	
2.1.11	Informimi i përshtatshëm i VT/VMT veçanërisht për fëmijët duke përdorur një gjuhë miqësore, në lidhje me të drejtat që kanë, shërbimet në dispozicion dhe mënyrat e aksesimit të tyre me qëllim marrjen e vendimeve të informuara nga ana e VT/VMT si edhe informimi i vazhdueshëm i VT/VMT	MSHMS	NJMF SHSSH KKSAT OJF, ON	2021	2023	Numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfutur nga shërbimet ndihmëse	86	85	170	250



2.1.12	Informimi i vazhdueshëm i VT/VMT për ndryshimet që ndodhin në rrethanat që prekin situatën e tyre përfshirë ndalimet, mbulimin nga media, ndryshimin e akuzave, ndërprerjen e procedurave etj.	DPPSH	PP	2021	2023	Numri i VT/VMT të informuar dhe që kanë përfutur nga shërbimet ndihmëse	86	85	170	250
2.1.13	Sigurimi i financimit të vazhdueshëm të shërbimeve për VT/VMT me qëllim që qendra pritëse dhe riintegruese për VT/VMT të respektojnë standardet e kërkuara	MSHMS	MKR SHSSH KKSAT ON	2021	2023	Standardet e riintegrit të përfundura; Numri i rasteve që kanë marrë paketat e shërbimeve në qendra dhe në komunitet	0 85	 80	1 75	 70
2.1.14	Vlerësimi i nevojave për sigurimin e strehimit, akomodimit dhe qasjes në shërbime për VT/VMT meshkuj	MB	MSHMS KKSAT OJF	2021	2023	Studim fizibiliteti për nevojat për strejim, akomodim dhe qasjen në shërbime për VT/VMT meshkuj	0	0	0	1
2.1.15	Zbatimi PSV-ve, i protokolleve shtesë dhe formateve të unifikuara për kthimin vullnetar të asistuar të VT/VMT, si dhe orientimi i NJMF-ve për plotësimin e saktë të formave dhe procedurave që përcaktojnë PSV-të.	MB	AP MEPJ NJMF SHSSH KKSAT OJF ON	2021	2023	Numri i kthimeve të asistuar VT/ VMT sipas procedurave të unifikuara	4	4	7	10
2.1.16	Forcimi i qasjes efektive në tregun e punës për VT/VMT nëpërmjet arsimit, formimit profesional, programeve të nxitjes së punësimit e vetëpunësimit	MFE/AKPA	MSHMS KKSAT NJMF SHSSH, Shërbimet sociale në bashki OJF	2021	2023	Numri i VT/VMT që kanë përfutur nga arsimi, formimi profesional dhe programet e nxitjes	86	85	170	250
						Numri i VT/VMT që janë punësuar: Ndarë sipas kategorive: - të vetëpunësuar - të punësuar në sektorin privat	19	19	38	57
2.1.17	Promovimi i ndërmarrjeve sociale, sipërmarrjeve të tjera sociale dhe partneritetin publik-privat në iniciativa që angazhojnë VT/VMT personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike	MSHMS	KKSAT OJF NJVQV Biznesi privat	2021	2023	Numri i ndërmarrjeve sociale dhe partneriteteve publik-privat, të cilat angazhojnë VT/VMT përfshirë shtetasit e huaj e personat me prejardhje të pafavorshme socio-ekonomike të promovuara	0	0	1	2
2.1.18	Sigurimi i efektshmërisë së njësive lëvizëse për identifikimin e VT/VMT nëpërmjet zgjerimit të tyre, qoftë nga pikëpamja e përfshirjes gjeografike, ashtu dhe në rritjen	ASHMDF	KKSAT DPPSH, NJMF Shërbimet	2021	2023	Numri i rasteve të identifikuar nga njësitë lëvizëse	40	40	60	80



	e numrit të anëtarëve të NJL		sociale në bashki OJF, ON							
2.1.19	Monitorimi i rasteve të fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF	ASHMDF	SHSSHJQVQV OJF	2021	2023	Numri i monitorimeve të kryera për rastet e fëmijëve VT/VMT të menaxhuara nga NJMF/PMF	0	5	6	7
2.2	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: Rritja e profesionalizmit									
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni kontribues				2020	2021	2022	2023
2.2.1	Trajnimi i avokatëve për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT	DHKA	ON KKSAT OJF	2021	2023	Numri i avokatëve të trajnuar për çështjet e trafikimit me qëllim mbrojtjen e VT/VMT	20	20	30	40
2.2.2	Trajnimi i vazhduar ndërdisiplinor i profesionistëve që punojnë me fëmijët/ të rinjtë për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	ASHMDF	Shërbimet sociale në NJVQV Nj L, GTN (Grupi Teknik Ndërsektorial në nivel Bashkie) ON/OJF	2021	2023	Numri i profesionistëve që punojnë me fëmijët për identifikimin e hershëm dhe trajtimin e VT/VMT	61	61	61	61
2.2.3	Trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT/VMT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës, ngrirjen e pasurive dhe mbështetjen e pretendimeve për kompensim të viktimave	SHM	ON KKSAT OJF	2021	2022	Numri i punonjësve të drejtësisë të trajnuar për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin në lidhje me mbledhjen e provave për dëmin që ka pësuar VT përfshirë përfitimin financiar nga shfrytëzimi i viktimës. Ndarë: prokurorë; gjyqtarë	26	26	36	45
						Numri i trajnimeve të zhvilluara	6	6	7	8
2.2.4	Trajnimi i avokatëve të specializuar për të mbështetur VT/VMT në pretendimin e kompensimit	DHKA	KKSAT ON OJF	2021	2023	Numri i avokatëve të specializuar për të mbështetur viktimat në pretendimin e kompensimit	20	20	30	40
2.2.5	Trajnimi i grupeve të tjera profesionale përfshirë inspektorët e punës, punonjësit shëndetësorë (përfshirë punonjësit e shëndetit mendor), socialë, arsimorë dhe konsullorë në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve	ISHPSHSHMS HMS MFE ASCAP MEPJ	MB,MKR AP,KKSATOJF ON Akademia Konsullore	2021	2023	Numri i personave nga grupet profesionale të trajnuar në lidhje me identifikimin e VT/VMT, intervistimin e referimin dhe zbatimin e PSV-ve	100	60	120	160



						Ndarja sipas grupeve profesionale: - inspektorët e punës, - punonjësit shëndetësorë - punonjësit e shëndetit mendor, - punonjës socialë - arsimtarë dhe - konsullorë				
I. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TERRORIZMIT DHE TRAFIKIMIT										
QËLLIMI I POLITIKËS III: RRIJTJA E FORCËS PARANDALUESE NDAJ KËRCËNIMEVE TË KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KRIMEVE TË RËNDA										
3.1	OBJEKTIVI SPECIFIK 3.1: Realizimi i fushatave për rritjen e ndërgjegjësimit me përfshirjen e institucioneve qendrore dhe vendore, shoqërisë civile, biznesit, medias dhe aktorëve të tjerë për parandalimin e krimit të organizuar									
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targets		
		Institucioni përgjegjës	Institucioni Kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
3.1.1	Organizimi dhe ndërmarrja e fushatave masive ndërgjegjësuere në nivel kombëtar dhe lokal për informimin lidhur me formate trafikimit të qenieve njerëzore dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë, përfshirë ndërgjegjësimin për të drejtat e VT/VMT (veçanërisht gjatë muajve tetor, si muaj dedikuar çështjeve të antitrafikut), nëpërmjet platformave të komunikimit: - spote ndërgjegjësuere mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore në radio & televizion lokale dhe kombëtare; - fushatë ndërgjegjësimi në terren dhe <i>online</i> nëpërmjet faqes zyrtare të MB-së dhe medieve sociale në lidhje me mënyrat e shfrytëzimit dhe format e shfaqjes së trafikimit, përfshirë format e trafikimit <i>online</i> , - materiale ndërgjegjësuere të printuara që synojnë grupet vulnerabël, djemtë, vajzat e gratë, fëmijët, komunitetin rom dhe egjiptian, në zonat urbane dhe rurale	MB	MKR,AP KRAT AMA, OJF ON, TV kombëtare dhe lokale	2021	2023	Numri i fushatave kombëtare dhe lokale të organizuara për informimin lidhur me format e trafikimit dhe efektin e tij në jetën e individit dhe shoqërisë (ndarja sipas fushatave të zhvilluara në televizion dhe medie sociale)	1	1 fushatë	2 fushata	3 fushata
						Numri i personave të informuar përmes fushatave kombëtare dhe lokale	200 000 persona	300 000 persona	600 000 persona	900 000 persona
3.1.2	Forcimi i kapaciteteve të linjës kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet: - prodhimit dhe shpërndarjes së posterave informues mbi linjën kombëtare dhe aplikacionin në 12 qarqe, përfshirë 61 bashki, pikat e kalimit kufitar, qendrat informuese etj.; - trajnimit të punonjësve të sallës operative mbi komunikimin etik, referimin e problematikave të adresuara dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit në	MB/DPPSH	KKSAT OJF, ON	2022	2023	Numri i rasteve të raportuara nga linja kombëtare falas 116-006, dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto” për të mundësuar këshillimin dhe raportimin e rasteve të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. (Ndarja: nr. i raportimeve në linjën kombëtare dhe atyre në	0	6	16	30



	fuqi					aplikacion				
						Numri i operatorëve të linjës kombëtare falas 116-006 për këshillimin dhe referimin e çështjeve të raportuara të trajnuar	4	4	4	4
						Numri i trajnimeve të zhvilluara	0	1	2	3
						Numri i fushatave të organizuara në mediet sociale për promovimin e linjës kombëtare dhe aplikacionit “Raporto dhe Shpëto!”	1			
3.1.3	Informimi e ndërgjegjësimi i punonjësve të hotelarisë dhe turizmit për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	MTM	MB, OJF, ON Shoqata Shqiptare e Turizmit	2021	2023	Numri i punonjësve të hotelarisë dhe turizmit të informuar për identifikimin dhe raportimin e VT/VMT, kryesisht gjatë sezonit veror	N/A	0	100	200
3.1.4	Informimi dhe këshillimi i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit me një fokus të veçantë të marrëdhëniet e rreme të punës edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019-2023	MEPJ	MB ON OJF	2021	2023	Numri i qytetarëve shqiptarë jashtë vendit të informuar dhe këshilluar nga stafet konsullore në lidhje me format e shfaqjes së trafikimit;	200 qytetarë	200 qytetarë	300 qytetarë	400 qytetarë
3.1.5	Informimi i vazhdueshëm i azilkërkuesve, migrantëve të parregullt, në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	MB/Drejtoria e Azilit, DK & M, QKPA, Karrec, Gërhot, Kapshtice	MKR	2021	2023	Numri i azilkërkuesve të informuar në gjuhë që e kuptojnë për të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga fenomeni i trafikimit	100 azilkërkues	100 azilkërkues	200 azilkërkues	300 azilkërkues
3.1.6	Rritja e mundësive sociale dhe ekonomike për personat që i përkasin grupeve vulnerabël nëpërmjet masave efektive integruese në kuadër të zbatimit të dokumenteve të tjera politike (PKV për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, PKV për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019-2021, Strategjisë Kombëtare për arsimin dhe Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022; Strategjia e Strehimit Social 2016-2025) që synojnë arsimimin, punësimin dhe përfshirjen sociale.	MSHMS MFEMAS	NJVQV, TT KRAT SHSSH NJMF DVP KKSAT	2021	2023	Numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar përmes arsimit, punësimit, dhe përfshirjes sociale	N/A Kryerja e një sondazh që do të shërbejë edhe si baseline në lidhje me: Numri i personave që i përkasin grupeve vulnerabël të integruar		5 % rritje nga vlera baseline e përllogaritur	10 % rritje nga vlera baseline e përllogaritur



							përmes arsimit, punësimit, dhe përfshirjes sociale”. Mbi bazën e shifrës baseline të përlogaritur do kemi edhe rrije në % të targets			
3.1.7	Ngritja e një qendre multifunkionale në veri të vendit në bashkëpunim me partnerë joshitetërorë për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VMT - Për të ofruar asistencë dhe shërbime shëndetësore, ekonomike, formim profesional dhe ngritje kapacitetesh për këto grupe vulnerabël	MB	NJVQV ON OJF	2022	2023	Qendra Multifunkionale e ngritur dhe funksionale në veri të vendit	0			1
3.1.8	Trajnimi i anëtarëve të Komiteteve Rajonale dhe Tryezave Teknike Antitrafikim dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal në 12 qarqet e vendit	MB	KRAT TT OJF ON	2021	2023	Numri i aktorëve antitrafik të trajnuar Ndare sipas: Anëtarë të Komiteteve Rajonale Anëtarë të tryezave Teknike Antitrafikim Aktorë të tjerë antitrafik	220	220	440	660
3.1.9	Ndërmarrja e veprimtarive edukuese dhe këshilluese për gazetarët, mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë).	AMA	MB MKR Shoqata e Gazetarëve OJF, ON	2021	2023	Numri i gazetarëve të medias së shkruar dhe vizive të trajnuar (ndarja sipas gazetarëve të medie vizive dhe të shkruar)	30 gazetarë	30 gazetarë	50 gazetarë	70 gazetarë
						Numri i trajnimeve me pjesëmarrjen e gazetarëve të medie vizive dhe të shkruar të zhvilluara. Ndarë sipas çështjeve të trajnimeve si me poshtë: 1. mbi rolin e medias në parandalimin e trafikimit të personave dhe rëndësinë e	5 trajnime	6 trajnime	7 trajnime	8 trajnime



						trafikimit si shkelje serioze të të drejtave të njeriut dhe të drejtave në punë (shfrytëzimi në punë, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve, lypja, shfrytëzimi seksual, martesat nën moshë 2. mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në medie dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël				
3.1.10	Kryerja e trajnimeve/takimeve ndërgjegjëse për gazetarët, mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në medie, si dhe respektimin e garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të fëmijëve si kategoria më vulnerabël	AMA	MKR Shoqata e Gazetarëve OJF ON	2022	2023	Numri i gazetarëve të trajnuar mbi mënyrën e paraqitjes së rasteve të trafikimit në media dhe respektimin dhe garantimin e të drejtës së ruajtjes së jetës private të VT/VMT dhe veçanërisht të të miturve si kategoria më vulnerabël	30	30	50	70
3.1.11	Rritja e ndërgjegjësimin të sektorit privat në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e bizneseve për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore në zinxhirët e tyre të furnizimit, për të mbështetur rehabilitimin dhe shërimin e viktimave në përputhje me rekomandimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (CM/Rec (2016) 3) për të drejtat e njeriut dhe biznesin, si dhe përfshirja e bizneseve në veprimtaritë rintegruese të VT/VMT	MFE	MB	2021	2023	Numri i bizneseve që kanë marrë pjesë në masa kundër trafikimit të qenieve njerëzore: Ndarë sipas: - masa parandaluese; - masa për rintegrimin e viktimave.	0	0	3	5
3.1.12	Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në shkollë në lidhje me fenomenin e trafikimit, efektet e tij negative, mënyrat e parandalimit dhe raportimit dhe rëndësinë e përdorimit të internetit në mënyrë të sigurt nga nxënësit	MAS	MB DPAP KRAT AP, OJF ON NJQV/NJMF/ PMF shërbimi psiko-social nshkolla	2021	2023	Numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete informuese dhe edukuese në shkollë	900 nxënës	900 nxënës	1300 nxënës	1700 nxënës
3.1.13	Trajnimi i punonjësve të institucioneve arsimore	MAS	MB	2021	2023	Numri i stafëve arsimore të	450 staf	200 staf	300 staf	450 staf



	parauniversitare (mësuesit, drejtuesit, psikologët dhe punonjësit socialë, stafi mbështetës si pastrues e punonjës sigurie etj.) për zbatimin me rigorozitet të PSV-së, veçanërisht për identifikimin e fëmijëve/të rinjve VT/VTM		ASCAP, Shkolla e Drejtorëve OJF			trajnuar për zbatimin me rigorozitet të PSV-së	arsimor	arsimor	arsimor	arsimor
3.2	OBJEKTIVI SPECIFIK 3.2: Ofrimi dhe koordinimi i mbështetjes së brendshme/ huaj për zona dhe komunitete vulnerabël									
Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse		Afati i fillimit	Afati i mbarimit	Treguesit	Baseline	Synimet/ Targetet		
		Institucioni përgjegjëse	Institucioni kontribues				2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
3.2.1	Përmirësimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit policor nëpërmjet një përfshirjeje më aktive në planet e veprimit operativ EMPACT në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë	DPPSH	ON	2021	2023	Numri i aksioneve të përbashkëta policore të kryera në luftën kundër krimit të organizuar dhe sipas strategjisë	1	1	2	3
3.2.2	Finalizimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Raporterit Kombëtar të Trafikimit të Qenieve Njerëzore pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Personave pranë Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e fëmijëve të pashoqëruar dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të asistuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit “	MB	MEPJ MKR	2022	2023	Memorandumi i bashkëpunimit i firmosur mes palëve	0	0	0	1
3.2.3	Negocimi/zbatimi i marrëveshjeve të veçanta/protokolleve shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)	MB	MEPJ DPPSH DK&M ASHMDF ON	2021	2022	Numri i rasteve të menaxhuara bazuar në bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me parandalimin e trafikimit të të rriturve dhe të të miturve (migrantë, fëmijë të pashoqëruar, VT/VTM, fëmijë në rrezik trafikimi)	4	4	6	
3.2.4	Organizimi i seminareve/trajnimeve për prezantimin e PKV 2021-2023, të të gjithë aktorët dhe partnerët që do të përfshihen në zbatimin e tij në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për të diskutuar/informuar mbi detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse që parashikon PKV, si dhe dhënia e udhëzime mbi hartimin e planeve të burimeve vjetore dhe planeve të monitorimit që parashikon ky plan.	MB	MKR, AP OJF, ON NJQV	2021	2022	Numri i zyrtarëve publikë dhe aktorëve të tjerë të informuar lidhur me PKV 2021-2023 në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor	0	0	500	
3.2.5	Monitorimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe hartimi i raporteve periodike të monitorimit	MB	KSH MKR Ministrinë e	2022	2023	Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit	0	1	2	3



			linjës dhe institucio-net e përfshira në zbatim ON OJF			Antitrafikim të hartuara dhe publikuara				
3.2.6	Përditësimi i vazhdueshëm në faqen zyrtare të MB-së me aktorë dhe projekte/masa të marra në fushën e antitrafikimit	MB	MKR, AP KRAT, OJF ON	2021	2023	Numri i përditësimeve çdo vit të kryera në faqen zyrtare të ZKKA-së	5	5	10	15
3.2.7	Vazhdimësia e raportimit nga të gjitha agjencitë zbatuese të MB-ja mbi veprimtaritë e tyre aktuale dhe ato të planifikuara mbi situatën dhe veprimtarinë antitrafik	MB	MKR, AP KRAT OJF ON	2021	2023	Të ndarë sipas: raporte vjetore/ masa të marra në fushën e antitrafikimit				
3.2.8	Intensifikimi i rolit të Bordit Këshillimor të VT/VMT, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për politikën dhe programet për parandalimin, mbrojtjen dhe ri integrimin	MB	KKSAT	2021	2023	Raporte periodike vjetore me rekomandime të Bordit Këshillimor të VT/VMT	0	1	2	3
3.2.9	Organizimi i vazhdueshëm i takimeve me grupe bashkërenduese kombëtare për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit.	MB	KSH, MKR KRAT ON	2021	2023	Numri i takimeve për evidentimin e progresit të zbatimit të PKV-së sipas nevojave dhe hartimin e raportit të monitorimit të kryera Të ndara sipas: takime me Komitetin Shtetëror kundër Trafikimit; takime me grupe bashkërenduese kombëtar	0	0	2	4

[illegible]

Viti 2021 – Numri 177[illegible]

Page | 15735

[illegible]

875,108,840

Kontribusi Total ke PV	412.552.420
PBA 2021-2023	345.220.036
Finansiasi (Hutang)	19.653.192
Hasil dari Investasi 2021-2023	-47.479.192
Kontribusi Korporasi	403.927.420
Kontribusi Kapitalis	8.625.000
Total Kontribusi	412.552.420

96
84
5
-12


	Konto Koreksi	Konto Kapital	Total
Gedilme / Pabrikas I	50,877,788	0	50,877,788
Gedilme / Pabrikas II	138,302,992	5,750,000	144,052,992
Gedilme / Pabrikas III	218,946,644	2,875,000	217,621,644

17
34
52




Nevojat Kapitale (në Lek)

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale	Kostot e Planifikuara	Hendeku Financiar
		2021-2023	PBA 2021-2023 Buxheti dhe Donatoret	2021-2023
Qëllimi i Politikës I: Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korente	50,677,784	47,478,584	3,199,200
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i Politikës II: Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë	Korente	138,302,992	132,507,000	8,670,992
	Kapitale	5,750,000	2,875,000	
Qëllimi i Politikës III: Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	Korente	214,946,644	182,012,644	35,809,000
	Kapitale	2,875,000	0	
TOTALI [Leke]		412,552,420	364,873,228	47,679,192
TOTALI [Euro] 1 euro 125 Leke		3,300,419	2,918,986	381,434






Natyra Ekonomike e Kostove të Planit të Veprimit



Kosto të lidhura me qëllimet e politikave





VENDIM

Nr. 528, datë 10.11.2021

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 75, DATË 23.5.2019,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR,
“PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT
TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE
LIGJORE PËR REKRUTIMIN E
KANDIDATËVE PËR GJYQTARË, PËR
ZHVILLIMIN E KARRIERËS SË
GJYQTARËVE DHE PËR EMËRIMIN E
GJYQTARËVE TË GJYKATËS
SË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 147, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 61, pika 2, gjerat “P” dhe “J”, nenit 70, pika 2, neneve 85 dhe 86, gjerat “a”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, i ndryshuar, neneve 32, 35, 36, 48, 49 dhe 55, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 75, datë 23.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në bazën ligjore të vendimit, pas fjalëve “të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë” shtohen fjalët: “nenit 61, pika 2, gjerat “J” dhe “j”, nenit 70, pika 2”.

2. Në fjalinë e parë të pikës 7, kreu IV, hiqet togfjalëshi “janë diplomuar në Shkollën e Magjistraturës”.

3. Seksioni A, kreu X, shfuqizohet.

4. Seksioni B, kreu X, ndryshohet si më poshtë:

“B. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar

1. Kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, të cilët janë konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë të organeve të rivlerësimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Për periudhën e rivlerësimit kalimtar, vendimi i Këshillit mbështetet në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit.

2. Për kandidatët subjekt rivlerësimi kalimtar, për të cilët nuk ka filluar ose nuk ka përfunduar procesi i rivlerësimit kalimtar, Këshilli i Lartë Gjyqësor kërkon shqyrtimin me përparësi të këtij procesi ndaj tyre. Për këta kandidatë fillon verifikimi i pasurisë dhe figurës sipas përcaktimeve të ligjit për statusin dhe të këtij vendimi, për periudhën mbas asaj të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procedura e verifikimit përmbyllet mbas dhe në varësi të mënyrës së përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar.

3. Marrja e masës disiplinore, sipas neneve 60 dhe 61, të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përbën shkak për skualifikimin dhe përjashtimin nga procedurat e ngritjes në detyrë të kandidatëve subjekt rivlerësimi kalimtar”.

5. Pika 1, seksioni Ç, kreu X, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETAR
Maksim Qoku

URDHËR
Nr. 252, datë 12.11.2021

**MBI DELEGIMIN E KOMPETENCËS
PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE
PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË
PROJEKTEVE NË FUSHËN E TURIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”, të pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës znj. Arta Dollani, në cilësinë e ushtrimit të detyrave si Sekretar i Përgjithshëm, për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare në fushën e turizmit me subjektet aplikuese, projektpropozimet e të cilave do të shpallen fituese, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, “Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit”.

2. Urdhri i ministrit nr. 228, datë 3.7.2019, “Për delegimin e kompetencave për nënshkrimin e kontratave për mbështetjen financiare në fushën e turizmit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve për komunikimin e këtij urdhri dhe Sekretari i Përgjithshëm, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 512 lekë